



Koha

www.koha.mk



KOHA për
kulturë

FORUM |||||

Qysh m'u ndreq?



"A u ndreqe?" - shpesh im atë në të folmen e tij e përdorke dialektin e gegnishtes së Kosovës e Malit të Zi... Në fakt, ne jemi rrit me tregimet e babit për miqtë e tij nga Kosova e Mali i Zi, Presheva njashtu - tek tuk. Njajt jena rrit edhe me iluzionin mbi Shqipëri, por ai ishte një iluzion i rremë... sepse kur ra muri, ra iluzioni! Masnej mësuam që këtë lidhje gjuhore t'shkrime në një t'folme universale t'a përjetojmë edhe si ekzotikë madje, ...sot kjo na duket edhe sexy edhe e jona shumë. E kemi përbrendu disi, mishnu! (Du shumë kur i shkel barrierat, kur i trus me taket e mia t'nalta, kur i...

RAJON |||||

Hyn në lojë shkëmbimi i Leposaviçit me Luginën

GLOBI |||||

Fëmijët e burgjeve të Izraelit!



ANALISTËT NUK PRESIN BOJKOT REAL NGA VMRO

PYETJE ME SHUMË PIKËPYETJE!



Sipas analistit politik Alajdin Demiri, pushteti ka bërë pyetje manipuluese dhe ultimative për qytetarët në Referendum, gjë që sipas tij, ka ardhur deri tek kundërshtimi i VMRO-së. Kjo e fundit, sipas tij, do të tentojë që fillimisht të ndryshojë pyetjen për Referendumin dhe më pas të marrë qëndrim për bojkot

Në garë për më shumë turistë

Shkup, 30 korrik - Nismat e ndryshme rajonale, por edhe bashkëpunimi i shteteve fqinje synojnë në të ardhmen zhvillimin e një ofertë të përbashkët turistike, me qëllim të rritjes së fluksit turistik, kohëzgjatjes së qëndrimit të turistëve, si dhe të ardhurave dhe punësimit në degën e turizmit në shtetet e Ballkanit Perëndimor. Në këtë drejtim, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal do të ofrojë grante apo mjete

të pakthyeshme me vlerë prej 1.62 milionë euro të financuara nga BE e që kanë për qëllim të përmirësojnë infrastrukturën dhe cilësinë e shërbimeve në rajon, e sidomos turizmin aventurier. Skema përfshin të paktën 30 grante, me një vlerë deri në 54 mijë euro secili. Implementimi i këtyre granteve do të bëhet përgjatë një periudhe 3-vjeçare. "Me këtë skemë grantesh, Këshilli i Bashkëpunimit...



EDITORIAL

MEDIAT SOCIALE DHE VETËDIJA SHOQËRORE



Emin AZEMI

Ka qenë një dilemë që ka shoqëruar debatin e përbotshtëm mbi internetin dhe vetëdijen qytetare. Jo pa arsye zhvillimi i së ashtuquajturës "media sociale" shihet si alternativë e së ardhmes, për t'u shkëputur nga kontrolli shtetëror i mediave dhe për rrjedhojë vetëdija shoqërore po ndjek hap pas hapi përhapjen e internetit.

Një vegël mjaft e sofistikuar siç është Facebooku dhe rrjetet e tjera sociale ka kohë që po e bën punën e vet në terren, kurse ngjarjet e vogla saora po globalizohen në përmasa planetare.

Mediatizimi i një mikro-ngjarje që ndodh vetëm disa orë më pas, do të duhej të shërbente si alarm për politikën e fjetur dhe stereotipe, e cila ende nuk është e zonja të kap trendet e shpejta të krijimit të opinionit publik me mjete që ajo nuk i ka nën kontroll.

Mediat e reja dhe politika, ndonëse e ndajnë të njëjtën sferë publike, ato megjithatë në shumë raste janë dy skajet e kundërta të një litari i cili vazhdon të tërhiqet mbi kurrizin e një mase të madhe njerëzish të paedukuar mjaftueshëm mediatisht. Një vetëdije e krijuar nga funksionimi i mediave të reja është në konflikt permanent me logjikën politike e cila njerëzit i trajton si makinë votuese dhe asgjë më tepër.

Ngjarjet politike dhe aktivitetet e ndryshme publike nuk mund të shikohen të shkëputura nga pjesëmarrja aktive e përdoruesve në rrjetet sociale. Kjo interaktivitet komunikues krijon një 'opozitë të re', e cila, hëpërhë, nuk është nën kontrollin e asnjë reprezentit politik. Janë të shumtë në numër ata persona që po e kultivojnë identitetin e tyre qytetar, intelektual e social përmes kësaj bote virtuale dhe favorit më i madh që del nga ky realitet është pamundësia e politikës së ditës për të manipuluar me këtë 'masë elitare' që po e projekton refuzimin e vet jo vetëm personal, por edhe komunitar.

Për dallim nga mediat konvencionale, të cilat luftën e propagandës e zhvillonin njëkahshëm, tani në praktikë po ndodhë një luftë tjetër e mediave sociale ku shpërndarja e mesazhit është shumëkahëshe dhe për pasojë efektet janë shumë fish më të mëdha, sidomos në krijimin e situatave paragjyquese sociale, etnike e fetare.

Sot gjithkush bën gazetarin dhe redaktorin nëpër media sociale, por askush nuk merr përgjegjësinë për efektet shpërdoruese të lirisë pa kufi dhe cenimit të standardeve minimale profesionale. Postimi pa kriter i materialeve (ku zakonisht mungojnë datat dhe vendet ku kanë ndodhur ngjarjet), qofshin të shkruara apo të multimedias, po krijon jo vetëm një publik pa shije e pa sens, por po ngre murin ndarës që po i ndihmon me të madhe mosqarkullimit normal të ndikimeve, vlerave e modeleve reciproke.

Ka rrezik që ky publik i ri që po formohet në këtë mënyrë, të jetë aq shumë i lidhur pas "realitetit të tij", sa të humbë sensin e prekjes në realitetin konkret të jetës së përditshme, por edhe heqjen dorë nga mediat e tjera, të ashtuquajtura konvencionale, ndaj të cilave, me pa të drejtë mund të ngrihet një gardh paragjyques.

Të udhëhequrit e shoqërisë me sasi të mëdha paragjykimi mund të shpjerë njeriun modern para dilemës hamletiane të jesh apo të mos jesh i mirinformuar. Një publik i tillë, i përbërë nga qindra e mijëra "dembelë Stambolli" që vetëmjaftohen duke dremitur e vegjetuar brenda kështjellave të tyre virtuale, është i padobishëm në planin e përgjithshëm të mendësisë civile të komunitetit dhe formimit kulturor të njerëzve.

ISA NUK E KA NË DORË PARTINË

"A ka një shembull më adekuat se sa ky postim i Isa Mustafës që tregon se shqetësimi im për LDK-në si një parti që ka mbetur pa udhëheqës, nuk është i shpifur, por është real? Si mund të shkruajë me konsideratë aq të lartë për Adem Demaçin, kryetari i partisë që mungon në varrimin e tij, sikur kjo mungesë të ishte krijuar me urdhrin e tij?! Isa Mustafa nuk njihet si njeri dyfyturësh e hipokrit, që thotë një gjë e bën një gjë tjetër. Ai vlerësohet si një njeri shumë i ngritur moralisht, intelektualisht dhe politikisht. Kjo çfarë ai ka shkruar përputhet 100 për qind me atë çfarë do të thoshte Ibrahim Rugova për Adem Demaçin, por edhe çfarë do të thosha edhe unë për shembull, si dhe çdo qytetar normal i Kosovës që nuk ia ka hedhur mendet në erë politika destruktive e ndarjes dhe e përçarjes vëllazërore! Duket sheshit se Isa Mustafa më nuk e ka në dorë partinë. Janë disa individë që po abuzojnë me rolin prijës që kanë marrë në mungesën aktive të liderit legjitim dhe të cilët nuk po ngurrojnë ta çojnë partinë buzë varrit vetëm për të përfituar vetë politikisht. LDK duhet urgjentisht t'i vlerësojë sjelljet e veta dhe të kërkojë përgjegjësi nga udhëheqja e vet për mungesë rezoni moral dhe politik dhe për largim nga kursi tradicional institucionalist. Një devijim i tillë e dëmton shumë partinë, të ardhmen e saj dhe shtetin e Kosovës. Votuesi i LDK-së duhet t'i njohë mirë hipokritet dhe të mos ju japë shansin atyre ta hedhin në greminë partinë. LDK është partia më politiken më konsistente institucionaliste dhe nëse nuk vazhdon të mbetet e tillë ajo humb identitetin e vet politik. Shpresoj shumë se brenda LDK-së do të ketë refleksione pozitive dhe se ajo do të këndellet shpejt që mos ta humbë hapin me kohën në udhëtimin e saj politik", shkruan publicisti nga Prishtina, Liri Loshi.

TRAMPI DHE PRESIDENCA TESHTITJE

"Barsolëta e vjetër e Luftës së Ftohtë thoshte se kur Moskë teshtin vetëm një herë i tërë blloku lindor, prej Varshavës e deri në Tiranë, fiton një grip serioz, me zjarrmi e kollitje. Analogjia është frikësuese sot për Perëndimin. Presidenca e Donald Trumpit është, për më keq, diçka më shumë se teshtitje dhe tash bëhet viti i dytë që diplomatë e burrshtetas (përfshirë edhe gratë e fuqishme si zonja Merkel) analizojnë zjarminë e pashmangshme të organizmit të krijuar me shumë mund pas Luftës së Dytë Botërore e të quajtur Aleanca Transatlantike. Dy nga tri shtyllat e kësaj aleance, SHBA-ja dhe BE-ja, kanë sëmundje që nuk kurohet me aspirinë, e kur SHBA-ja ka problem që nuk kurohet me aspirinë atëherë ky është problem i madh edhe për shtyllën e tretë, NATO-n. Problemi i SHBA-së quhet presidenca Trump dhe evidencohet nëpërmjet të asaj që në Evropë perceptohet gjithandej si braktisje të politikës tradicionale atlanticiste, së cilës SHBA-ja i ka prirë me sukses prej fundit të Luftës së Dytë Botërore. Ky është, automatikisht, problemi i shtyllës së dytë, problemi i NATO-s; kjo nuk është organizatë e njëjtë nëse SHBA-ja nuk beson në të dhe nuk i prin. Dhe, pastaj vjen edhe problemi i shtyllës së tretë, BE-së. Problemi i kësaj shtylle ilustron me Brexitin, dëshirën e njërit shtet anëtar (të madh e të rëndësishëm) për t'u larguar nga Klubi, e që në masë të madhe ka të bëjë me krizën e përhershme të identitetit të një organizmi në rritje: sa e thelluar mund të jetë vendimmarrja brenda BE-së? Pastaj, a ekzistojnë parakushtet strukturore - në politikë ekonomike, fiskale e të mbrojtjes, për të dhënë një listë të shkurtër - për ta bërë këtë?", shkruan në FB, publicisti Veton Surroi.

MEDIACitate

KURTI: KATËR ETAPAT E DOMOS- DOSHME PARA DIALOGUT ME SERBINË



Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në debatin parlamentar për dialogun me Serbinë, ka thënë se para dialogut të ri me Serbinë, duhet të shqyrtohet dhe vlerësohet dialogu i deritashëm, synimet dhe kërkesat e Kosovës, parimet, si dhe ekipi negociator dhe strategjia.

Kurti tha se dialogu me Serbinë po bëhet për ta anëtarësuar Serbinë në Bashkimin Evropian dhe jo për t'u anëtarësuar Kosova në OKB.

"Para çdo dialogu të ri me Serbinë, katër etapa përgatitore janë të domosdoshme në Kosovë. E para shqyrtim dhe vlerësim i dialogut 2011-2017, e dyta, synimet e Kosovës dhe kërkesat tona ndaj Serbisë, e treta parimet dhe kushtet e dialogut të ri dhe e katërta, ekipi ynë negociator me strategji dhe udhëheqës. Unë besoj që vetëm një gjë nuk duhet të jetë publike, strategjia e ekipit negociator, të gjitha gjërat tjera duhet të jenë publike", ka thënë ai. Kurti i inkurajoi deputetët që të deklarohen për dialogun e ri që tashmë ka filluar pa mandat.

Sipas tij, rezultati kryesor i dialogut të deritanishëm është lista serbe, pasi është vrapuar pas marrëveshjeve të reja, pavarësisht zbatimit të marrëveshjeve të vjetra.

(Zëri, 30 korrik)

NËSE NUK E KENI DITUR...

KUSH ISHIN DUSHMANËT?

Dushmanët ishin familje sunduese feudale, zotërimet e së cilës shtriheshin në Pultin e Vogël (Krahina e Shllakut).

Si pinjollë të saj përmenden në fillim të shek. XV vëllezërit Damiani, Goranin dhe Nenada. Nën presionin osman, ata u bënë në fund të shek. XIV e në fillim të shek. XV vasalë të osmanëve; më pas, me dobësimin e këtij presioni Dushmanët njohën mbrojtjen e

Venedikut. Një pinjoll i saj, Lekë Dushmani mori pjesë më 1444 në Kuvendin e Lezhës dhe qëndroi për disa kohë si anëtar i Lidhjes shqiptare që u themelua atje.

Ai u largua prej saj kur Lidhja hyri në luftë kundër Venedikut.

Emri i Dushmanëve mbeti si toponim në regjistrat osmanë dhe deri në ditët tona në malësi.

MAZHORANCA ME INICIATIVË

PARLAMENTI VOTON PRO REFERENDUMIT

Me shumicë votash, Parlamenti ka votuar pro mbajtjes së Referendimit për emrin në seancë ku si pikë të rendit të ditës krahas Referendimit, ishte edhe buxheti që do të vihet në dispozicion për zhvillimin e tij. Seanca është hapur nga koordinatori i LSDM-së, Tomislav Tuntev, i cili ndër të tjera tha se kjo është një ditë kur shkruhet historia e re e Maqedonisë dhe se me këtë vendim deputetët do të zgjedhin mes Maqedonisë evropiane dhe Maqedonisë së izoluar. Në sallë vihej re mungesa e deputetëve të VMRO-së që në masë të madhe bojkotuan seancën



spozicion për zhvillimin e tij. Seanca është hapur nga koordinatori i LSDM-së, Tomislav Tuntev, i cili ndër të tjera tha se kjo është një ditë kur shkruhet historia e re e Maqedonisë dhe se me këtë vendim - deputetët do të zgjedhin mes Maqedonisë evropiane dhe Maqedonisë së izoluar. Në sallë vihej re mungesa e deputetëve të VMRO-DPMNE-së që në masë të madhe bojkotuan seancën. Për diskutim, përveç Tuntevit, u paraqitën vetëm pesë deputetë. Përpara nisjes së seancës parlamentare për Referendumin, sekretari i përgjithshëm i VMRO-së, Igor Janushev, në një konferencë për shtyp ka bërë të ditur se nuk do ta bojkotojnë seancën, por do të votojnë kundër. Ai e ka cilësuar si manipulative formulimin e pyetjes për referendumin, ndërsa marrëveshjen për emrin të

dëmshme për shtetin dhe qytetarët, në kundërshtim me vullnetin e tyre.

"Kemi të bëjmë me shkelje brutale të praktikës demokratike për çfarëdolloj pyetje për Referendumin, por edhe të formulimit të saj që duhet të bëhet me konsensus me të gjitha partitë politike... Pyetja e Referendimit

është krejtësisht në kundërshtim me Ligjin dhe para së gjithash, manipulative. Prandaj VMRO nuk e pranon propozimin në mënyrë që të bëhet alibi e pushtetit, por me argumente debatua se pyetja duhet të jetë unanime", ka thënë Janushev. Referendumi për çështjen e emrit do të mbahet më 30 shtator, ndërsa pyetja që do të

ju drejtohet qytetarëve është: "A jeni për anëtarësimin në BE dhe NATO me pranimin e marrëveshjes mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë?"

Që nga mëngjesi i djeshëm, shumica parlamentare ka pritur PO-në e opozitës për thirrjen e seancës më të cilën duhet të merrej vendimi për shpalljen e Referendimit. Pasi VMRO-DPMNE edhe zyrtarisht u shpreh kundër propozimit të shumicës për pyetjen e Referendimit, atëherë këta të fundit dorëzuan vetë iniciativën për këtë seancë. Në afat rekord prej vetëm dy orëve kryeparlamentari Talat Xhaferi caktoi seancën plenare me mbështetje vetëm të shumicës parlamentare. Sa i takon buxhetit që shteti parashikon të vërë në dispozicion të mbajtjes së Referendimit - është rreth 3.4 milionë euro, fond që duhet të grumbullohet nga më shumë institucione dhe që do të transferohet në arkën e KSHZ.

Koha

Evis HALILI

Shkup, 30 korrik - Iniciativa e koalicionit qeverisës për shpalljen e Referendimit për çështjen e emrit ka kaluar në seancën parlamentare të zhvilluar në orët e pasdites, e kundërshtuar nga deputetët e VMRO-DPMNE. Me shumicë votash, Parlamenti ka votuar pro mbajtjes së Referendimit për emrin në seancë ku si pikë të rendit të ditës, krahas Referendimit ishte edhe buxheti që do të vihet në di-

BETOHEN ANËTARËT E KSHZ

Anëtarët e rinj të Komisionit Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) kanë bërë betimin në prezencë të kryetarit të Parlamentit, Talat Xhaferi. I pari është deklaruar kryetari i KSHZ-së, Oliver Derkovski, i propozuar nga VMRO, ndërsa nënkryetare është Demire Shehu nga BDI. Si anëtarë të tjerë janë betuar Elizabeta Postolovska nga VMRO, Janakie Vitanovski, Boris Kondarko dhe Radica Risteska nga LSDM, si dhe Oliver Saliu nga BESA e fraksionit të Bilall Kasamit. Anëtarët e sapozgjedhur pritet të fillojnë me përgatitjet për zhvillimin e referendimit.



Lika takoi Goldstein, diskutohet mësimi i gjuhës së njëri-tjetrit

Shkup, 30 korrik - Zëvendëskryetari i Qeverisë së Maqedonisë përgjegjës për zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit, Hazbi Lika, ka realizuar dje takim pune me Xhef Goldstein, ushtrues i detyrës së Shefit të Misionit të OSBE-së në Shkup. Fillimisht në takim, njofton Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes së Ohri u diskutua rreth mbështetjes potenciale që Misioni mund të ofrojë mbi çështjet prioritare të përfshira në Planin e reformave të Qeverisë dhe mundësive për bashkëpunimet e ardhshme të cilat do të jenë në dobi të të dy institucioneve. Paralelisht, bashkëbiseduesit shprehën gatishmëri për përfundim të bashkëpunimit duke nënshkruar memorandum bashkëpunimi që do të shërbejë si bazë e punës së mëtejshme e cila do të realizohet përmes grupeve punuese dhe intensivikimin e takimeve të rregullta. "Në aspektin e identifikimit të fushave prioritare për t'i adresuar së bashku, u diskutua rreth asistencës së nevojshme në çështjen e gjuhës, përfaqësimit të drejtë, si dhe raportet mes komuniteteve", shtohet në kumtesë.

Zëvendëskryeministri Lika më tej në takim propozoi që të inicohen projekte të përbashkëta të cilat qëllim kryesor do të kenë stimulimin për mësimin e gjuhës dhe kulturës së njëri-tjetrit, si një indikacion i rëndësishëm në rrugën drejt përfundimit të marrëdhënieve ndëretnike në Republikën e Maqedonisë.

OSMANI TAKOI AMBASADORIN PLOMP

Nisin përgatitjet për negociatat aderuese

Shkup, 30 korrik - Zëvendëskryetari i Qeverisë së Maqedonisë për Çështje Evropiane, Bujar Osmani, realizoi takim me ambasadorin e Mbretërisë së Holandës, Valter Plomp, me ç'rast, siç thuhet në kumtesë, diskutuan për aktivitetet e ardhme të shtetit në drejtim të përgatitjes për fillimin e negociatave aderuese, për momentet e reja lidhur me referendumin e ardhshëm lidhur me Marrëveshjen me Greqinë, për mbështetjen nga ana e Mbretërisë së Holandës për integrimin tonë evropian, si dhe tema tjera aktuale. "Punojmë në mënyrë intensive në përgatitjen e ekipit dhe strukturës për fillimin e negociatave, duke e mbajtur fokusin e Qeverisë drejt reformave me të cilat në periudhën e ardhshme do të japim rezultate konkrete dhe të dukshme në pjesën e gjyqësorit, shërbimet e sigurisë dhe administratës publike, si dhe në pjesën e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe në fushat tjera kyçe", nënvizoi Osma-



ni. Ai e informoi ambasadorin me rrjedhën e përgatitjeve për referendumin e ardhshëm, si dhe krijimin e mbështetjes për implementimin e obligimeve të marra nga marrëveshjet ndërkombëtare, në veçanti për implementimin e Marrëveshjes për zgjedhjen e kontestit të emrit me Greqinë. "Kemi perspektiva të qarta

evropiane dhe euro-atlantike, dhe ne si Qeveri në përgjithësi jemi të përkushtuar në implementimin e detyrimeve të marra, me qëllim të rumbullakimit të procesit evropian dhe euro-integrues", theksoi Osmani, duke shtuar se në këtë rrugë pret vazhdimin e mbështetjes së sinqertë të Mbretërisë së Holandës.

Rritje e konsiderueshme e prodhimitarisë industriale

Sipas grupeve kryesore industriale, prodhimtaria në qershor të vitit 2018, në krahasim me qershorin e vitit 2017, shënon rritje te Energjia për 12.3 për qind, Prodhimet intermediare, përveç energjisë për 13.5 për qind, Prodhimet kapitale për 34.2 dhe te Prodhimet e qëndrueshme për konsum të gjerë për 20.1 për qind

Shkup, 30 korrik - Prodhimtaria industriale në qershor të këtij viti në raport me qershorin e vitit të kaluar është rritur për 12.1 për qind. Në periudhën janar-qershor të vitit 2018, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ka rritje prej pesë për qind, kumtoi Enti Shtetëror Statistikor.

Shikuar sipas sektorëve, prodhimtaria industriale në sektorin e Minierave dhe nxjerrjen e gurit në qershor të këtij viti në krahasim me qershorin e vitit 2017 shënon rritje prej 4.2 për qind, në sektorin e Industrisë përpunuese ka rritje prej 14.1 për qind, ndërsa në sektorin Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër i klimatizuar rritje prej 16.3 për qind.

Rritja në sektorin e Industrisë përpunuese është rezultat, para së gjithash, i prodhimitarisë së rritur në sferat: Prodhimtaria e prodhimeve ushqimore, Prodhimtari e prodhimeve të duhanit, Prodhimtaria e tekstilit, Prodhimtaria e veshmbathjeve, Prodhimtaria e prodhimeve farmaceutike dhe preparateve farmaceutike, Prodhimtaria e prodhimeve nga goma dhe prodhime nga masat plastike, Prodhimtari e metaleve, Prodhimtaria e prodhimeve të fabrikua të metalit, përveç makinave dhe pajisjeve, Prodhimtaria e pajisjeve elektrike, prodhimtaria e makinave dhe pajisjeve, të pa përmendura në vend tjetër, Prodhimtaria e automjeteve, rimorkio dhe gjysmë rimorkio dhe Prodhimtaria e mobilieve. Sipas grupeve kryesore industriale, prodhimtaria në qershor të vitit 2018, në krahasim me qershorin e vitit 2017, shënon rritje te Energjia për 12.3 për qind, Prodhimet intermediare, përveç energjisë për 13.5 për qind, Prodhimet kapitale për 34.2 dhe te Prodhimet e qëndrueshme për konsum të gjerë për 20.1 për qind.

ANALISTËT NUK PRESIN BOJKOT REAL NGA VMRO

PYETJE ME SHUMË PIKËPYETJE!

Sipas analistit politik Alajdin Demiri, pushteti ka bërë pyetje manipuluese dhe ultimative për qytetarët në Referendum, gjë që sipas tij, ka ardhur deri tek kundërshtimi i VMRO-së. Kjo e fundit, sipas tij, do të tentojë që fillimisht të ndryshojë pyetjen për Referendumin dhe më pas të marrë qëndrim për bojkot

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 30 korrik - Kryeministri Zoran Zaev ka deklaruar të hënën se Referendumi do të jetë konsultativ dhe se do të mbahet më 30 shtator. Zaevi theksoi po ashtu se pyetja është ajo që tashmë është publikuar: "A jeni për hyrje në NATO dhe BE me përkrahje të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë?".

"E di se Referendumi do të jetë konsultativ. Sërisht e shfrytëzoj rastin që ta ftoj opozitën që të përfshihet, dhe t'i ftoj qytetarët që të dalin masovikisht që të tregojnë qëndrimin e tyre. E dini se ky është vendim historik, jo vetëm se del nga referendumi, por për shkak se nëpërmjet tij definohet ardhmëria e Republikës së Maqedonisë", tha Zaev. Sipas analistit politik Alajdin Demiri, pushteti ka bërë pyetje manipuluese dhe ultimative për qytetarët në Referendum, gjë që sipas tij, ka ardhur deri tek kundërshtimi i VMRO-së. Kjo e fundit, sipas Demirit, do të tentojë që fillimisht të ndryshojë pyetjen për Referendumin dhe më pas të marrë qëndrim për bojkot.

"Dihet që qytetarët e Maqedonisë janë për integrim në BE dhe në NATO, dhe më herët VMRO po ashtu ka bërë përpjekje për të bërë Marrëveshje për emrin me Greqinë. Nga ana tjetër, dihet se LSDM bëri më shumë dhe arriti të bëjë Marrëveshje për emrin. Por LSDM gaboi kur bëri pyetjen ultimative dhe detyruese, dhe më këtë rast nxiti VMRO-në të kundërshtojë ashpër Referendumin", thotë Demiri. Pyetja, sipas tij, në vend se të ishte sugjestionuese, do të duhej të ishte precize: A jemi për ndryshimin e emrit të shtetit?".

"Mendoj se VMRO para së të marrë qëndrim përfundimtar për Referendumin, do të tentojë të ndryshojë pyetjen për të njëjtën.



Nëse do të mbetet kjo pyetje, mendoj se VMRO nuk do ta pengojë mbajtjen e Referendumit, por formalisht do ta kundërshtojë atë. Kjo, si rezultat i trysnisë së faktorit ndërkombëtar që mund të ushtrojë ndaj saj nëse eventualisht do të dilnin në skenë elemente destabilizuese para mbajtjes së Referendumit", thotë Demiri. Për analistin tjetër politik, Ibrahim Mehmeti, kundërshtimi i VMRO-së nuk është ndonjë befasi kur shihet qartazi se nëpërmjet këtij kundërshtimi, kjo parti tenton t'i kthejë simpatizantët e saj të cilët definitivisht i humbi gjatë zgjedhjeve lokale.

"Megjithatë, edhe pse kjo është pjesë e luftës politike, mendoj se ky qëndrim nuk është korrekt, sepse vetë kjo parti vite me radhë ka qenë e kyçur në negociata për të njëjtën çështje dhe nuk ka të drejtë ta pengojë realizimin e marrëveshjes së arritur me aq mund. Nëse e dimë se kjo marrëveshje me Greqinë në të njëjtën kohë paraqet parakusht për daljen e Maqedonisë nga izolimi ndërkombëtar dhe kyçjen e saj në proceset integruese në NATO dhe BE, atëherë ky kundërshtim do të thotë edhe kundërshtim i këtyre proceseve", thotë Mehmeti. Ai shprehet se faktori ndërkombëtar do të gjejë mënyrë që më në fund t'a bindë liderin e kësaj partie, Hristijan Mickovski, që të heqë dorë nga kjo rrugë qorre e cila Maqedoninë e mban peng të ambicieve partiake në llogari të përparimit të vendit drejt rrugëtimit të saj në shoqërinë e shteteve euro-atlantike.

Kur jemi tek përgatitjet rreth Referendumit dhe qëndrimet e partive politike shqiptare, nga BDI thonë se do të bëjnë fushatë intensive për dalje në referendum së bashku me partnerin e saj në Qeveri - LSDM.

"BDI si bartëse e procese integruese në vend do të bëjë fushatë aktive për Referendumin. Siguri-

sht se do të kemi bashkërendim me LSDM-së, por ende nuk kemi vendosur se a do të jetë fushata e përbashkët. Por sigurisht fushata do të jetë intensive e të dy partive. Presim që qytetarët shqiptarë në mënyrë unanime ti thonë PO referendumit për t'i hapur rrugë kështu anëtarësimit të shpejtë në NATO dhe shkurtimit të rrugës për në BE", thonë nga BDI. Nga Lëvizja BESA me kryetar Afrim Gashin thonë se me kapacitet të plotë do të punojnë për suksesin e Referendumit.

"Sapo ta votojmë në Parlament vendimin për shpalljen e Referendumit, do të mblidhet Kryesia Qendrore e Lëvizjes BESA dhe do të diskutojë për mënyrën e organizimit përkitazi me detyrimet për një Referendum të suksesshëm. Mes tjerash, do të flitet për organizimin e Shtabit dhe detaje të tjera, që pastaj duhet ta miratohen edhe në Kuvendin Qendror. Gjithsesi ne jemi dhe do të jemi të angazhuar me kapacitet të plotë për suksesin e këtij Referendumi, duke besuar thëllëse se kjo është portë drejt integrimit euroatlantik", thotë për gazetën KOHA, Orhan Murtezani, zëdhënës i Lëvizjes BESA. Nga Aleanca për Shqiptarët thonë se shqiptarëve nuk kanë nevojë për t'iu të bëhet fushatë për ti bindur dikush për rëndësinë e BE-së dhe NATO-s, ngase ata pikërisht politika e deritanishme dhe qeveritë e shumta ku ka marrë pjesë aktive BDI, ua kanë pamundësuar integrimin e tyre në BE dhe NATO.

"Fushata jonë politike do të jetë duke kërkuar llogari nga BDI që i ka izoluar shqiptarët deri tani, i ka varfëruar pa zhvillim ekonomik, pa mirëqenie sociale, dhe pa vende të punës", thotë Flakron Bexheti, zëdhënës i Aleancës për Shqiptarët. Faktori shqiptar, sipas Bexhetit, do të jetë vendimtar që ky Referendum dhe propozim emri i Maqedonisë të kalojë qoftë në Parlament - qoftë në Referendum.

ALAJDIN DEMIRI

Nëse do të mbetet kjo pyetje, mendoj se VMRO nuk do ta pengojë mbajtjen e Referendumit, por formalisht do ta kundërshtojë atë. Kjo, si rezultat i trysnisë së faktorit ndërkombëtar që mund të ushtrojë ndaj saj nëse eventualisht do të dilnin në skenë elemente destabilizuese para mbajtjes së Referendumit

IBRAHIM MEHMETI

Nëse e dimë se kjo marrëveshje me Greqinë në të njëjtën kohë paraqet parakusht për daljen e Maqedonisë nga izolimi ndërkombëtar dhe kyçjen e saj në proceset integruese në NATO dhe BE, atëherë ky kundërshtim do të thotë edhe kundërshtim i këtyre proceseve

"Megjithatë Qeveria LSDM-BDI po tenton ti vë shqiptarët para aktit të kryer, sepse në Marrëveshjen me Greqinë, nuk është paraparë çështja e identitetit shqiptar dhe e gjuhës shqipe, ndërsa shqiptarët janë faktor determinues që Maqedonia të anëtarësohet në NATO dhe BE. Në parim jemi deklaruar se do të përkrahim edhe në Parlament edhe në Referendum propozim-emrin e ri, dhe më pas kur të hapet Kushtetuta, do të kërkojmë edhe nga subjektet tjera politike shqiptare që çështjen e identitetit shqiptar dhe të gjuhës shqipe, këto dy elemente ti bëjmë pjesë të Kushtetutës, duke e legjitimuar identitetin shqiptarë dhe gjuhën shqipe si komponentë juridike dhe kushtetuese", thotë Bexheti.

EUROPOL-i TËRHEQ VËREJTJEN PËR FAQET MASHTRUESE

KUJDES GJATË BLERJEVE NË INTERNET



Protokolli mbrojtës "3D sekjur", siç njoftojnë nga EUROPOL-i, është njëri prej sistemeve më të njohura për pagesë, të cilin e shfrytëzojnë bankat më të njohura botërore. Përderisa një blerës është i interesuar të bëjë ndonjë transaksion në ndonjë faqe, atëherë rekomandim i Policisë Europiane është që të shikohet se vallë, ajo faqe posedon "3D sekjur"

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 30 korrik - Gjatë pagesave nëpërmjet internetit, blerësit në asnjë mënyrë, përveç të dhënave bazë, nuk duhet të dërgojnë edhe PIN-kodin e kartelës bankare. Në publikimin e fundit se si të mbrohem nga keqpërdorimi i të dhënave personale, Policia Evropiane - EUROPOL, thotë se ekzistojnë mundësi që e-mail adresat të komprometohen përmes programeve (softuereve) të ndryshme kriminojgjene, respektivisht ka softuere që i njohin të dhënat nga kartelat bankare. Në pjesën e rekomandimeve për parandalimin e mashtrimeve në internet, EUROPOL-i tërheq vërejtjen që shfrytëzuesit e faqeve jo komerciale në internet, të kenë kujdes gjatë shënimit të të dhënave bankare edhe kur bëhet fjalë për aplikacionet siç janë lojërat e ndryshme, lotaritë e rrejtshme apo lirimet për veshmbathje. "Qëllimi i kryesor dhe i vetëm i këtyre faqeve është mbledhja e sa më shumë informacioneve nga kartelat bankare, me qëllim që më vonë të keqpërdoren. Në internet ekziston një numër i konsiderueshëm i këtyre llojeve të faqeve. Për këtë arsye, me rëndësi të veçantë është njohja se cilat faqe elektronike janë të sigurta dhe cilat jo. Shumica e brendeve të njohura - faqe për shitje, i kanë të siguruara me sistemet më kualitative dhe ato ofrojnë mbrojtjen e të dhënave personale. Tash vetë blerësve ju mbetet ti vlerësojnë se cilët janë ato adresa të sigurta dhe cilat aplikacione mund të paraqesin rrezik për keqpërdorimin e të dhënave të tyre", thonë nga EUROPOL-i.

Protokolli mbrojtës "3D sekjur", siç njoftojnë nga EUROPOL-i, është njëri prej sistemeve më të njohura për pagesë të cilin e shfrytëzojnë bankat më të njohura botërore. Përderisa një blerës është i interesuar të bëjë ndonjë tran-

saksioni në ndonjë faqe, atëherë rekomandim i EUROPOL-it është që të shikohet se vallë ajo faqe posedon "3D sekjur". Mirëpo, nëse mungon ky lloj aplikacioni, atëherë blerësi duhet të sigurohet se faqja e mundëson transferin e sigurt të parave. Kryesisht faqet e sigurta e posedojnë një parashtrësë "URL".

Me qëllim shkatërrimin e rrjeteve kriminele që merren me keqpërdorimin e të dhënave personale, Policia Evropiane në fillim të muajit qershor realizoi një aksion të gjerë policor në më shumë vende të Evropës, me çka u arrestuan 95 mashtrues profesional të internetit. Të dyshuarit e arrestuar dyshohet se gjatë veprimtarisë së tyre kriminele në internet, kanë realizuar mbi 20 mijë transaksione mashtruese, në masë të madhe duke i keqpërdorur të dhënat e kartela-



Me qëllim shkatërrimin e rrjeteve kriminele që merren me keqpërdorimin e të dhënave personale, Policia Evropiane në fillim të muajit qershor realizoi një aksion të gjerë policor në më shumë vende të Evropës, me çka u arrestuan 95 mashtrues profesional të internetit. Të dyshuarit e arrestuar dyshohet se gjatë veprimtarisë së tyre kriminele në internet, kanë realizuar mbi 20 mijë transaksione mashtruese, në masë të madhe duke i keqpërdorur të dhënat e kartelave bankare, vlera e të cilave i arrin deri në 8 milionë euro

ve bankare, vlera e të cilave i arrin deri në 8 milionë euro. Ky aksion i gjerë i EUROPOL-it me seli në Hagë, rezultoi pas ankesave të shumta të palëve të dëmtuara, përfshi persona juridik, kompani, banka e qytetarë të shumtë.

Ndryshe, të dhënat zyrtare të Agjencisë për Komunikime Elektronike të Maqedonisë, flasin se një përqindje e vogël e amvisërive në vend i kanë të instaluar programet mbrojtëse për kontroll të fëmijëve. Raporti zyrtar i AKE-së, i publikuar së fundmi ka konstatuar se vetëm 10 për qind e popullatës në vend i kanë të regjistruar këto aplikacione. Hulumtimet e realizuar nga ky institucion shtetëror, po ashtu kanë konstatuar se gjysma e popullatës së intervistuar nuk ka pasur idenë se ekzistojnë këto lloje të programeve, respektivisht 44 për qind prej tyre që kanë fëmijë të mitur, pas njoftimit kanë shprehur interes për ta instaluar. Megjithatë, pjesa dërmuese e popullatës nuk ka as informacionin më të vogël se si mund të sigurohet ky program mbrojtës. Në bazë të raporteve ditore të mediave botërore dhe atyre nga rajoni, mund të vërehen se shumë fëmijë të mitur, pa njohurit e prindërve kanë realizuar transaksione të mëdha dhe pa vetëdijen e tyre kanë krijuar probleme të mëdha financiare të familjes. Në vendin tonë, siç njoftojnë nga AKE-ja, për dallim nga vitet paraprake, gjatë vitit 2017 numri i fëmijëve të mitur që kanë qasje deri në internet shënon rritje të vogël. Në 83 për qind të rasteve, fëmijët kanë qasje të vazhdueshme në Internet dhe aty 37 për qind prej tyre qëndrojnë minimum deri në dy, mbi 40 për qind prej tyre qëndrojnë deri në pesë orë. Të dhënat e fundit nga AKE-ja, thonë se qasje deri në rrjetin e Internetit, në Maqedoni kanë 84 për e popullatës, ndërsa vetëm 76 për qind prej tyre janë regjistruar si shfrytëzues.

KRONIKË

Djali sulmon nënën dhe gruan

Të dielën mbrëma në ora 22 e 50 minuta është denoncuar se dy orë më parë në Tetovë, personi H.U. 33 vjeçar, së pari ka filluar të ofendojë nënën e tij Xh.U., 61 vjeçare dhe gruan e tij Xh.U. 36 vjeçare dhe më pas edhe fizikisht e ka sulmuar nënën e tij. Të sulmuarës Xh.U. ndihmë mjekësore i është dhënë në Spitalin Klinik të Tetovës. Nga ana e pjesëtarëve të policisë, personi H.U. është arrestuar dhe mbajtur në Stacionin policor në Tetovë, dhe punohet në zbardhjen e plotë të rastit, ku edhe do të pasojë padi adekuate.

Dëmtohen katër vetura nga plumba pa destinim

Katër vetura janë dëmtuar në katër raste të ndara nga plumba të padestinuara gjatë ditës së diel në rajonin e Pollogut. Nga policia informojnë se të dielën rreth orës 13 e 45 minuta është denoncuar, se në Tetovë, në rrugën "Vëllezërit Milladinovi" nga një plumb i padestinuara, është dëmtuar vetura "BMW" me targa të Zvicrës, pronë e personit F.A 44 vjeçar nga Tetova. Të dielën rreth orës 16.30 është denoncuar se gjithashtu në Tetovë, në rrugën e "Ilindenit" nga një plumb i padestinuara është dëmtuar pjesa e përparme e veturës "Reno Megan" me targa të Tetovës, pronë e R.A 21 vjeçar nga fshati Bogovinë. Po ashtu të dielën në mesditë është denoncuar se në fshatin Zhelinë në oborrin e shtëpisë, nga një plumb i padestinuara është dëmtuar dritarja e veturës Mercedes me targa të Belgjikës, pronë e personit M.A 41 vjeçar nga fshati Zhelinë. Të njejtën ditë, rreth orës 16 e 50 minuta është denoncuar se në fshatin Çegran në oborrin e shtëpisë, nga një plumb i padestinuara është dëmtuar xhami i veturës "Opel Astra" me targa të Gostivarit, pronë e personit S.N. 41 vjeçar nga fshati Çegran. Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë punon në zbardhjen e të gjitha katër rasteve në veçanti.

Fundjava në Shkup me 29 aksidente, dy të lënduar rëndë

Dy persona kanë marrë lëndime të rënda, ndërsa 26 lëndime më të lehta trupore në 29 aksidente rrugore që gjatë fundjavës që lamë pas kanë ndodhur në rajonin e SPB Shkup. Policia rrugore ka sanksionuar 147 shoferë që kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se e lejuara, ndërsa nga komunikacioni janë përjashtuar 90 shoferë. Sipas raportit policor, 38 shoferë e kanë drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit, 38 para se të marrin të drejtën e ngasjes së automjetit motorik, ndërsa 14 shoferë fillestarë. Në mënyrë të parregullt ishin parkuar 136 automjete, ndërsa karrotreci ka marrë 107 automjete. Janë sanksionuar edhe nëntë këmbësorë të cilët kanë kaluar jashtë vijave të shënuara për ta, 11 shoferë të cilët kanë kaluar në dritën e kuqe të semaforit, dy shoferë të cilët nuk u kanë dhënë përparësi kalimi këmbësorëve, shtatë për rreshtim të parregullt, gjashtë për parakalim të parregullt dhe 19 drejtues të motoçikletave janë sanksionuar për mos shfrytëzimin e helmetave mbrojtëse. (U.H)

"Në 2017, të ardhura më të larta se sa në vitin 2016 ka realizuar vetëm TV Telma (për 31.02 për qind). Katër televizionet tjera kanë shënuar rënie të të ardhurave dhe atë: TV Alfa, për 22.12 për qind, TV Alsat-M për 7.29 për qind, TV Sitel për 4.55 për qind dhe TV Kanal 5 për 0.64 për qind", tregon analiza e Agjencisë për Media

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 30 korrik - Në industrinë mediatike audio dhe audiovizuale në Maqedoni në vitin 2017 janë realizuar të ardhura më të ulëta të përgjithshme në pesë vitet e fundit. Nga viti 2013 e këndeje, shkalla e rritjes së të ardhurave të përgjithshme në këtë industri çdo vit ka qenë negative, por të ardhurat janë zvogëluar më së shumti vitin e fundit, për 10.35 për qind, tregon analiza e tregut të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale për vitin 2017.

"Të gjitha tre segmentet e industrisë kanë realizuar më pak të ardhura se sa në vitin paraprak, dhe atë RTVM për 152.34 milionë denarë, televizionet komerciale për 118.87 milionë denarë, ndërsa radiostacionet komerciale për 30.10

ANALIZË E TREGUT TË SHËRBIMEVE MEDIATIKE

ULEN FITIMET E TELEVIZIONEVE



milionë denarë", qëndron në analizën e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale. Të ardhurat e përgjithshme që në vitin 2017 së bashku i kanë realizuar të gjithë radiodifuzerët (RTVM, 54 televizione komerciale dhe 70 radiostacione) kanë arritur 2.608.84 milionë denarë. Më shumë se gjysma e asaj vlere (54.48 për qind) janë të ardhura të përgjithshme të televizioneve komerciale prej 1.421.32 milionë denarë. Të ardhurat e RTVM-së nga 1.037.49 milionë denarë paraqesin 39.77 për qind, ndërsa të ardhurat e radiostacioneve prej 150.03 milionë denarë janë 5.75 për qind nga të ardhurat e përgjithshme të të gjithë radiodifuzerëve. Në vlerën prej 2.608.84 mi-

lionë denarë janë llogaritur të ardhurat që radiodifuzerët së bashku i kanë realizuar sipas të gjitha bazave. Pjesa më e rëndësishme, më saktë 90 për qind e kësaj vlere, të ardhurat nga reklamimi (53 për qind) dhe të ardhurat e RTVM-së nga taksa radiodifuzive dhe nga mjetet e transferuara nga Buxheti i Maqedonisë sipas nenin 105 - financim i RTVM-së dhe nenit 135 - mjete për financim të veprimtarisë radiodifuzive (37 për qind nga të ardhurat e tërësishme). Të tjerat 10 për qind e të ardhurave të tërësishme në industrinë janë të ardhurat e realizuara sipas të gjitha bazave tjera.

Të ardhurat nga reklamimi kanë arritur 1.383.61 milionë de-

narë, prej të cilave 90.04 për qind u takojnë televizioneve komerciale, 8.15 për qind radiostacioneve komerciale, ndërsa 1.81 për qind RTVM-së. Njëjtë sikur edhe të ardhurat e tërësishme, në vitin 2017 janë realizuar edhe të ardhura më të ulëta nga reklamimi në pesë vitet e fundit. Përveç në vitin 2014, kur janë realizuar për 3.10 për qind më shumë të ardhura se sa në vitin paraprak, në tre vitet e fundit vazhdimisht është zvogëluar vlere e këtyre të ardhurave, duke arritur 1.383.60 milionë denarë në vitin 2017.

Më pak të ardhura nga reklamimi kanë realizuar edhe sektori publik dhe komercial. Të ardhurat e televizioneve komerciale ishin për

5.68 për qind më të ulëta se sa në vitin 2016, përkatësisht për 74.96 milionë denarë. RTVM ka realizuar të ardhura më të ulëta 43.30 për qind (19.15 milionë më pak se sa në vitin 2016 29.84 milionë denarë). Sipas analizës, në vitin 2017 pesë televizione të cilat emetojnë program përmes multipleksit tokësor digjital në nivel shtetëror (TV Sitel, TV Kanal 5, TV Telma, TV Alsat-M dhe TV Alfa), kanë realizuar të ardhura prej 1.071.89 milionë denarë. Kjo është vlere më e vogël e të ardhurave të tërësishme të këtyre pesë televizioneve në pesë vitet e fundit. Në krahasim me vitin paraprak të ardhurat janë më të ulëta për 2.65 për qind. "Të ardhura më të larta se sa në vitin 2016 ka realizuar vetëm TV Telma (për 31.02 për qind). Katër televizionet tjera kanë shënuar rënie të të ardhurave dhe atë: TV Alfa, për 22.12 për qind, TV Alsat-M për 7.29 për qind, TV Sitel për 4.55 për qind dhe TV Kanal 5 për 0.64 për qind", tregon analiza e ASHAVM. Gjatë vitit 2017 numri i tërësishëm i radiodifuzerëve është zvogëluar për gjashtë për qind. Në fillim të vitit të kaluar, përveç servisit radiodifuziv publik, programe kanë emittuar edhe radiodifuzerë (63 televizione dhe 71 radiostacione), ndërsa në fund të vitit gjithsej 128, prej të cilave 58 televizione dhe 70 radiostacione.


Analiza edhe sivjet tregon se numri më i madh i anëtarëve të kabinetit qeveritar dhe ekipeve të tyre për çdo ditë publikojnë përmbajtje për aktivitetet e tyre në Fejsbuk dhe kanë profile apo faqe të hapura në të cilat mundën qytetarët t'u shkruajnë publikisht apo, megjithatë, në mesazh privat

Shkup, 30 korrik - Njëzet e tre nga gjithsej 26 ministra në Qeverinë e Maqedonisë në mënyrë aktive përdorin Fejsbuk, që është rritje për tre të cilët janë aktivë në këtë rrjet, tregojnë të dhënat nga analiza e dytë vjetore të realizuar në periudhën nga data 23 e deri në 28 korrik të vitit 2018.

Analiza edhe sivjet tregon se numri më i madh i anëtarëve të kabinetit qeveritar dhe ekipeve të tyre për çdo ditë publikojnë përmbajtje për aktivitetet e tyre në Fejsbuk dhe

RRJETET SOCIALE I PËRDORIN 23 MINISTRA NË QEVERI

MINISTRAT E FEJSBUKUT



kanë profile apo faqe të hapura në të cilat mundën qytetarët t'u shkruajnë publikisht apo, megjithatë, në mesazh privat. Më shumë se gjysma e ministrave kanë hapur profilin vetin, por edhe faqe në këtë medium social.

Rritje është vërejtur në Twitter që sivjet e përdorin 14 anëtarë të Qeverisë, ndërsa gjithashtu po aq janë të pranishëm edhe në Instagram.

Sipas analizës, vitin e kaluar Twitter kanë përdorë tetë ministra, derisa gjithsej 10 kanë qenë aktivë edhe në Instagram. Kryeministri Zaev edhe 10 ministra të tjerë janë aktivë dhe kanë profile/afate të veta në Fejbuk, Twitter dhe Instagram, që është për katër herë më shumë se vitin e kaluar. Vetëm dy anëtarë të Qeverisë, zëvendëskryeministri Koço Angjushev dhe ministri Ro-

bert Popovski aspak nuk kanë profile/faqe të veta në këto rrjete sociale, kundrejt vitit të kaluar kur gjashtë ministra nuk kanë qenë aktivë në asnjë medium social. "Të gjithë ministrat është me rëndësi të jenë të pranishëm me faqe apo kanale të veta në mediat sociale, ndërsa me qëllim që komunikimit të drejtpërdrejt dhe dydrejtimësh me qytetarët. Në Analizë edhe sivjet është

theksuar se publikimet, komentet dhe përgjigjet e pyetjeve nuk nevojitet drejtpërdrejt t'i kryejë ministri, por këtë mund ta bëjnë ekipet e tyre onlajn, pas dakordimit paraprak në emër të ministrit apo ministres", thotë Bojan Kaedalov, ekspert për marrëdhënie me opinionin dhe mediave të reja, i cili është edhe autor i hulumtimit.

Mes konkluzioneve të analizës është me qëllim të përfshirjes të të gjithëve grupeve synuese dhe të të gjithë opinionit në strategjinë e komunikimit të Qeverisë, nevojitet të gjithë ministrat të kenë faqe/kanale të tyre aktive në mediat sociale. Përsëritet edhe të dhënat se është pranuar sugjerimi nga analiza e vitit të kaluar dhe të faqes së internetit të Qeverisë në vend të dukshëm është vendosur pjesë me kontakte nga palët apo kanalet e mediave sociale të anëtarëve të kabinetit qeveritar. Rekomandimi është dinamika e publikimeve do të jetë e përditshme edhe atë me të paktën 2.3 publikime në ditë në të gjitha mediat sociale.

RAJONI, OFERTË E PËRBASHKËT NË TREGUN E TURIZMIT BOTËROR

NË GARË PËR MË SHUMË TURISTË

Nismat e ndryshme rajonale synojnë zhvillimin e një oferte të përbashkët turistike, me qëllim rritjen e fluksit turistik, kohëzgjatjen e qëndrimit të turistëve, si dhe rritjen e të ardhurave në degën e turizmit në shtetet e Ballkanit Perëndimor



Koha / Fisnik PASHOLLI

Shkup, 30 korrik - Nismat e ndryshme rajonale, por edhe bashkëpunimi i shteteve fqinje synojnë në të ardhmen zhvillimin e një oferte të përbashkët turistike, me qëllim të rritjes së fluksit turistik, kohëzgjatjes së qëndrimit të turistëve, si dhe të ardhurave dhe punësimit në degën e turizmit në shtetet e Ballkanit Perëndimor. Në këtë drejtim, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal do të ofrojë grante apo mjete të pakthyeshme me vlerë prej 1.62 milionë euro të financuara nga BE e që kanë për qëllim të përmirësojnë infrastrukturën dhe cilësinë e shërbimeve në rajon, e sidomos turizmin aventurier. Skema përfshin të paktën 30 grante, me një vlerë deri në 54 mijë euro secili. Implementimi i këtyre grantëve do të bëhet përgjatë një periudhe 3-vjeçare.

"Me këtë skemë grantesh, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal do t'i mundësojë ekonomive publike dhe private në vendet e Ballkanit Perëndimor të implementojnë

ndërhyrjet e nevojshme në qendrat turistike dhe të bëhet më tërheqëse për turistët e huaj. Me fjalë të tjera, ne do të ndihmojmë në ndërtimin e një turizmi të përbashkët të rajonit, gjë që do të çojë në më shumë vizitorë në këto vende, si dhe do të zgjasë në kohë qëndrimin e tyre në rajon, duke qenë se pritet të ketë më shumë vende për t'u vizituar dhe guida të unifikuar", thotë Goran Svilanović, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal.

Kohë më parë, gjatë takimit të ministrit të Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, me homologen bullgare Nikolina Angelova, u arrit pajtueshmëri se për të tërhequr turistë nga tregjet e largëta, nevojitet krijimi i një rruge rajonale turistike, dhe për këtë qëllim veç më është krijuar një grup pune nga dy vendet, të cilat deri në këtë vjeshtë duhet të përgatisin një propozim-ofertë të përbashkët të turizmit, që mund të përfshijë vendet e tjera në rajonin e interesit, të cilat do të ofrojnë tërheqje të ndryshme për turistët botërorë në një distancë të vogël.

Ministri Bekteshi shprehu gatishmëri për realizimin e kësaj iniciative, ndërsa propozoi që në periudhën e ardhshme të realizohet një takim pune mes dy vendeve, me përfaqësues nga vetëqeverisja lokale, operatorë turistikë, hotelierë, transportuesit ajror, sidomos ato me kosto të ulët, me qëllim të përfshirjes së sektorit të turizmit në përcaktimin e aktiviteteve të përbashkëta për paraqitje në tregjet e largëta turistike. Në ndërkohë, është paralajmëruar se edhe Shqipëria dhe Serbia do të paraqiten me një ofertë të përbashkët turistike për vendet e treta. Lajmi u bë i ditur kohë më parë nga ministri shqiptar i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi në Beograd, ku firmosi një marrëveshje bashkëpunimi në fushën e turizmit me ministrin serb të Tregtisë, Turizmit dhe Telekomunikacionit, Rasim Lajiq. Marrëveshja e bashkëpunimit midis dy vendeve parashikon bashkëpunimin në fushën e turizmit, promovim të përbashkët të turizmit mes Shqipërisë e Serbisë, pako të përbashkëta për vendet e treta, etj.

Përveç kësaj marrëveshjeje dypalëshe, ministri Klosi shprehu vullnetin edhe për oferta të përbashkëta rajonale. "Së bashku me ministrin Lajiq do të punojmë që ofertat të mos jenë vetëm shqiptare dhe serbe, por të jenë një bashkëpunim midis gjashtë institucioneve të turizmit të rajonit tonë, së bashku me Malin e Zi, Bosnje dhe Hercegovinën, Kosovën dhe Maqedoninë", tha ministri Klosi.

Në ndërkohë, Këshilli i Koordinimit Rajonal po punon për të harmonizuar bashkëpunimin në sektorin e turizmi duke vënë nëntë piketa për të cilat do të punojnë bashkërisht.

Në një dokument të posaçëm i këtij institucioni me seli në Sarajevë, bëhet e ditur se një projekt i posaçëm për Zhvillimin dhe Promovimin e Turizmit në Rajon synon të promovojë në rang global ofertat e përbashkëta turistike, të përmirësojë aftësitë dhe kapacitetet në industrinë e turizmit, të hiqen barrierat administrative për zhvillimin e turizmit dhe të rrisin hyrjen e turistëve dhe të ardhurave të gjeneruara nga turizmi.

Qëllimet e planit të përbashkët rajonal për turizmin përfshijnë: ofertat e konsoliduara turistike në Ballkanin Perëndimor, zhvillimin e rrugëve dhe ofertave të përbashkëta rajonale të turizmit të kulturës dhe aventurës, ofertat rajonale të bëhen konkurruese, të përmirësohet infrastruktura e turizmit, si dhe të hiqen pengesat administrative për lëvizjen e lirë të turistëve. Gjithashtu punohet që turizmi rajonal të ofrohet në nivel global, të rritet fluksi turistik, kohëzgjatja e qëndrimit dhe të ardhurat etj.

Deri tani, shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë themeluar grupin e ekspertëve të turizmit, i cili identifikoi barrierat e politikave që pengojnë zhvillimin e sektorit dhe prodhuan rekomandime se si t'i kapërcejnë ato. Është ngritur poashtu edhe Task Force mbi Kulturën dhe Shoqërinë (TFÇS).

Turizmi kulturor dhe turizmi i aventurës janë renditur si pakot më konkurruese të tregut për zhvillimin e përbashkët të produkteve rajonale.

Një projekt me vlerë 5 milionë euro është aktivizuar për Zhvillimin dhe Promovimin e Turizmit (Triple P Tourism) me qëllim për të promovuar ofertën rajonale të turizmit. Ndryshe, ekspertët e turizmit thonë se ekonomitë e Ballkanit mesatarisht shpenzojnë më pak se 2 për qind të shpenzimeve të përgjithshme qeveritare për turizmin, oferta e turizmit është e fragmentuar në të gjithë zinxhirët e vlerës dhe infrastruktura është pjesërisht e pazhvilluar. Njëherazi, ekzistojnë edhe pengesa administrative për rrjedhjen e lirë të turistëve (p.sh. viza dhe sigurimi shëndetësor), ndërsa aventurat dhe rrugët e turizmit kulturor nuk janë zhvilluar dhe promovuar në mënyrë të mjaftueshme.

Gostivari nis prishjen e ndërtimeve pa leje

Gostivar, 30 korrik - Komuna e Gostivarit ka filluar sot aksionin për prishjen e ndërtimeve pa leje në territorin e komunës së Gostivarit, njoftojnë nga Shërbimi për Informim i komunës. I pari ndërtim i cili u prish dje, ishte një murr në lagjen Pitarnicë që ishte ndërtuar pa leje përkatëse dhe në vendin e paraparë për rrugë duke mundësuar kështu qarkullimin e lirshëm të automjeteve të asaj pjese të lagjes Pitarnicë. Komuna e Gostivarit do të vazhdojë me prishjen e ndërtimeve pa leje, siç janë muret të cilët kapin pjesë të rrugës, ndërtime shtesë si dhe objekte banimi të cilët janë ndërtuar në mënyrë të paligjshme, shtohet më tej në njoftim. Nga Sektori i urbanizimit pranë Komunës së Gostivarit i bëjnë, apel qytetarëve që të mos ndërtojnë pa leje adekuate, sepse do të ballafaqohen me të gjitha masat në përputhje me ligjet pozitive të Republikës së Maqedonisë.

Maqedonia e pret Kosovën të tërheqë tarifën doganore

Shkup, 30 korrik - Ende është e pasigurt nëse dhe kur Kosova plotësisht do ta tërheqë vendimin për rritjen e tarifave doganore të prodhimeve bujqësore. Sot (e martë), Qeveria e Kosovës duhet të mbajë seancë në të cilën do të shqyrtohen argumentet që të premtën ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi ia transmetoi kolegut kosovar Bajram Hasani.

Bekteshi në takimin me Hasanin në Prishtinë i vuri në dukje dëmet nga masat e përkohshme të Kosovës dhe shfaq shpresë se në shpejti Maqedonia dhe Kosova do ta vazhdojnë bashkëpunimin e deritanishëm të shkëlqyer tregtar, në dobi të prodhuesve bujqësorë dhe komuniteti të biznesit nga të dyja

palët. "Do ta presim rezultatin nga seanca e nesërme e Qeverisë së Kosovës, është shkurt përgjigjja nga Ministria e Ekonomisë në pyetjen e MIA-s lidhur me hapat e ardhshëm që vendi planifikon t'i ndërmarrë rreth doganave të rritura.

Edhe Ministria e Bujqësisë pret në seancën e sotme qeveritare të Kosovës. Afaristët dhe prodhuesit e Maqedonisë mbesin në qëndrimin se vendimi i Kosovës duhet sa më shpejt të tërhiqet, sepse dëmet janë të mëdha, ndërsa Maqedonia të mos vendosë kundërmasa. Sipas drejtorit ekzekutiv të Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, Drilon Iseni, dëmet në eksportin edhe më tej numërohen, nuk ka



ndryshime në qëndrimin e Odës së Kosovës duhet ta rishikojë vendimin dhe të gjendet një zgjidhje e përbashkët e pranueshme.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrimit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPLLJE PUBLIKE NUMËR – 127/2018

për punësimin e 6 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Komunën e Sarajit” për vendet e punës në vijim:

1. YIP0101V04000 Bashkëpunëtor i ri 1 realizues(ë)
për obligime buxhetore, Njësia për koordinim buxhetor, kontroll buxhetore dhe kontabilitet dhe pagesë, Sektori për çështje financiare

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca Ekonomike ose Juridike
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 21.037,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

2. UPR0101B04000 Udhëheqës i njësies për tatime dhe furnizime publike, Sektori për çështje financiare 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca ekonomike
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 28.757,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

3. UPR0101V04000 Bashkëpunëtor i ri 1 realizues(ë)
për kontabilitet dhe pagesë, Njësia për koordinim buxhetor, kontroll buxhetore dhe kontabilitet dhe pagesë, Sektori për çështje financiare

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca Ekonomike ose shkenca organizuese dhe menaxhim(menaxhment)
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 21.037,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

4. UPR0101V04000 Bashkëpunëtor i ri 2 realizues(ë)
për koordinim të aktiviteteve të kryetarit të komunës, Njësia për punë profesionale - administrative dhe të përgjithshme, Sektori për punë juridike dhe normative

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca juridike, politike ose ekonomike
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 21.037,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 2.

5. UPR0101V04000 Bashkëpunëtor i ri 1 realizues(ë)
për përsosje profesionale, Njësia për resurse njerëzore

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca ekonomike, politike ose organizuese dhe menaxhim (menaxhment)
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 21.037,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Edhe një nga parqet më të mëdha përgjatë rrugës "Boris Kidriç", duke filluar nga Qendra për Kulturë e deri tek Qendra Sportive, viteve të fundit është përfshirë nga ndërtimet dhe zaptimet e tavernave

GJITHNJË E MË PAK GJELBËRIME NË TETOVË

PARQET PO SHNDËRROHEN NË BETON



pjesët ku janë ndërtuar ndërtesa të mëdha. Kjo edhe viteve të kaluara, sipas ekspertëve ishte një ndër arsyt kryesore të ndotjes për shkak të mos qarkullimit të ajrit.

Nga Komuna e Tetovës thonë se hapësirat e gjelbërta do tu kthehen qytetarëve. "NPK Tetovë-Tetovë, do të dalë në terren, do të inspektojë dëmtimet dhe në bashkëpunim me investitorët të cilët ndërtojnë në atë pjesë, do të kthehen hapësirat e gjelbërta. Në Tetovë kemi diku rreth 41.123 metër katror sipërfaqe të gjelbra publike, por po ballafaqohemi me një problem. Të gjithë jemi të vetëdijshëm se uzurpohen në mënyrë të pashkruar hapësirat publike, mirëpo tendenca jonë edhe si komunë edhe si ndërmarrje është që ata sipërfaqe ti zhbllokojmë dhe ti kthejmë tek qytetarët", thonë nga pushteti lokal në Tetovë.

Në qytetin e Tetovës, i cili tashmë është shndërruar në qytet-beton, nuk respektohet as në minimum hapësira e gjelbërta e cila sipas standardeve evropiane, është që për kokë banori të ketë 16 metër kub hapësirë të gjelbërt. Në të kaluarën, në Tetovë ka patur shumë

parqe të cilët janë shfrytëzuar nga qytetarët, kurse kohëve të fundit ka mbetur vetëm ai pranë Xhamisë së Larmë, ndërsa së fundi është rregulluar edhe parku afër stacionit të autobusëve.

Pjesa dërmuese e hapësirave të lira të cilët kanë qenë me gjelbërim janë uzurpuar dhe në ato vende janë bërë ndërtime. Nga NPK-ja, krahas kësaj thonë se për më shumë pastërti vendosin edhe shporta, por ato dëmtohen. "Shpeshherë kalimtarë të rastit dëmtojnë shportat dhe të njëjtat mund të them se janë në gjendje të mjerueshme. Prandaj, në këtë drejtim duhet edhe një vetëdije më e lartë e qytetarëve që të mos i dëmtojnë ato, sepse bashkërisht mund të kontribuojmë për një ambient më të pastër në qytetin e Tetovës", thonë nga kjo ndërmarrje. Tetovë që nga viti 1990 është kthyer në një qendër në Maqedoninë Perëndimore, si në aspektin tregtar, ashtu edhe në aspekte të tjera, ngase pas hapjes së dy universiteteve, dukshëm qyteti është zgjeruar, numri i banorëve është rritur, ndërsa gjithnjë e më pak ka hapësira të gjelbërta.

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 30 korrik - Komuna e Tetovës me shpërndarjen e të punësuarve nga administrata në ndërmarrjet publike do të tentojë të zgjidhë problemin me mungesën e kuadrin, e cila sipas informacioneve, është një nga shkaktarët për mungesën e higjienës dhe mbajtjen e gjelbërimit në qytet. Kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi, disa herë ka theksuar se ka mungesë edhe të punësuarve në ndërmarrjen "Parqet dhe gjelbërimi", sepse një numër shumë i vogël i punëtorëve kujdesen për një qytet ku gravitojnë rreth 100 mijë qytetarë. Ajo ka nënvizuar se ky proces duhet të fillojë me shpërndarjen e administratës nëpër ndërmarrjet publike, por pa precizuar se kur do të fillojë ky proces. Tetovë kështu ngel pa hapësi-

ra të gjelbërta viteve të fundit. Të njëjtat shkatërrohen në mënyrë të pamëshirshme.

Një nga parqet më të mëdha përgjatë rrugës "Boris Kidriç", duke filluar nga Qendra për Kulturë e deri tek Qendra Sportive, viteve të fundit është përfshirë nga ndërtimet dhe zaptimet e tavernave. Një pjesë tashmë është rregulluar si

parking, ndërsa përgjatë rrugës janë vendosur edhe mburoja prej metali për ndërtimet që zhvillohen. Qytetarët theksojnë se me ndërtimet e reja, në qytet po dëmtohen hapësirat e gjelbërta, të cilët përvetësohen nga investitorë duke mos lënë asnjë hapësirë jeshile apo parqe. Në Tetovë, dëmtime të këtylla ka gjithandej, sidomos në

Publicitet

Në bazë të nenit 9 paragrafi (1) të Rregullores për procedurën dhe kriteret për shpërndarje të mjeteve për realizim të interesit publik në sport nr. 08-35/1 të datës 4 janar 2018 në pajtim me Programin për zhvillim të sportit dhe të rinjve për vitin 2018 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/2018), Programi për shpërndarje të mjeteve nga lojërata e fatit dhe lojërata argëtuese për vitin 2018 për financimin e federatave nacionale të sportit dhe projekteve të Agjencisë për të rinj dhe sport për avancimin e sportit në Republikën e Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/2018), si dhe Vendimit për publikim të Konkursit për vitin 2018 nr. 08-1580/1 të datës 30.07.2018, drejtori i Agjencisë për të rinj dhe sport e Republikës së Maqedonisë, publikon

KONKURS 2
Për ndarje të mjeteve për vitin 2018

Publikohet konkurs për ndarje të mjeteve për vitin 2018, nga:

- Programi për shpërndarje të mjeteve nga lojërata e fatit dhe lojërata argëtuese për vitin 2018 për financimin e federatave nacionale të sportit dhe projekteve të Agjencisë për të rinj dhe sport për avancimin e sportit në Republikën e Maqedonisë, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/18).
- Programit për zhvillim të sportit dhe të rinjve për vitin 2018 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/2018) dhe

- Programi për shpërndarje të mjeteve nga lojërata e fatit dhe lojërata argëtuese për vitin 2018 për financimin e federatave nacionale të sportit dhe projekteve të Agjencisë për të rinj dhe sport për avancimin e sportit në Republikën e Maqedonisë**

I. a

Numri rendor	Përcaktimi	Përshkrimi
1.	Participim për financim të federatave nacionale të sportit për shkak të sigurimit të funksionalitetit të tyre, punës së organeve dhe trupave të federatave dhe funksionim të sistemit nacional të sportit	Është planifikuar participim për shkak të sigurimit të funksionalitetit të federatave nacionale të sportit për: punë profesionale të sekretarëve të përgjithshëm dhe administruesve; funksion të organeve dhe trupave; funksionim i sistemit nacional të garave
2.	Participim për financim të klubeve të të rinjve të radhitur pjesëmarrës në sisteme të sportit të organizuara nga federatat nacionale të sportit	Është planifikuar participim për mbështetje të klubeve të të rinjve të radhitur pjesëmarrës në sisteme të sportit të organizuara nga federatat nacionale të sportit.
3.	Participim për financim të punës profesionale në klubet e të rinjve të radhitura, pjesëmarrës në sisteme të sportit, të organizuara nga federatat nacionale të sportit	Është planifikuar participim për federatat nacionale të sportit në financim të punës profesionale me sportistë individë dhe ekupe nacionale në federatat nacionale të sportit.
4.	Participim për aktivitete programore për edukim dhe licencim të trajnerëve dhe personave tjerë profesional në sport (referë, mjekë sportiv, psikologë, nutricionistë, fizioterapeutë etj.)	Është planifikuar participim për aktivitete programore për edukim dhe licencim të trajnerëve dhe personave tjerë profesional në sport.
5.	Participim për financim të projekteve të federatave nacionale të sportit dhe Agjencisë për të rinj dhe sport për masivitet të sportit dhe mbështetje të sportistëve të rinj më të talentuar	Është planifikuar participim për realizim të federatave nacionale të sportit dhe Agjencisë për të rinj dhe sport për avancim dhe zhvillim të sportit në Republikën e Maqedonisë.
6.	Participim në aktivitetet programore të federatave nacionale të sportit për veprimtari botuese, për literaturë profesionale dhe shkencore nga sfera e sportit, të së drejtës evropiane dhe nacionale të sportit, si dhe rregullave ndërkombëtare të asociacioneve ndërkombëtare të sportit	Është planifikuar participim në aktivitetet programore të federatave nacionale të sportit për veprimtari botuese, për literaturë profesionale dhe shkencore nga sfera e sportit, të së drejtës evropiane dhe nacionale të sportit, si dhe rregullave ndërkombëtare të asociacioneve ndërkombëtare të sportit.
7.	Participim për financim të programeve të federatave nacionale të sportit për luftën kundër dopingut në sport	Është planifikuar participim për realizim të doping kontrollit dhe menaxhim me rezultatet e kontrolleve të realizuara për doping.
8.	Participim për financim të aktiviteteve programore për shpresat olimpike të Maqedonisë, selektimi, specializimi i hershëm i sportit dhe karriera e dyfishitë e sportistëve të rinj	Është planifikuar participim për financim të aktiviteteve programore për shpresat olimpike, selektimi i tyre, si dhe specializimi i hershëm i sportit dhe karriera e dyfishitë e sportistëve të rinj
9.	Participim për financim të projekteve për mbështetje të femrës në sport	Është planifikuar participim për financim të projekteve për mbështetje të femrës në sport.
10.	Participim për financim të projekteve për mbështetje të sportit të personave me pengesa në zhvillim dhe nevoja të posaçme	Është planifikuar participim për financim të projekteve për mbështetje të sportit të personave me pengesa në zhvillim dhe nevoja të posaçme
11.	Participim në aktivitete programore të federatave nacionale të sportit për mbështetje dhe zhvillim të sportit për të gjithë dhe kushteve për sport për veteranët e sportit dhe qytetarët e ritur	Është planifikuar participim për financim të projekteve për mbështetje të sportit dhe kushteve për sport për veteranët e sportit dhe qytetarët e ritur.

I. b

12.	Participim për mbështetje të federatave nacionale të sportit për furnizim të pajisjeve për ekipet, reprezentacionet dhe individëve për pjesëmarrje në kampionatet evropiane dhe rajonale	Është planifikuar participim për financim të furnizimit të pajisjeve për reprezentacionet dhe individëve për pjesëmarrje në kampionatet evropiane dhe rajonale.
-----	--	---

2. Programi për zhvillim të sportit dhe të rinjve për vitin 2018

Numri rendor	Përcaktimi	Përshkrimi
1.	Participim për financim të programeve ndërkombëtare të federatave nacionale të sportit	Është planifikuar participim në realizimin e programeve të federatave nacionale të sportit për pjesëmarrje në sistemin ndërkombëtar të garave. Në vitin 2018, sportistët tanë, ekipet kombëtare dhe klubet sportive do të marrin pjesë në kuadër të kampionateve rajonale, kampionateve evropiane dhe botërore, kupe, kampionateve të hapura dhe llojeve të ndryshme të garave ndërkombëtare.
2.	Participim për financim të garave dhe manifestimeve tradicionale ndërkombëtare sportive	Është planifikuar participim për realizimin e programeve të federatave nacionale të sportit për organizim të garave dhe manifestimeve tradicionale ndërkombëtare sportive. Në Republikën e Maqedonisë mbahen një numër i madh i garave dhe manifestimeve tradicionale sportive në më shumë sporte. Disa prej tyre janë pjesë e Kalendarit për garat e asociacioneve ndërkombëtare sportive, me çka valorizohet edhe vlera dhe rëndësia e tyre.
3.	Participim për programet e federatave nacionale të sportit për edukim permanent të trajnerëve të sporteve olimpike dhe jo olimpike	Është planifikuar participim për financim të federatave nacionale të sportit për edukim permanent të trajnerëve të sporteve olimpike dhe jo olimpike
4.	Participim për përgatitje të sportistëve nga Republika e Maqedonisë për pjesëmarrje në Lojërata olimpike veporore - Tokio 2020	Është planifikuar participim për realizim të programeve të federatave nacionale të sportit për përgatitje të kandidatëve evident për pjesëmarrje në Lojërata olimpike veporore - Tokio 2020
5.	Participim për organizim të kampionateve evropiane dhe botërore në Republikën e Maqedonisë	Është planifikuar participim për realizim të programeve të federatave nacionale të sportit për organizim të kampionateve evropiane dhe botërore në Republikën e Maqedonisë

Aplikacionet 1 dhe 2 për pjesëmarrje në "Konkurs 2018" merren nga internet faja e Agjencisë për të rinj dhe sport www.ams.gov.mk ku është dhënë përshkrimi i paragrafëve sipas të cilave do të udhëhiqeni.

Aplikacionet 1 dhe 2 për pjesëmarrje në "Konkurs 2018" duhet të dorëzohen në Agjencinë për të rinj dhe sport në dorë dhe në mënyrë elektronike më së voni **deri më 13 gusht 2018 deri në ora 16.30** në adresën:

Agjencia për të rinj dhe sport
rr. "Makedonija" nr. 38 (Pallati "Panko Brashnarov")
1000 Shkup
Me shenjë: PËR KONKURS 2018

Dhe në mënyrë elektronike në e-mail:
Ognen Stojanovski - ognenstojanovski@hotmail.com
Natasha Smilevska - smilevska@hotmail.com

DREJTOR
DARKO KAEVSKI

Qysh m'u ndreq?

Nga

Adelina MARKU



Au ndreqe? -shpesh im atë në të folmen e tij e përdorke dialektin e gegnishtes së Kosovës e Malit të Zi... Në fakt, ne jemi rrit me tregimet e babit për miqtë e tij nga Kosova e Mali i Zi, Presheva njashtu- tek tuk. Njajjt jena rrit edhe me iluzionin mbi Shqipërinë, por ai ishte një iluzion i rremë...sepse kur rra muri, rra iluzionit! Masnej mësuam që këtë lidhje gjuhore t'shkrime në një t'folme universale t'a përfjetojmë edhe si ekzotikë madje, ... sot kjo na duket edhe sexy edhe e jona shumë. E kemi përbrendu disi, mishnu! (Du shum kur i shkel barierat, kur i trus me taket e mia t'nalta, kur i rrafshoj! Moralizmi asht një anti mësim në kuptimin tim! Nuk bahesh njeri i mirë tuj moralizu. Pik!) Padyshim përdorimi i shpeshhtë i ksaj gegnishtjeje n'tosknish-te (e via versa) boni që ne fëmijët e tij t'a ndejmë po atë vibrim në t'folmen tonë, po atë dashni për tjetrin, sidomos unë që shkruaj dhe që rrefuzoj me i respektu standardet e gjuhës sonë...(Këtë përparësi ka kolumnisti a! Nuk më fusin tekstin në centrifugën e lektorimit, del ashtu qysh e jap!). Kështu mësova se si qenka NDREQJA E VETES! Masnej aty për aty prodhoh një si tip teoreme a, apo një si tip vetëarsyetimi, vet'knaqje do thoja ma shumë, e them se, kur din me e përba gjuhën që flet, me gjas' din me pranu tjetrin që është ndrysh nga ti, por që din me mat knaqësinë njajt si ti! Dhe kështu unë kam mësuar të shpall modestinë- ART T'JETUMI!

E folmja ka të bën me dashninë poashtu, me pranimin e tjetrit/ës! Unë psh rrefuzoj konvencionin kohëve të fundit, sepse gjykoj se e rrendmja pas standardeve t'kodifikume dikur e nga dikush në një kohë e për një kontekst kohor e rrethanor të dhanë, jodoe-mosdoshmërisht duhet të jetë standard i t'jetumit e t'veprumit tem sot. E nëse doni me dijt, ky përcaktim imi që m'zbriti në këtë moshë jete, po m'ban me u ndi jashtë standardeve! Doemos që nuk asht standard në dekadën e pestë të jetës të mahnitësh me muzikën elektronike që e bën një maestro nga Gostivari psh, Blerimi (Rustemi), (siç u mahnitë këtyre ditëve unë). Ky asht përjashtim...por, përjashtimet bëjnë rregullin mëtej, mos harro! Për më shumë, kur shoshit dialektet bashkë, pak dibrance, pak gostivarçe, oj sa shumë tetovarçe e strugançe, prish-tinase e tironse...ti në fakt e kupton se pikërisht tek ky amalgam kreativ qëndron fuqia e gjuhës, mbarset fuqia e nukleusit kombëtar. Dhe nuk të pengon të shndrohesh në urë e të përcjel-

lësh lidhjen. Mos ju tut dialektit e origjinës pra!

Tani, tek përmenda babën, desha të ndaj me ju mësimin që më la ai pas e që kish të bënte me tej-konvencionalizmën e të jetumit. Doemos: mos vidh, mos rrej, mos vraj! - janë shtyllat e njeriut të mirë a, e për më shumë, nga ai mësova se ky mësim nuk merret në xhami o kishë e as te moralizuesit konvencional. Për t'a mbri të njajtin, pra premtimin e këtyre para Zotit mundesh me e arrit edhe pa ndërmjetësimin e fesë në mes (ai nuk preferonte fare gjuhën e standardizime të priftit ose hoxhës, gjuha e babës sim për "udhën e Perëndisë", ishte jashtë konvencës së hoxhës o priftit, jashtë moralizmave të tjera! Ai nuk njih-te kësaj barierash ...Sigurisht që e tillë jam dhe unë, të meremi vesh!)

Pra, qysh me u ndreq në këtë kohë t'pakohë qenka dilema e njeriut ose të riut sot sepse jodoe-mosdoshmërisht gjejmë njeriun e duhun në vendin e duhun dhe dëshpërimi - them unë- i njeriut e të riut sot, asht shumëfish ma i theksur se i të riut të kohës së socializmit! Sot, depresioni asht njajt si kolera dikur a, nëse kolera shpërndahet si epidemi vrastare, sot depresioni po depersonalizon të riun, njeriun më saktë! Sepse, ka hyp qeni në sixhade - thonë nga Dibra e rrallë rrallë tek i pasuni gjejmë edhe filantropin,

ose rrallë rrallë tek gjykatësi gjejmë edhe autoritetin e t'pavarunit, ose rrallë e kurrë tek shteti gjejmë provajderin... e kështu me radhë. Por, kur njeriu arrin me e kuptu këtë rrëshqitje/rramje të sistemit, atëherë ban mirë me lyp me ndreqë veten e me mbajt t'ngritun moralin personal! Lyp me i shpallë luftë sistemit përmes ngjizjes s'vazhdushme t'vetes! Jehona, shoqja ime e fëmijërisë do thoshte: " me u aftësu me rikriju veten vazhdimisht!" Thonë se kjo qenka arritja e njeriut të shekullit 21! Unë e dua këtë përcaktim, vlen për ata që kanë shpallur Pamoshën vlerë universale të të jetumit! Pra, paska mënyra të ndreqjes jashtë kësaj pritshmërie, jashtë kornizave konvencionale. Unë kam kuptuar se njeriu i cili pret që para t'a bëjë të lumtun, ose partia t'ia plotësojë karrierën (për shkak të 'besnikërisë'), ose dashninë t'a blejë o korruptojë, ose biles biles njeriu që pret të mer atë që meriton (!?), ose ai /ajo që pret një jetë tanë të jetë i respektum nga tjetri ...në esencë ky njeri asht i palumtun ë! Në këtë hesap palumtunie as prifti e as hoxha nuk t'ndreq po s'dijte me ndreq veten vetë! Hahahha, biles do thoja, narativa e diskursi i tyne të shkund më keq, të radikalizon ma shumë, sepse jo secili nga ne asht i prim me ndjek moralizmat e dogmave ideologjike a. Kur mëson mësimin

(Kolumnën ia kushtoj miqve të mi të rinj e kreativë - që m'a krijojnë të tashmen, miq tejdimensionit kohor e shumë si këta që i njohë do i njoh mëtej...! Asht preludë për ta dhe ...muzikën elektronike!)



e SINDRENQJES, rikrijimit të vetes pra, ke mësu mësimin e jetës tande...dhe, i shpall kohës matjen përmes orës tande personale. Tan' këtë hymje, tan' këtë dhanie jush e bona për me ju josh ditën ndrysh! Këtë shkrim m'a inspiroi një grup të rrinsh që përfjetojnë muzikën elektronike si Zotin vetë! Ishte edhe vendimi im i aty atyshëm këtyre ditëve, për me shiju diçka ndryshe e tuj dasht me përjetu një muzg e një agim në vajbet e muzikës elektronike të Blerimit nga Gostivari, të një të riu shqiptar që jeton jashtë konventave të tjerëve por që ka zgjedhur të jetë besnik i konventës personale, pa dëmtu e lëndu najkend kurrë! Dhe një gjë për fund, nuk do gaboja me konstati-min se të dijsh të jetosh SOT e të SOT-MEN, është njësoj sikur të shumëzosh një jetë të tanë me ditën që e ki konstruu ma së miri! Kështu ngjau edhe një ditë imja me miq, t'moshave e kulturave të ndryshme, një ditë e kësaj vere mrolane...një ditë që na bani lidhjen me muzikën e Blerimit njajt sikur njeriu që ban lidhjen saças me pikurën e Mona Lizës kur bef pa plan n' Luvr...

Aty, rikrijohet arti i modestisë së jetës tande dhe mson qysh m'u ndreq mëtej! Babi im kish pas të drejtë!

(Autorja është kolumniste e rregullt e gazetës KOHA)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovassja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypit dhe distribuimi: Adria Media Balkan - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 30 korrik | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Amerika dhe ndeshja energjetike në Baltik

Nga GEOPOLITICS

Shtetet e Bashkuara nuk duket se e pëlqejnë projektin Nord Stream 2: Në fakt, për Uashingtonin dyfishimi i gazsjellësit rusogjerman që shtrihet nën ujërat e baltikut duhet kundërshtuar aq sa të shkruhet e zeza në të bardhë në një ligj të Kongresit të miratuar më 2 gusht 2017. Linja politike e Shtëpisë së Bardhë duket kështu sikur ndjek përmbajtjen e një diskutimi të famshëm (dhe të shillirët) të George Friedman të mbajtur në Chicago Council në vitin 2015, ku themeluesi i Stratfor ilustronte nevojën historike për Shtetet e Bashkuara për të shmanhur që Gjermania dhe Rusia të krijojnë një aks (tejet) strategjik. Trump shpluhuros kështu një thënie të vjetër të gjeopolitikës amerikane të adoptuar tashmë nga Ronald Reagan në vitet '80 kundër Bashkimit Sovjetik, duke demonstruar kështu sesi loja energjetike në anën perëndimore e kontinentit euraziatik shkon përtej rreshtimeve të thjeshta ideologjike dhe sesa narrativja lidhur e Luftës së Re të Ftohtë është (në këtë aspekt) e vërtetë.

DILEMA MIDIS TARIFAVE (AMERIKANE) DHE GAZIT (RUS)

Më 15 maj, Gazpromi ka komunikuar nisjen e punimeve përgatitore për ndërtimin e pjesës gjermane (Gjiri i Greifswald) të gazsjellësit Nord Stream 2. Ashtu si binjaku i tij Nord Stream, tubacioni i ri do të shtrihet nën ujërat e Detit Baltik, duke furnizuar Europën perëndimore me gaz të ardhur nga zemra e Federatës Ruse. Kapaciteti transportues i tij është 55 miliard metra kub në vit. Konsorciumi - me seli në Zyrih - përveçse nga rusët e Gazpromit financohet edhe nga francezët e Engie, nga austriakja OMV, nga anglo-holandezja Royal Dutch Shell dhe nga grupet gjermane Wintershall e Uniper. Sipas "Wall Street Journal" të 17 majit - në një artikull të Boris Pancevski ku citoheshin burime gjysmëzyrtare anonime europiane (gjermane) dhe amerikane - Presidenti Donald Trump e kishte manifestuar hapur kundërshtimin e administratës së tij ndaj Nord Stream 2 gjatë një takimi të zhvilluar në prill me Bundeskanzlerin Angela Merkel, duke zbuluar gjithashtu se, në rast tërheqjeje nga ana e qeverisë gjermane, Uashingtoni do të ishte i gatshëm që të anulonte tarifën e lajmëruara ndaj disa produkteve siderurgjike (çelikut dhe aluminit) të Bashkimit Europian. Lajmi vjen në një moment që duket delikat për marrëdhëniet euro-atlantike, pasi

Më 15 maj, Gazpromi ka komunikuar nisjen e punimeve përgatitore për ndërtimin e pjesës gjermane (Gjiri i Greifswald) të gazsjellësit Nord Stream 2. Ashtu si binjaku i tij Nord Stream, tubacioni i ri do të shtrihet nën ujërat e Detit Baltik, duke furnizuar Europën perëndimore me gaz të ardhur nga zemra e Federatës Ruse



lidhet me tërheqjen tashmë të paralajmëruar, 8 majin e kaluar, e Shteteve të Bashkuara nga Joint Comprehensive Plan of Action, lëvizje që duket se ka krijuar një hendek në partneritetin strategjik midis Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve europiane (përfshi Mbretërinë e Bashkuar). Megjithatë, pozicioni i Trump ndaj Nord Stream 2, nëqoftëse konfirmohet, nuk vjen si një rrufe në qiell të hapur.

NJË LIGJ AD HOC

Shumë përpara raportimeve të "Wall Street Journal", Kongresi amerikan më 2 gusht 2017 kishte miratuar Public Law 115 - 44, i titulluar "Countering America's Adversaries Through Sanctions Act". Në pjesën e quajtur "Countering Russian Influence in Europa and Eurasia", në seksionin 257 (Pika 9), deklarohet shprehimisht se politika e jashtme e Shteteve të Bashkuara duhet të konsistojë edhe në vazhdimin e kundërshtimit të gazsjellësit Nord Stream 2 në konsideratë të impaktit të tij negativ ndaj stabilitetit energjetik të Bashkimit Europian dhe zhvillimit të tregut të gazit në Europën Qendro-Lindore (Ukrainë). Veç kësaj në tekst afirmohet (Pika 10) se prioriteti për Uashingtonin duhet të jetë ai i favorizimit të eksportimit të resurseve energjetike kombëtare me qëllim krijimin e punësimit në Shtetet e Bashkuara, të ndihmohen aleatët e partnerët, së fundi të for-

cohet politika e jashtme amerikane. Veç kësaj, duhet kujtuar se Kongresi më 18 dhjetor 2015 kishte votuar tashmë një masë (Consolidated Appropriations Act) për heqjen e pengesave të vjetra legislative lidhur me eksportimin e produkteve të sektorit energjetik. Sipas narratives amerikane, vendimi i marrë në 2015 i përgjigjej nevojës për të përkthyer në terma tregtarë të dhënë sipas së cilës në vitin 2013, për herë të parë në dy dekada, në Shtetet e Bashkuara sasia e naftës së papërpunuar (crude oil) të nxjerrë do ta kalonte atë të importuar. Kësaj i shtohet që në vitin 2015 sasia e përgjithshme e gazit dhe naftës (bashkëpunëtor edhe shale revolution) e nxjerrë nga Shtetet e Bashkuara do t'i kalonte ato të Rusisë e të Arabisë Saudite bashkë, duke e bërë Uashingtonin prodhuesin më të madh botëror, duke e shtyrë kështu që futej në sërën e eksportuese kryesore në tregun energjistik botëror. Nga ana tjetër, rajoni balltik përbën një zonë strategjike të rëndësishme për Shtetet e Bashkuar pasi përfaqësojnë eastern flank (në kurriz të Rusisë) të NATO-s. Jo rastësisht, më 21 gusht 2017 Lituania ka marrë furnizimin e parë me gaz natyror të lëngëzuar të ardhur me anije nga Texas. Në funksion të kësaj rrethane, Presidentja e Lituaniës Dalia Grybauskaitė ka shkruar se: "Importi i gazit amerikan në Lituani dhe në vende të tjera europiane përfaqëson një ndryshim fushe në tregun e gazit europian", pasi mund të përbëjë një mundësi për Europën që t'i japë fund varësisë së saj nga gazi rus, duke ofruar furnizime të sigurta, konkurruese dhe të diversifikuara. Për hir të së vërtetës, Lituania nuk ka qenë as vendi i parë europian që ka marrë furnizime me gaz nga përtej Atlantikut, as i pari në rajonin baltik: në qershorin e pot atij viti ka qenë Polonia ajo që marrë një ngarkesë nga Shtetet e Bashkuara, ndërsa më parë i kishte takuar tashmë Portugalisë, Spanjës dhe Mbretërisë së Bashkuar.

PARALAJMËRIMI I FRIEDMAN DHE HERA E PARË E RONALD REAGAN

Sipas "Wall Street Journal" edhe Gjermania duket se është duke e vlerësuar ofertën amerikane për të zëvendësuar apo të paktën bashkangjitur furnizimeve tradicionale ruse. Një burim gjysmëzyrtar gjerman i cituar në kushte anonimiteti nga e përditshmja në fjalë do të tregojë i hapur ndaj një hipoteze të tillë, duke zbuluar sesi problem paraqitet sidomos nga sasia e gazit që

Shtetet e Bashkuara do të ishin në gjendje të furnizonin dhe me çfarë çmimi. Përtej asaj që filtron nga shtypi amerikan, duhet marrë në konsideratë një episode që duket i lidhur me strategjinë energjetike të Uashingtonit lidhur me Europën. Në një diskutim të famshëm në Chicago Council on Global Affairs të mbajtur në vitin 2015 dhe të titulluar "Europe destined for conflict?", themeluesi i think-tank amerikan Stratfor, George Friedman, kishte nënvizuar se gjatë dekadave interesi parësor i gjeopolitikës amerikane ka qenë ajo e pengimit që midis Gjermanisë dhe Rusisë të formohej një bllok ekonomik - sipas tij - në gjendje që të përfaqëonte një kërcënim domethënës për interesat e Uashingtonit dhe, për pasojë, për rolin hegjemon të tij në anën ekstreme-perëndimore të Eurazisë. Lëvizja e Trump dhe vendimet e Kongresit shkojnë në këtë drejtim? Vetëm zhvillimet e ardhshme do të mund të na japin një përgjigje shterruese. Për momentin, duket me vend të kujtohet një precedent që i përket fazës së fundit të Luftës së Ftohtë. Bëhet fjalë për përplasjen politike që në fillimet e viteve '80 e shekullit të kaluar pa përballë Presidentin Ronald Reagan me aleatët europianoperëndimorë rreth tubacionit të ri që sovjetikët patën nisur të ndërtimin për të transportuar gaz natyror nga vendburimet e reja siberiane të Oren-goy deri në vendet europiane e përtej Perdes së Hekurt, veçanërisht Gjermaninë Perëndimore. Sipas Reagan, ky projekt shkelte sanksionet e vendosura nga Shtetet e Bashkuara ndaj regjimit sovjetik, pasi i lejonte Moskës që të shfrytëzonte teknologjinë perëndimore. Në radhë të dytë, Reagan ndjeu frikën se të ardhurat që vnin nga kontratat e nënshkuara midis Moskës dhe vendeve të Europës Perëndimore mund ta furnizonin me valutë të çmuar ekonominë stanjante sovjetike, duke kontribuar kështu që të shkelej, ose të anashkalohej më tej regjimi i sanksioneve i vendosur unilateralisht nga Uashingtoni ndaj Moskës qysh në vitet e para e Luftës së Ftohtë. Një raport i CIA-s i datës 27 mars 1983 dhe i titulluar "Soviet Gas Pipeline" e përmbledhonte kështu problemin: "Kohët e fundit Presidenti Reagan bëri një betejë të ashpër me aleatët europianë rreth gazsjellësit të ri që sovjetikët po ndërtojnë në Europë. Europianët e duan gazin sovjetik. Reagan nuk e donte që ta kishin". Në Gjermaninë Perëndimore u ndërmor edhe një fushatë sensibilizimi përsa u përket akuzave të supozuara - të quajtura gënjeshtër nga sovjetikët

- lidhur me përdorimin e të burgosurve të ndodhur në gulagët e menaxhuar nga KGB-ja për ndërtimin e pjesës sovjetike të gazsjellësit. Deri u evokua edhe spektri i nazimit kur një aktiviste e rëndësishme e të drejtave civile në Gjermani pyeti se kush - midis liderëve politikë perëndimore - do të ishte Albert Speer i radhës. Në thelb, bëhej fjalë për formulën retorike të njohur si "reductio ad Hitlerum", sot e përdorur nga shumë anë në Perëndim (Hillary Clinton, Wolfgang Schäuble, Boris Johnson) ndaj Presidentit rus Vladimir Putin.

NJË KONSTANTE HISTORIKE

Që çështjet energjetike janë ngushtësisht të lidhura me aspektet gjeopolitike, duke u përfaqësuar disa prej konstanteve kryesore gjeoekonomike, e zbulon një precedent i mëtejshëm, në disa aspekte tejet domethënës, i përfaqësuar nga përmbajtjet e serive financiare dhe ekonomike të "Studiemeve lidhur me interesat amerikane në luftë dhe në paqe" të hartuara nga Council on Foreign Relations (CFR) midis viteve 1940 e 1941. Në konkluzionet e 10 shkurtit 1941 - domethënë kur Gjermania ishte akoma mike e Bashkimit Sovjetik - pohohej: "Pika kryesore e këtyre krahasimeve (dhe e studimeve shtesë që janë bërë) është se Shtetet e Bashkuara [...] sikur të donin ta ruanin për vete një zonë tregtare që do të sillte për të një pozicion tregtar të barabartë apo edhe më të mirë se pozicionin tregtar të një Europe të dominuar gjermane, një gjë e tillë kërkon praktikisht të gjithë botën jogjermane si një zonë brenda të cilës ajo duhet të funksionojë. Në fakt, shkalla e vetëmjaftueshmërisë për botën jogjermane si një e tërë është paksa mbi 80% krahasuar me shkallën e vetëmjaftueshmërisë për zonën e dominuar gjermane prej 75%. Sikur zona e Japonisë dhe Kinës të hiqeshin nga bota jogjermane dhe [...] Rusia të përfshihej brenda botës gjermane, atëherë të dy zonat ka mundësi që të do të ishin njëjloj të barabarta në pozicion tregtar. Megjithatë, në dy aspekte, zona gjermane do të ishte akoma superiore".

Kjo analizë retrospektive na bën të kuptojmë se në çfarë mase prioriteti (që për Uashingtonin zbritet siç u pa në stinën e "Paktit Ribbentrop - Molotov") për të parandaluar shkrirjet e një aksi të qëndrueshëm gjeopolitik dhe gjeoekonomik ruso - gjerman është i ngulitur thellë në mendimin strategjik amerikan, atëherë ashtu si sot, praktikisht pa zgjidhje kontinuiteti.

NJË PËRGJIGJE NGA LIBRI I ILIR IKONOMIT PËR DEBATIN POLITIK AKTUAL

“ESAT PASHË TOPTANI NUK UA SHITI SHKODRËN MALAZEZËVE”



Sezoni politik u mbyll me palët kryesore në politikë duke shkëmbyer disa herë akuza të forta politike. Kryeministri Edi Rama deklaroi disa herë se opozita shqiptare është tradhtarë ose ‘esadiste’, një term fyes për Esat pashë Toptanin. Por cila është historia e Esat Pashës? Një nga figurat më komplekse të historisë shqiptare, për të cilin janë botuar disa libra dhe studime, por gjithnjë i vendosur ose si patriot i kulluar, ose si emblemë e tradhtisë - Esat Pashë Toptani nga historianët shqiptarë shpesh është refuzuar, duke vlerësuar studimet mbi të si një përpjekje pa vlerë. Ashtu si vetë jeta e Esat Pashës, komplekse është edhe përgjigja që jep gazetari i “Zërit të Amerikës”, Ilir Ikonimi në librin e tij studimor “Esat pashë Toptani: Njeriu, lufta dhe pushteti”, publikuar nga UET-PRESS dy vjet më parë. Gjeni më poshtë fragment nga ky libër


DORËZIMI I SHKODRËS

Trupat e Esatit po sfiliteshin nga uria. Nga mesi i prillit, në Tarabosh, Bërdicë dhe Bardhajn e Vogël kishin nisur rebelimet e shqiptarëve. Në Bërdicë Esati nuk arriti të vendosë menjëherë qetësinë, prandaj dha urdhër të pushkatoheshin 50 nga të pabindurit. Ai mendonte se kalaja mund të mbahej. As vetë malazezët nuk besonin se Shkodra mund të merrej me forcë. Gazetari Guelfo Civinini, i cili më 20 prill arriti në kampin malazez të Muriqanit, e përshkruante kështu atmosferën në shtab: “Ishte përhapur bindja se pushtimi i Shkodrës nga Mali i Zi që bëre thujtë pamundur. Prandaj, mbreti Nikollë kishte vendosur që me një përpjekje të fundit ta merrte me çdo kusht Taraboshin dhe t’i detyronte Fuqitë që t’i jepnin Malit të Zi krejt bregun e djathtë të Bunës, duke përfshirë Taraboshin. Si përgatitje për sulmin, artileria malazeze, me këshillën e majorit italian Cattagani, shkatërroi urën mbi Bunë, duke izoluar pozicionet turke të asaj ane”.

Një mbrëmje, Seadin beu, oficer i lartë turk dhe mik i Esatit, i shkoi në shtëpi pashait për të biseduar. Esati, i mërzhitur në kulm, ecte me çape të mëdha nëpër sallon. I tha Seadinit:

- Unë po bëj çfarë mundem për çështjen shqiptare, por janë ushtarët shqiptarë që më dalin kundër. Janë ata që më presin krahët. Kështu si po shkojnë punët nuk besoj se do t’ia dalim dot.

Esati vazhdonte të ecte, duke u menduar dhe duke shprehur me gishta flokët e kuqërremtë. Një çast u qetësua dhe u përpoq të ndreqë atë që sapo kishte nxjerrë goje: - Nuk duhet harruar, - tha, - se këta fshatarë të ngratë, trima e bujarë kanë dhënë gjithçka që mund të jepnin. Kanë shtatë muaj që flenë nëpër llogore, janë vrrarë e



sakatuar në luftë, kanë hequr shumë nga uria, nga të ftohtët e nga shiu dhe nuk kanë bëzajtur. Kaq shumë vuajtje njerëzore asnjë ushtri tjetër nuk do ta kishte përballuar dot. Fajtorët janë tjetërkund dhe unë e di se cilët janë. Kur këtu bëhet gjithë kjo sakrificë, janë ca të tjerë që nuk e kanë mendjen të na ndihmojnë, por duan si e si të përvetësojnë frytin e sakrificës sonë.

- Seadin, - vazhdoi Esati. - Nuk mund t’i quajmë vëllezër ata që e presin lirinë t’u vijë si lëmoshë, ata që kurdisin plane për të patur një princ francez, austriak, anglez apo italian të zgjedhur shpejt e shpejt, sikur të kërkoni një padron. Faktet e Shqipërisë janë më të larta. Unë e shkatërroj Shqipërinë nëse ajo e ul veten aq poshtë. Hiç nuk do të ngurroja.

Pashai bëri një pushim të shkurtër dhe tha:

- Seadin, e kam marrë vendimin. Nuk kthehem më prapa. Rebelimet nuk po ndaleshin. Duke u

gdhirë e shtuna, 19 prill, qindra vulnetarë braktisën llogoret dhe hynë në qytet. Shqiptarëve të rebeluar u ishin bashkuar tani edhe trupat e rregullta turke. Një batalion i Taraboshit kishte hedhur armët në llogore, pasi ishte marrë vesh se mishi që u ishte shpërndarë kishte qenë kërmë.

Atë ditë, Esati thirri në kala shefin e shtabit Abdurrahman Nafiz dhe të dy shëtitën pranë vendit ku sot është kapiteneria. Esati i tha: - Bukë nuk kemi më dhe uria sa vjen e po rëndohet. Shkodra do të bjerë, por nëse ajo bie, kjo do të ishte fatkeqësia më e madhe për mua dhe për ty personalisht. Armiqtë e mi politikë do të përfitojnë, populli do të ngrihet kundër meje dhe vuajtja ime nuk do të ketë fund. Ç’mendon?

Nafizi u përgjigj:

- Nuk e përfytyroj dot se si mund ta dorëzohet Shkodrën. Por e vërteta është se ushqim nuk kemi dhe populli po vuan. Nëse ky është fundi, atëherë le ta mbyllim me

nder. Të çajmë rrethimin dhe kush të shpëtojë të shpëtojë, kush të vdesë të vdesë.

Esati nuk foli, por një ditë më vonë thirri komandantët. Mbledhja u bë në kala, në sallën e armëve, dhe u shqyrtua ajo pjesë e rregullores ushtarake, ku flitej se në ç’kushte mund të jepeshin fortesat. Pas një diskutimi të gjatë, u vendos dorëzimi për shkak të urisë. Shtatmadhuria paraqiti një justifikim me shkrim ku renditeshin arsyet: mungesa e ushqimit, rebelimet mes rezervistëve shqiptarë, pamundësia për të çarë frontin armik dhe rreziku i asgjësimit të ushtrisë, në qoftë se përpjekja dështonte. Komandantët nënshkruan me radhë. Esati vendosi të dërgojë oficerët e shtabit, Nafizin dhe Qeramudinin në Mal të Zi me një letër për Princin Danilo. Në fillim Nafizi nuk pranoi, sepse nuk donte që në letër të përmendej fjala dorëzim. Pas diskutimeve me Esatin ai u bind dhe ndërkaq fjala poshtëruese u hoq nga teksti.

Ishte 20 prill, e diel pasdite, kur dy oficerët u nisën me anijen e blinduar Mesudije që ndodhej e ankoruar përpara doganës. Anija mbante flamurin e Turqisë dhe një tjetër të bardhë. Kur oficerët arritën në Zogaj, një kapiten malazez shtatmadh u lidhi sytë të ardhurve dhe i përcolli për në shtabin e gjeneralit Janko Vukotić. Me t’u njoftuar me telegraf, princi Danilo u nis nga Cetina dhe rreth orës 10 të mbrëmjes erdhi në Zogaj me një anije të vogël. Pastaj kërkoi që dy oficerët turq ta takonin në bord.

Letra që këta kishin sjellë ishte në turqisht dhe pak a shumë në të thuhej: “Nisur nga gjendja e tanishme, gjykoj se vazhdimi i mbrojtjes së kalasë është një gjakderdhje e kotë nga të dyja anët. Meqenëse edhe ju mendoni njëllë, ju lutem të dërgoni në Shkodër njerëzit tuaj për të negociuar së bashku kushtet e nevojshme. Pranoni nderimet e mia. Valiu dhe komandanti i korpusit të Shkodrës, Esat.”

Princi tha se me shprehjen “kushtet e nevojshme” ai kuptonte dorëzimin, por dy oficerët u përgjigjën se nuk kishin ardhur të bisedonin për këtë dhe se nuk mund të bënin interpretimin e asaj që ishte shkruar në letër. Siç shihet nga këto veprime të oficerëve, ndonëse thelbi i vizitës ishte dorëzimi i Shkodrës, në librin e tyre ata përpiqen të tregojnë se në këtë pikë nuk mbajnë asnjë përgjegjësi. Daniloja ngarkoi gjeneralin Vukotić për të biseduar me Esatin dhe oficerët turq u kthyen në Shkodër po atë mbrëmje. Mali i Zi bllokoi menjëherë shërbimin postar. Mbreti Nikollë dha urdhër që asnjë letër apo telegram të mos dilte nga Mali i Zi pa përfunduar bisedimet. Askush jashtë mbretërisë së vogël nuk duhej të dinte se Esati kishte ndërmend të dorëzohej. Të hënën, më 21 prill, në orën 9 të mëngjesit, Vukotići arriti

në doganën e Shkodrës në shoqërinë e Pllamenacit dhe një adjutant të princit.

Të ardhurit u pritën nga Esat Pasha, Nafizi dhe Qeramudini dhe u ftuan në një dhomë të rregulluar për miq në katin e dytë të ndërtesës. Pa u ulur mirë, Vukotiçi, ky malazez trupmadh e përherë i vrenjtur, iu drejtua Esatit:

- Shkëlqesë, ja ku kemi ardhur me kërkesën tuaj. Jemi ushtarë dhe ndodhemi ende në luftë. Le të hyjmë drejt e në temë, nuk kemi përse zgjatemi.

Esat Pasha zbërtheu dy kopsa të xhakëtës, pastaj nxori ngadalë nga xhepi një copë letër të palosur dhe e vuri mbi tryezë.

- Shkëlqesë, - tha ai, - mbrojtja e mëtejshme e kalasë nuk është e mundur. Prandaj, pardje në mëngjes thirra gjithë komandantët për të biseduar dhe vendosëm ta dorëzohet. Shikoni! - tha Esati dhe tregoi tekstin e letrës me nënshkrimet.

- Ky është vendimi ynë. Dhe këto janë firmat e të gjithë komandantëve që kanë të drejtën e votës për çdo vendim. Mbi bazën e kësaj zgjidhjeje, i dërgova edhe princit Danilo letrën për mbretin. Por, në kohën që njerëzit e mi ndodheshin tek ju, gjërat morën një kthesë të papritur, sepse në pozicionet tona në Bërdicë erdhën disa përfaqësues serbë me flamur të bardhë. Njerëzit e mi i pritën, por serbët filluan të bërtasin me sa kishin në kokë: Lufta mbaroi! Tani jemi në paqe! Jemi miq! Atje na dhanë edhe këtë, - tha Esati dhe i dorëzoi Vukotiçit një letër, të cilën ky ia kaloi Pllamenacit.

- Serbët, - vazhdoi Esati, - na kërkuar leje për të hyrë në qytet. Pasi u informova me telefon për gjithçka, i lejova të hyjnë. Ata shëtitën gjatë në Shkodër. Blenë bizhuteri dhe biseduan me njerëzit në rrugë, të cilëve u thane hapur se lufta kishte mbaruar, se ushtria e tyre do të largohej nga Shkodra, se flota europiane ndodhej në ujërat malazeze dhe se e kishte bllokuar Malin e Zi.

Fjalët e tyre u përhapën si rufe kudo në Shkodër dhe në të gjitha pozicionet. Njerëzit tani ishin të gëzuar se nuk do t'u dorëzoheshin malazezëve, duke shpresuar se ushtritë europiane do të vinin t'i shpëtonin. Komandantët nga të gjitha pozicionet në Shkodër më uruan me telegram që e mbajta kalanë. Ja, shikoni, -tha Esati dhe i tregoi gjeneralit malazez një vanda me telegrame. -Pas kësaj i trajtova përfaqësuesit serbë si miq dhe i lashë të shkonin për të pare robërit e tyre e për të biseduar me ta. Për të gjitha këto, Shkëlqesë, konsideroj se lufta ka mbaruar dhe me këtë ka marrë fund edhe çështja e Shkodrës. Vukotiçi u kthye nga Pllamenaci dhe e pyeti:

- Petre, ç'është ajo letër?

- Çudi, - u përgjigj Pllamenaci. - Komandanti i një farë garnizoni serb, paska sjellë një telegram nga Veziri i Madh i Turqisë drejtuar komandantit të Shkodrës. E pabesues-

shme!

Telegrami ishte në frëngjisht dhe aty thuhej: "Komandantit të Shkodrës. Nën trysinë e forcave europiane, ushtria serbe do të largohet nga Shqipëria. Mos i ndiqni. Veziri i Madh."

Vukotiçi iu drejtua Esatit:

- Shkëlqesë, nuk është e vërtetë që është vendosur paqja. Para se ne ta marrim Shkodrën nuk do të ketë paqe. Sepse ne malazetët, nga mbreti e deri te ushtari i fundit, do të vdesim në kala nëse nuk e marrim qytetin. Sidoqoftë, na lejoni të ikim nga erdhëm. Dhe kur të kthehem te garnizoni im, ju dhe shkoderanët do të shihni nëse është vendosur apo jo paqja.

Kur Vukotiçi po matej t'i jepte dorën Esatit, ky i kërkoi të rrinte edhe ca dhe të vazhdonin bisedën. Gjenerali malazez i tha:

- Nuk ka ç'të flasim më, veç nëse ju e dorëzoni Shkodrën menjëherë. Përndryshe unë iki.

Gjithnjë sipas rrëfimit të Vukotiçit, Esati u përgjigj:

- Unë personalisht nuk mundem dhe nuk kam të drejtë të nënshkruaj marrëveshje për tërheqjen nga kalaja, prandaj duhet që përsëri të thërras këshillin ushtarak dhe këtë do ta bëj sot. Nëse janë dakord, ata do të vënë firmat dhe çdo gjë do të jetë në rregull. Nëse jo, ju jap fjalën e nderit se ushtarët, që u binden urdhrave të mia dhe që janë gati gjysma, do të dorëzohen te ju.

Unë vetë do të vij të jetoj në Mal të Zi dhe ju mund të më bëni ç'të doni. Ishte e qartë se Esati po përpiqej t'i hiqte zvarrë bisedimet, pasi tani ai kishte mësuar diçka të re: se ushtria serbe ishte tërhequr, se flota ndërkombëtare kishte bllokuar bregdetin e Malit të Zi dhe se Fuqitë kishin marrë një vendim për Shkodrën. U ra dakord që, të nesërmen, më 22 prill, njerëzit e Esatit të shkonin përsëri në kampin malazez.

Me t'u kthyer Vukotiçi në shtabin e tij, mbi Shkodrën dhe mbi pozicionet rreth saj u hap zjarr me të gjitha armët. Predhat binin si breshër. Bombardohej sidomos Bërdica, e cila kishte qenë objekt i

topave të ushtrisë serbe. I gjithë ky zjarr, që dukej sikur do t'i çante më dysh tokën dhe ujërat e Shkodrës, kishte një qëllim të vetëm: t'u tregonte mbrojtësve se nuk bëhej fjalë për paqe dhe se ushtria malazeze nuk ishte dobësuar si pasojë e tërheqjes së serbëve. 186 Ferri i natës zgjati deri në orën 9 të mëngjesit, kur në horizont u dukën të dërguarit e Esatit, Nafiz dhe Qeramudin, të cilët u pritën nga Princi Danilo në anijen e tij.

Të ardhurit i dorëzuan princit një tjetër letër nga Esati, i cili shkruante se do të largohej nga kalaja, por me dinjitet, pra kërkonte që ushtarët të lejoheshin të iknin bashkë me armët, duke përfshirë çdo gjë: topat, anijet dhe armatimet e tjera.

Kjo nuk i pëlqeu Danillos. Në letrën e parë topat nuk përmendeshin, ndërsa tani Esati kërkonte t'i merrte me vete dhe këtë princ nuk mund ta lejonte, sepse kishte dobësi për topat e shpejtë të turqve. Vukotiçi u përpoq t'i mbushte mendjen. I tha se kur Esat Pasha shkroi letrën e parë, ai nuk e dinte se ushtria serbe po ikte dhe se forcat europiane po e shtrëngonin Malin e Zi të hiqte rrethimin e Shkodrës. Tani gjërat kishin ndryshuar. Prandaj le t'i merrte topat Esati.

U vendos që Vukotiçi të shkante prapë për të biseduar me pashain. Gjenerali malazez dhe shoqëruarit arritën në doganën e Shkodrës në orën 11 paradite. Bisedimet u hapën me çështjen e topave. Pllamenaci nguli këmbë që e gjithë artileria turke t'i mbetej Malit të Zi dhe menjëherë pas kësaj filloi grindja.

Atëherë foli Vukotiçi, i cili propozoi që Pllamenaci dhe Qeramudini të hidhnin në letër pikat kryesore të ujdisë, pra që ushtria e Esatit të tërhiqej dhe të merrte me vete pajisjet dhe armatimet. Ishte e martë pasdite. Esati urdhëroi që konsujve në Shkodër t'u shpërndahej një komunikatë, në të cilën thuhej se ushtria kishte rezistuar gjatë muaj pa asnjë ndihmë, duke përbaluar të gjitha shkatërrimet dhe privimet. U bë e qartë se

dorëzimi ishte punë e kryer.

Mirëpo në doganë negociatat nuk kishin mbaruar, sepse shumë hollësi nuk ishin sqaruar. Kur u shtrua pyetja se në ç'kohë dhe në ç'mënyrë do të largohej nga Shkodra ushtria mbrojtëse, Vukotiçi propozoi që kjo të bëhej të nesërmen në orën 6 të mëngjesit. Me të dëgjuar këtë, Esati brofi në këmbë, vetullat iu ngritën përpjetë dhe tha se kjo nuk ishte e mundur, sepse i duhej kohë të përgatiste ushtarët për marshimin, për më tepër trupat nuk mund ta kalonin dot Drinin për të dalë nga Shkodra, sepse ura e Bahçallëkut ishte prishur dhe duheshin tri-katër ditë për ta ndrequr. Vukotiçi propozoi që trupat e Esatit të linin pozicionet herët në mëngjesin e 23 prillit dhe të grumbulloheshin në qendër të Shkodrës. "Pas kësaj, -tha ai, - trupat tona do të marrin pozicionet dhe ju keni kohë sa të doni për t'u përgatitur." Por Esati u përgjigj se kjo do të ishte e rrezikshme, pasi dy ushtritë do ta gjenin veten përballë njëra-tjetrës dhe malazetët mund të hakmerreshin.

Sipas kujtimeve të Vukotiçit, gjatë diskutimit që vazhdoi deri në mesnatë, ai disa herë i kërkoi Esat Pashës të shënonte kohën dhe mënyrën se si do të largohej nga secili pozicion dhe pastaj të nënshkruante marrëveshjen. "Nëse nuk pranohet, - i tha, - më mirë më lër të iki dhe le të fillojnë përsëri luftimet." 189 "Esati, - kujton Vukotiçi, - herë-herë dilte nga dhoma për të biseduar me parinë e Shkodrës dhe, çdo herë që kthehej, na kërkonte të prisnim edhe dy-tri ditë para se të dorëzonte pozicionet."

Siç duket, bisedat e tij me parinë nuk ishin të lehta. Esati u shpjegonte atyre gjendjen dhe vendimin për të braktisur qytetin, duke u thënë se kush dëshironte mund të largohej bashkë me ushtrinë. Mes tij dhe parisë u shkëmbyen fjalë të ashpra. Siç tregon Gino Berri, gjashtë të krishterët e pranishëm, ndonëse dukeshin të brengosur për rënien e qytetit dhe të gatshëm për të bërë sakrificë, thanë se komuniteti i tyre

ishte në kushte tepër të trishtueshme dhe se numri i të vdekurve nga uria rritej çdo ditë. Shumica e myslimanëve thanë se as ata nuk mund të jepnin ndonjë ndihmë me vlerë për t'i rezistuar rrethimit. Megjithatë, disa propozuan që të bëhej edhe një përpjekje, për ta shtyrë edhe ca ditë. Njëri prej tyre, Sulçe beu, i ofroi valiut njëqind lopë dhe tha se këtyre do t'u shtoheshin së shpejti po aq të tjera. Por Esati e ndërpreu me një gjest zemërimi:

- Nëse ke vetëm kaq për të thënë, më mirë kurseji fjalët! Është qesharake të ofrosh dyqind a treqind lopë për njëzet mijë njerëz që ushqehen keq prej një muaji. Është cinike të bësh këtë ofertë tani që i kam helmuar ushtarët e mi me kërmat e kuajve.

Esati tha se askush nuk mund ta mësonte se si ta kryente detyrën e tij.

- Kur them që dorëzimi është i domosdoshëm, - vazhdoi ai, - kjo do të thotë se kam pritur deri në çastin e fundit, përtej të cilit nuk mund të vazhdohej më pa cenuar dinjitetin dhe nderin tonë. Shihni si janë katandisur ushtarët. Nuk na ka mbetur asnjë thes miell. Racioni për sonte ishte një gjysmë peksimadhe dhe një grusht stafidhe. Kam dymijë të sëmure dhe të plagosur nëpër spitale. Municionet e topave thuajse janë shteruar dhe një sulmi malazez nuk i përgjigjem dot më gjatë se 15 minuta me artileri. Nuk ju ka lezet të bëni patriotizëm në orën e fundit.

Esati heshti pak dhe nisi të flasë me një ton më të butë:

- Harroni për një çast se jeni tregtarë. Ajo që ndodhi ndoshta ishte e pashmangshme. Por nuk e di nëse e keni ndërgjegjen të qetë. Në qoftë se Turqia po humbet një krahinë, kujdes se mos humbisni atdheun tuaj. Unë do të iki bashkë me ata që mbetën gjallë nga ky rrethim i lavdishëm, por po ju lë atë që është më e shtrenjtë: të vdekurit.

Ndërkaq, gjatë gjithë kohës që brenda doganës vazhdonte kjo betejë e fundit, ku njëra palë ishte në agoni dhe në ankth, ndërsa tjetra mezi ç'priste ta shtrëngonte fort në dorë fitoren, malazetët nuk e ndalën demonstrimin e forcës. Ata e goditën qytetin me mbi 300 predha.

"Pasi kaloi mesnata, - tregon Vukotiçi, - u ngrita dhe i thashë prerë Esat Pashës: ose të vëmë firmat, ose unë dhe njerëzit e mi ikim nga Shkodra. Esati tha: a mund të prisni edhe një çast? Dhe doli. Nuk kishin kaluar as pesë minuta, kur ai u kthye, u ul në tryezë, nxori vulën, e vendosi mbi marrëveshje, pastaj mbi kopjen e saj dhe i nënshkroi të dyja. Në këto e sipër, ai shante nëpër dhembë parinë e Shkodrës: Sojsëza! Ju që nuk deshët të më jepnit as njëqind lopë për ushtrinë, më kërkoni tani të mbroj qytetin!" Ishte data 23 prill, pak pas mesnate.

(Fragment nga libri "Esat Pashë Toptani. Njeriu, Lufta, Pushteti")



Profili krijues i Salajdin SALIHUT

Salajdin Salihu, lindur më 26 maj të vitit 1970 në Tetovë. Ai i përket brezit të rokut, i çliruar nga kompleksët dhe i zhveshur nga iluzionet; me pikëpamje dhe qëndrime më liberale ndaj jetës, që thinjet para baballarëve të tyre.

Salajdin Salihu është autor i disa librave: "Vdes pas gjërave të imëta" (poezi dhe tregime), "Panteoni i utopisë" (ese), "Nata e parë e pushtimit" (poezi dhe tregime), "Edhe ne dëshmojmë" (koautor, publicistikë), "Cjurmë" (ese), "Cënjeshtër e sinqertë" (poezi), "Natë e blertë vetmie" (poezi në shqip dhe maqedonisht), "Digresione I-II" (ese), "Gazetaria – Njohuri të përgjithshme" (libër universitar), "Vonë për gjëra të turpshme" (poezi), "Zë në shkretëtirë" (ese). Ka përkthyer librin "Përmbledhja sarajevase e luftës" të Izet Sarajliqit si dhe poezie ese të shumë autorëve prej letërsive të ndryshme. Poezitë e tij janë përfshirë nëpër shumë antologji kombëtare e ndërkombëtare. Shkrimet letrare dhe prozë të ideve dhe janë përkthyer në disa gjuhë: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, maqedonisht, boshnjakisht, greqisht, turqisht, ukrainisht, bullgarisht, greqisht, sllovenisht, në gjuhën malazeze etj. Është fitues i disa çmimeve kombëtare e ndërkombëtare për letërsi. Një periudhë të gjatë ka punuar edhe në media të ndryshme në gjuhën shqipe dhe të huaj. Është fitues i disa çmimeve letrare në plan kombëtar e ndërkombëtar. Ka doktoruar në Universitetin e Shkupit dhe aktualisht është ligjërues në Fakultetin e Filologjisë në USHT. Salajdin Salihu është autor i një diksioni poetik rezonant... krijon jo vetëm një imazh filozofik, por edhe një "koncentrat" të paharueshëm ekonomik në poezinë e shkurtër "Sytë"... Germat ose "qeniet e zeza" janë një "lidhje" e "syve të rinj". E kur "i verbëri" shikon nëpërmjet tyre atëherë kjo është më kristalorja deri në përsosmëri: është mendimi, poezia, sikurse edhe vdekja! Një zë i spikatun individual në poezinë e brezit të tij. Duke folur për poezinë arrire që ai e ka krijuar, Saladin Salihu, në një rast ka thënë: "Krejt varet nga çasti. Ndonjëherë mendoj se mund të jetë njëra e pas një kohë them se e tillë mund të jetë një tjetër poezi. Ndonjëherë më mundon një pasiguri totale dhe sa nuk them se asgjë nuk e kam shkruar ashtu siç do të duhej. Ndjenja e pasigurisë e shoqëron çdo krijues. Dikur më frikësonte kjo ndjenjë, por kur lexoja Stefan Cvajgun, ndjeva një lehtësim. E njëjta ndjenjë e kishte shoqëruar përgjatë jetës. Jo vetëm Cvajgun, por edhe shkrimtarë të tjerë, si për shembull: Franc Kafkën. Ai madje la një dhiatë që librat e tij të digjeshin, ngase nuk ishte i sigurt për vlerën e tyre. Falë Maks Brodit, që e "tradhtoi", sot i lexojmë kryeveprat që zjarri do t'i kishte kthyer në harresë të përgjithmonshme. E kështu me radhë, me shumë krijues të tjerë, si p.sh. Tolstoi, Nabokovi, por edhe të tjerë që kaluan në ekstrem dhe i dogjën veprat e tyre.



SALAJDIN SALIHU

MUZG OHRI

(Fragment)

*Ndë një vjetë të largët ndë Ohri
Progon Zguri heteriarku
Puthte një Evdoki
Dhe Andrej Gropa mëpastaj
puthte Anën a Kiranën
Pranë klishës Shën Sofi
Dhe ra terri mbi historinë
Mbi Progonin dhe Andrenë
Mbi Kiranën e Evdokinë
Ndë asnjë altar ndë asnjë klishë
As edhe një fjalë më nuk kumbon
Nga e ambla gluhë arbërisht*

STATUJA E ESENINIT

*pranë statujës shkëmbejmë puthje
vargjet e tij i merr era e lehtë
me shikimin e tij prej gipsi na miklon
sikur thotë:
ah, të kthehesha edhe njëherë në jetë
sërish do të doja vajzat
sërish do të isha poet
tani jam vetëm qenie prej gipsi
një statujë që s'mund të flas përsëri
po ju nuk m'i ndjeni dridhjet
zjarrin për gratë nuk e shihni assesi
vajza vetëm për ju kam lerë
që t'ua vjel përjetësinë...*

*pranë statujës së eseninit shkëmbejmë puthje...
e ai më shikon me xheloz...*

DIKTATORE E TMERRSHME E ADHURUAR

*ti je kudo
në këtë botë të vogël*

*ti je kudo
në këtë botë të tmerrshme*

*s'të flak dot
si copë të hidhur pështyme*

*sundon qenien time
si diktatore e tmerrshme e adhuruar*

AQ SA PREKET E PUSHTOHET TYMI

*i mbështjellë me heshtjen e kësaj mbrëmje
këndoj një këngë për një vashë sy ulliri
drini zi i heshtur si mendimtar
rrjedh mes për mes qytetit me shumë ura
nga kutia e cigareve plot numra telefoni
nxjerr një mikeshë dhe e thith dashurisht
në tymin dredha - dredha shfaqet imazhi saj
dua ta prek ta ndiej ta puth ta pushtoj...
e prek e ndiej e puth e pushtoj...
aq sa preket ndjehet puthet pushtohet tymin...*

*vetëm një klithje është jeta, më tha
pastaj u bë re
që atëherë dal të më lagë shiu...*

*u shuan dritat nisi loja
ti hyre qetë në jetën time
e heshtur e pushtuar si troja*

*në pemë lëvaret vjeshta
zverdhen ëndrrat
vyshten buzëqeshjet*

DITA GDHIN YJET PËRHUMBEN

*dita gdhin
yjet e kujtimeve përumben
në qiellin e madh të bezdisë
mbi tavolinën ku është shtruar trishtimi
mbështetet vetmia
si plakë e pashpresë
me veg zhgënjimi
thurë emblemën e humbjes
a fitores
në flamurin e bardhë të ngushëllimit*

“GRUAJA E THYER”, SIMONE DE BEAUVOIR

Një grua që zbulon se bashkëshorti i saj ka një lidhje jashtëmartesore, dhe bota e saj pikërisht në këtë moment fillon e shkërmoqet

“Gruaja e thyer” është një vepër nga Simone de Beauvoir, e cila u publikua në vitin 1967. Një libër i cili përmban tre histori që na tërheqin në jetën e tri grave që janë në moshë të mesme, të cilat përballen me kriza të papritura. Libri është sjellë në shqip nga Botimet Pegi dhe bën pjesë në koleksionin Lotus.

“Ajo hakmerret falë monologut” (Flober). Një thënie që i vendoset para tregimit, si për të na lënë pezull që në gërmat e para. Monolog, është tregimi i dytë i veprës “Gruaja e thyer”. Këtu kemi të bëjmë me një grua të llastuar, që gjendet e vetme në natën e vitit të ri, dhe nëpërmjet një monologu vjell vërin e zhgënjimeve të një jete. Beauvoir, në këtë tregim është



munduar ta trajtoj femrën ndryshe, ta zhveshë dhe të flasë me zërin e saj të brendshëm, me një pjesë që aq sa “e shëmtuar” mund të duket së jashtmi aq dhe e bukur vjen njëkohësisht. Këto femra në këtë libër nuk kanë heronj, dhe sidomos në tregimin “Monolog”, por mbase heroin, ne mund ta imagjinojmë. Vetë monologu i saj është një shpëtim, si për ti thënë vetes që nuk është vetëm, dhe pse në të vërtetë si lexuesi, dhe personazhi kryesor e di dhe e sheh

qartë ngjarjen reale.

Ky është tregimi nga ku ky libër ka marrë dhe titullin. Një grua që zbulon se bashkëshorti i saj ka një lidhje jashtëmartesore, dhe bota e saj pikërisht në këtë moment fillon e shkërmoqet. E gjithë historia është shkruar në formën e një ditari. Mënyra e përshkrimit të situatave dhe e ndjenjës së brendshme të kësaj gruaje, na nxit për të ditur nëse ajo do e shpëtoj vetveten nga ky burg që i ka ngritur vetes, apo thjesht

do ti lejojë gjërat ta vrasin. Duket se në të treja tregimet, Beauvoir na i ka sjellë të treja personazhet e saj në varësi nga meshkujt që kanë përkrahë. “Jam e frikësuar”, kështu mbyllet dhe tregimi i fundit, si për të na treguar, se shpëtimi jemi vetëm ne, dhe kur presim, duhet të dimë mirë se çfarë presim, sepse ndoshta drita që ne kërkojmë nuk do të shfaqet kurrë. Ky është koleksioni i tre tregimeve të Simone de Beauvoir, në librin “Gruaja e thyer”, i cili përqendrohet tek disa gra që e kanë kaluar rininë e tyre, dhe po përjetojnë kriza të papritura. Ato mendojnë se jeta e tyre është shkërmoqur, dhe se gjithçka që ato mendonin se e njihnin papritmas bëhet e huaj. Të treja tregimet duket sikur janë shkruar nga autorë të ndryshëm, kjo për shak të stilit, që tre tregimet e kanë të ndryshëm nga njëri-tjetri. Ua sugjeroj për ta lexuar këtë libër sepse do ta shihni femrën të trajtuar ndryshe, i kapur nga një këndvështrim, i cili nga rutina apo dhe nga “rehatia” harrojmë ta shohim.



“E vërteta mbi çështjen e Herri Kjubert”, Joël Dicker

Historia e këtij romani voluminoz është historia e të gjithë librave të botës. Në paragrafët e mëposhtëm do tregoj se si autori duke treguar një histori magjepsëse, ka shkruar dhe një guidë se si shkruhen librat.

Romani në qendër mban historinë e dy shkrimtarëve Herri Kjubert dhe Markus Goldman. Herri është një shkrimtar i famshëm i cili, akuzohet për vrasjen e Nolës, tridhjetë e tre vite pas zhdukjes së saj, pasi trupi i kësaj të fundit gjendet i varrosur në shtëpinë e tij. Markus është një shkrimtar i suksesshëm, por duket sikur ky sukses ia ka prerë frymëzimin dhe nuk shkruan dot. Afati për dorëzimin e romanit të tij, po afrohet dhe ende nuk është në hapat e parë të librit. Arrestimi i mikut të tij më të mirë, shërbën si një shkundje për Markusin. Ai vendos të hetojë ngjarjen dhe të shkruajë dhe një roman për të vërtetën e çështjes së Herrit. Tek flet me njerëzit e zonës dhe përpiqet të kthejë kohën tridhjetë e tre vite më parë, Herri zbulon më shumë se një të vërtetë. Ajo vdekje mban me vete sekretet e një jete të suksesshme si shkrimtar, mban një dashuri “të ndaluar”, mban tradhti dhe frikë. Kur e mbylla këtë roman, kisha bërë një listë me pyetje, ashtu siç bëj për çdo libër, për të kuptuar dhe nëse unë kam qenë në gjendje t’a kuptoj vërtetë romanin. Kur po mbylla librin iu riktheva dhe në herë fragmentit tim të preferuar në libër, që përmban dhe gjithë kolonën e guidës për mënyrën si shkruhet një libër. Fragmentin lexojë më postojë më poshtë dhe pas kësaj, vrapo të marrësh librin. Siç e thashë kanë kaluar thajse tre vite që kur është në treg dhe akoma vazhdon të jetë një best seller në Shqipëri e kudo.




Vdes regjisori kosovar Bekim Lumi

Ka vdekur regjisori i njohur kosovar Bekim Lumi. Lajmin e ka konfirmuar në rrjetin social edhe dramaturgu kosovar, Jeton Neziraj. “Rest In Peace, Bekim Lumi”, ka shkruar ai. Regjisori dhe profesori i njohur i Fakultetit të Arteve në Prishtinë, Bekim Lumi, që prej dy vitesh po përballej me një sëmundje të rëndë. Për vdekjen e tij, ka shkruar edhe kryeministri Ramush Haradinaj, duke thënë se ikja e tij e hershme do të zbrazëti në shoqërinë tonë. “Pikëllues lajmi për kalimin në amshim të regjisorit Bekim Lumi, ndër më të veçantët në artin skenik të Kosovës. Ikja e hershme e Lumit ka lënë një zbrastësi të madhe në familje, shoqëri dhe sidomos në artin e regjisë. Ai nuk reshiti për tre dekada me radhë t’i jepte vulën e tij origjinale artit dramatik të Kosovës. Ngushëllime të sinqerta familjes Lumi, të gjithë atyre artistëve që punuan më të si dhe miqve të shumtë. I qoftë i lehtë dheu i Kosovës”, ka shkruar ai. Ndërkohë edhe presidenti Hashim Thaçi ka ngushëlluar për humbjen e tij. “I dhimbshëm lajmi për vdekjen e parakohshme të mikut tim, Bekim Lumi. Si artist e si regjisor, Bekim Lumi kontribuoi shumë për artin, teatrin, kulturën dhe për edukimin e artistëve të rinj. Ngushëllime familjes Lumi dhe të gjithë artistëve, miqve dhe bashkëpunëtorëve të tij”, ka shkruar ai.

“David Golder”, Irene Nemirovsky

“David Golder” të shkrimtares Irene Nemirovsky. është një roman i mrekullueshëm që arrin të tejkalojë parashikimet e një lexuesi të mirë, kur gjen faqet e para, ngjashmëri me Xha Gorioin e Balzakut. Një roman që në qendër ka egon për të patur sa më shumë para, kundrejt vlerës njerëzore që mund të blesh me të. Historia e një çifuti bankieri të pamëshirshëm në hapat e fundit të jetës. Një përshkrim i rreptë i borgjezisë që gllabërohet nga depresioni i madh. Maska që bien përpara vdekjes dhe në fund nevojë për të pas dikë që të ka dashur. Në kohën

e Depresionit të madh (1929-1933), borgjezia në shumë vende ra nga pedestali ku gjendej për shkak të krizës ekonomike dhe hiperinflacionit. Të gjetur ngushtë, shumë njerëz po përpiqeshin të shpëtonin ato pasuri që kishin grumbulluar, një ndër ta dhe Golderi. Tek rrëfen hap pas hapi sesi ka arritur gjer aty ku është, ai trajton dhe mardhënien me të shoqen dhe të bijën, dy gra interesaxhie që kanë vrapuar gjithmonë pas pasurisë së Golderit. Ndonëse ka bërë gjithmonë një sy qorr e një vesh shurdh, tek gjendet në greminën e vdekjes ai kërkon pak vëmendje



dhe dashuri. Sa thjesht mund të shitet dashuria një blerësi?! A ekziston një ndjenjë e vërtetë mes të pushtetshmit dhe atij që jeton nga këto të ardhura? Sa të shëndetshme janë familjet që ngrihen mbi luksin e gjithçkaje? Libër që duhet të jetë në bibliotekën tuaj.

Jeta e fshehte e Salvador Dalisë, e treguar nga ai vetë

Salvador Dali ka qenë një nga figurat më interesante dhe më provokuese në artin e shekullit të njëzet. Një pionier i surrealizmit, ai është admiruar dhe sulmuar për imagjinatën e subkoshiençës që projektoi në pikturën e tij, së cilës disa herë i referohej si “fotografi ëndrre e pikturuar me dorë”. Kushdo që është i interesuar për artin e shekullit të njëzetë dhe për një nga figurat më karizmatike dhe më të talentuara të këtij shekulli, duhet të lexojë patjetër “Jetën e fshehtë e Salvador Dalisë”. “Jeta e fshehte e Salvador Dalisë, e treguar nga ai vetë”, është një libër që çdokush që do e lexojë do ndikohet për ta parë çdo gjë që e rrethon ndryshe. Kjo për lexuesin fillon që në leximin e titujve dhe nëntitujve që përmban libri, si: “Kujtime brenda barkut të nënës”, “Përvetësimi i lavdisë”, “Zbulimi i makinës së fotografimit të mendimeve”, etj.

Ky është një libër autobiografik



i shkruajtur nga vetë Salvador Dali, që zgjat deri në fund të tridhjetave. Gjithçka në libër, si nga bëmat e jetës, përshkrimet e tij janë të paparashikueshme dhe provokuese, aq sa dhe arti i tij. Në faqet para sapo fillon historia, është një nënshkrim i vogël që thotë “Gala-gradives, asaj që më udhëhoqi”, mirënjohjen e parë të kësaj biografie të hershme, të shkruar nga ai

vetë duket se ia jep bashkëshortes së tij, ku përveç emrit, i ka vënë dhe prapashtesën Gradiva. “Gradiva” është romani i V.Jensenit, i cituar nga Zigmund Frojdi në veprën “Gradiva e V.Jensenit”, ku heroina e heroit dhe pikërisht këtë ka bërë Gala dhe me Salvadorin, ajo e shëroi falë dashurisë së saj të pashembullt dhe të pafund, thellësia e së cilës u shfaq në praktikë dhe i tejkaloi të gjitha mënyrat më ambicioze të psikanalizës për Salvadorin. Ky libër, e sjell autobiografinë ndryshe, nga pyetjet retorike që vetë Salvadori ia drejton vetes. Papritur dhe ti e gjen veten duke i drejtuar personit tënd pyetje te tilla, një libër frymëzues për ta bërë dhe lexuesin ta shikojë jetën e vet në imtësitë që asnjëherë si ka parë. Me këtë libër do njihni veten dhe Salvador Dalin, që fillon nga kujtimet e tij brenda barkut të nënës, e deri në pikën ku ai arrin të prekë qiellin me dorë.



Arrestohet i dyshuari kryesor për zjarret në Greqi

Një burrë 65 vjeçar është arrestuar si i dyshuar kryesor për shkaktimin e zjarreve në Atikën lindore, në të cilat humbën jetën 91 persona, ndërsa 25 njerëz llogariten si të zhdukur. I arrestuari, identiteti i të cilit nuk është zbuluar, gjoja është banor i qytetit në pjesën veriore të Atikës, Penteli, citon televizioni grek "Skaj". Sipas fqinjëve të tij, ai edhe në të kaluarën u ka vënë zjarrin mbeburinave dhe degëve të thata, ndërsa para prokurorisë kanë dëshmuar nëntë persona të cilët e llogarisin përgjegjës për shkaktimin e zjarreve. I dyshuari gjoja ka djegur bar dhe degë të thata në kodrën mbi Pentelin kur shkëndijat shpejt e kanë përfshirë edhe vegetacionin tjetër. Për shkak të temperaturave të larta dhe erërave të fuqishme të cilat fryjnë në rajon, zjarri është përhapur shpejt dhe ka marrë përmasa të mëdha. Siç transmeton "Skaj" prejse e ka kuptuar se sa është përhapur zjarri, ndërsa veçanërisht pas rrjedhave tragjike, burri i dyshuar është munduar t'i fshehtë gjurmët me dhe, ujë dhe baltë, në pikën fillestare prej ku është shkaktuar zjarri.

200 konteste për vijën kufitare me Serbinë

Vendosja e një table kufitare nga ana e KFOR-it në fshatin Karaçevë të Kamenicës ka shqetësuar banorët e këtij fshati, megjithëse KFOR-i ka sqaruar se nuk bëhet fjalë për lëvizje të kufirit, porse vetëm ka zëvendësuar tabelën e vjetër. Deputetë të Kuvendit të Kosovës të dielën kanë vizituar Karaçevën dhe thonë se 170 deri në 180 pronarë kanë shprehur shqetësimin e tyre për fatin që do t'i kenë tokat e tyre pas demarkimit të kufirit me Serbinë që pritet të ndodhë pas arritjes së marrëveshjes finale Kosovë-Serbi. Megjithatë kontesti kufitar në Karaçevë pritet të jetë vetëm një nga rreth 200 kontestet kufitare që do të jenë në mes të Kosovës dhe Serbisë. Pavarësisht kësaj, nga Komisioni Qeveritar për Mirëmbajtjen dhe për Shënimin e Kufirit kanë thënë për "Zërin" se ata e kanë studiuar mirë vijën kufitare me Serbinë dhe janë përgatitur mirë për këtë çështje. Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje në njërën nga seancat e Kuvendit të Kosovës ka folur rreth problemeve që pritet t'i ketë Kosova me Serbinë gjatë demarkimit të kufirit.



HYN NË LOJË SHKËMBIMI I LEPOSAVIÇIT ME LUGINËN

Për shkrimet se Leposaviçi mund të shkëmbehet me Preshevën e një pjesë të Bujanocit, e shkrimet tjera në media, Thaçi nuk i ka komentuar. "Nuk flas për shkrime që nuk kanë adresë, janë spekulime the fake news, që s'dua t'i komentoj", tha ai

Dje, kur Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, vendosi kurorë lulesh tek varri i veprimtarit të shquar, Adem Demaçi, foli edhe për dialogun Kosovë-Serbi para mediave. I pyetur nga gazetarët për deklaratat e fundit se çka mund të bisedohet në Bruksel, Thaçi nuk e mohoi mundësinë se në tryezë do ketë bisedime edhe për mundësinë e shkëmbit të territoreve.

Për shkrimet se Leposaviçi mund të shkëmbehet me Preshevën e një pjesë të Bujanocit, e shkrimet tjera në media, Thaçi nuk i ka komentuar. "Nuk flas për shkrime që nuk kanë adresë, janë spekulime the fake news, që s'dua t'i komentoj", tha ai. Por, burime të Kohës Ditore, të afërta me këto zhvillime, kanë thënë se opsion është që komuna më veriore e Kosovës- Leposaviqi bashkë



me Leshakun të shkëmbehen me Preshevën dhe një pjesë e Bujanocit.

"Kosova dhe Serbia janë shtete që kanë të drejtë të nënshkruajnë marrëveshje cilado qofshin ato, të cilat janë të mirë të të dy vendeve", ka thënë Thaçi. Thaçi ka insistuar që Kosova dhe Serbia, në fund të dialogut do të kenë njohje reciproke. Ndërkohë i pyetur për liqenin e Gazivodës, Thaçi nuk ka pranuar të përgjigjet. Pjesë e marrëveshjes mendohet të jetë edhe liqeni i Gazivodës, përkatësisht gjetja e një zgjidhjeje bazuar në traktet ndërkombëtare për ujërat. E sipas buri-

meve të Kohës Ditore, këtu pritet të ketë përplasje mes palësh, për shkak të pretendimeve të serbëve se kanë pronësi mbi Gazivodën.

Burime të Kohës Ditore, të afërta me këto zhvillime, kanë thënë se opsion është që komuna më veriore e Kosovës- Leposaviqi bashkë me Leshakun të shkëmbehen me Preshevën dhe një pjesë e Bujanocit. Pjesë e marrëveshjes do të jetë edhe liqeni më i madh artificial që gjendet në veri, Gazivoda. Presidenti ka refuzuar të deklarohet qartësisht, derisa në kabinetin e Haradinajt e kanë quajtur "të pavërtetë" këtë opsion.

Prokuroria Speciale s'ka informacione për vrasësin e 46 shqiptarëve

Pas katër vjetësh qëndrimi në arrati autoritetet malazeze ditë më parë kanë prangosur ish-anëtarin e grupit paramilitar "Çakallët", Predrag Vukojeviqin, i quajtur "Magjo", i cili dyshohet të jetë përfshirë në vrasjen e 46 civilëve shqiptarë në vitin 1999 në fshatin Lubeniç. Edhe pse ai dyshohet për vrasjen e disa civilëve në një fshat të Pejës, emri i tij nuk figuron në databazën e Prokurorisë Speciale të Kosovës, e cila është kompetente për hetimin e krimeve të luftës. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës nuk e ka idenë më të vogël nëse ish-anëtarin e grupit paramilitar "Çakallët", Predrag Vukojeviqin, i quajtur "Magjo", i cili dyshohet të jetë përf-



shirë në vrasjen e 46 civilëve shqiptarë në vitin 1999 në fshatin Lubeniç, është i përfshirë në lëndën për "Krime lufte në Kosovë". Vukojeviqi është arrestuar nga autoritetet malazeze sipas një urdhërrarrestimi ndërkombëtar në INTER-

POL, të lëshuar nga Prokuroria për Krime Lufte në Serbi. Derisa kjo e fundit ka lëshuar urdhërrarrestim ndërkombëtar kundër Vukojeviqit, për Prokurorinë Speciale të Kosovës ky emër është ende i panjohur. Zyrtarë të kësaj Prokurorie bëjnë të ditur se në databazën e PSRK-së nuk gjendet një emër i tillë. Zyrtari i lartë për komunikim me publikun nga Prokuroria e Shtetit, Bedri Gashi, pohon se lënda për vrasjet e civilëve shqiptarë në fshatin Lubeniç gjendet ende në duart e EULEX-it dhe për të mësuar nëse Predrag Vukojeviqin është pjesë e kësaj lënde Prokuroria do të mësojë posa lënda të transferohet te vendorët. (zëri.info)

Serbia përfituesja më e madhe e CEFTA-s

Serbia rezulton të jetë përfituesja më e madhe e Marrëveshjes së Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA). Nga shkëmbimet tregtare midis 6 vendeve, bazuar në Marrëveshjen e CEFTA-s, Serbia ka peshën më të madhe dhe ekonominë më të zhvilluar nga 6 vendet anëtare të CEFTA-s, shkruan sot Koha Ditore. Ministri i Financave dhe Ekonomisë së Shqipërisë, Arben Ahmetaj, ka pohuar në Komitetin Kombëtar të Lehtësimit të Tregtisë se gjatë 10 vjetëve të fundit shkëm-

bimet tregtare të Shqipërisë janë rritur me rreth 5 herë në kuadër të CEFTA-s, ku rritjen më të madhe e kanë shënuar shkëmbimet tregtare me Serbinë me 8.73 herë, me Kosovën me 6.2 herë dhe me Malin e Zi me 5.6 herë. Në total, shkëmbimet tregtare të Shqipërisë me vendet e rajonit në vitin 2017 zënë 11.1% të shkëmbimeve të përgjithshme tregtare. Ndërkohë që ekonominë e 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor janë të angazhuara për të krijuar një Zonë Ekonomike

Rajonale (REA në CEFTA).

Zona Ekonomike Rajonale (REA) është një zonë e integruar, ku mallrat, shërbimet, investimet dhe fuqia punëtore e kualifikuar mund të lëvizin pa pengesa brenda 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor, me qëllim rritjen e atraktivitetit ekonomik të rajonit, zgjerimin e tregut për investitorët potencialë, krijimin e zinxhirit të vlerave rajonale dhe përmirësimin e marrëdhënieve tregtare brenda WB6 dhe BE-së.





Qentë që luftojnë krimin!

Në Tajlandë, qentë endacakë bredhin rrugëve në tufë, por një nisim e re mund t'i kthejë qenët e shfrenuar nga një telash në një skuadër detektive për luftimin e krimin. Sipas Curiosity, hapësirat publike të tejmbushura me qentë endacakë mund të përhapin sëmundje dhe në përgjithësi të

ngacmojnë kalimtarët për ushqim dhe vëmendje. Agjencia reklamuese Cheil, me seli në Korenë e Jugut, ofroi një zgjidhje interesante për problemin e qenve të humbur të Tajlandës. Qenve u janë vendosur kamera të fshehura. Këto kamera të fshehura aktivizohen kur qeni filon të lehtë në mënyrë agresive dhe

shpresa është që qenët endacak do të fillojnë të lehin kur diçka në lagje nuk shkon. "Ajo që duam të theksojmë është se qentë endacakë mund të jenë të dobishëm dhe mund të jetojnë bashkë me komunitetin", tha për Uashington Post, Awika Suyasit, një anëtare e ekipit që doli me idenë për qentë hetues.



Në Lesbos mbyten refugjatë turq, pasues të Gylenit

Para ishullit grek Lesbos u mbyt një varkë me refugjatë nga Turqia. Sipas njoftimeve të mediave nga 16 vetë që ishin në bord, gjetën vdekjen ndër ta tre foshnja. Roja bregdetare turke arriti të shpëtonte 10 vetë. Refugjatët ishin nënshtritur turq. Sipas Gekhan Gergu-luarslan, anëtar i Këshillit bashkiak të Ayvalikut prej nga ishte nisur varka, personat e arritur ishin pasues të lëvizjes Gylen. Meqë qeveria turke e bën këtë lëvizje përgjegjëse për grushtin e shtetit të 15 korrikut 2016 deri tani janë arrestuar dhjetëra-mijëra pasues të predikuesit Fethullah Gylen. Rreth 130.000 punonjës civilë janë pushuar nga puna dhe zakonisht kjo shoqërohet edhe me anulimin e pasaportave të tyre. Pas dështimit të grushtit të shtetit presidenti Erdogan shpalli gjendjen e jashtëzakonshme, e cila u zgjat shtatë herë. Prej asaj kohe një numër diplomatësh, ushtarakësh apo qytetarë të tjerë turq janë përpjekur të largohen nga Turqia dhe të kërkojnë azil në BE. Me 19 korrik 2018 gjendja e jashtëzakonshme u hoq nga fuqia, por parlamenti miratoi një ligj anti-terror, i cili u jep autoriteteve të drejta largvajtëse.

FËMIJËT E BURGJEVE TË IZRAELIT!



Anëtarja e Bordit ekzekutiv të Organizatës për Çlirimin e Palestinës (OÇP), Hanan Ashravi tha se në burgjet e Izraelit ndodhen 291 fëmijë. Në një deklaratë me shkrim, pas lirim të "palestinezes së guximshme" Ahd al-Tamimi, Ashravi tha se "Në burgjet e Izraelit ka ende 291 fëmijë dhe rreth 5900 palestinezë". Duke kërkuar lirinë e të gjithë të burgosurve në burgjet e Izraelit, Ashravi tha se Izraeli vazhdon të shkelë të drejtat e palesti-

nezëve të burgosur ndërsa komuniteti ndërkombëtar po i mbyll sytë përpara trajtimeve të tilla ilegale dhe çnjerëzore. Ajo thotë se Tamimi dhe nëna e saj janë mbajtur në paraburgim nga forcat okupuese izraelite në mënyrë të padrejtë, duke shtuar se kjo kishte arsye politike. Ashravi shtoi se familja Tamimi është shndërruar në simbol të rezistencës, nderit dhe krenarisë. Ndërkohë, Qeveria e Izraelit dje liroi "palestinezin e guximshme",

Anëtarja e Bordit ekzekutiv të Organizatës për Çlirimin e Palestinës (OÇP), Hanan Ashravi tha se në burgjet e Izraelit ndodhen 291 fëmijë

fituese e "Çmimit të Guximit Handhala", Ahd al-Tamimi si dhe nënën e saj.

Ushtarët izraelitë më 19 dhjetor të vitit 2017 e arrestuan Tamimin pas një bastisjeje në shtëpinë e saj në Ramallah ku jetonte së bashku me familjen. Ndërkaq edhe nëna e saj Neriman ishte ndaluar nga ushtarët izraelitë në njësinë e paraburgimit në lindje të Ramallahut, pasi kishte shkuar të marrë informacione në lidhje me vajzën e saj. Arrestimi i saj ndodhi pasi mediat izraelite publikuan pamje teksa Ahd al-Tamimi e godiste me shuplakë një ushtar izraelit i cili kishte hyrë me forcë në oborrin e shtëpisë së saj në Nebi Salih, në afërsi të qytetit Ramallah në Bregun Perëndimor të okupuar. Ajo akuzohej për "sulm" ndaj ushtarëve izraelitë.

Tamimi, e cila njihet si "guximtarja palestineze", në vitin 2012 në Stamboll ishte shpërblyer me çmimin për kurajo Handhala, për qëndrimin e saj të guximshëm ndaj ushtarëve izraelitë derisa ata po arrestonin vëllain e saj. Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, në atë kohë kryeministër, u takua personalisht me vajzën palestineze për të shprehur admirimin e tij për trimërinë e saj.

Policia gjermane në kërkim të 126 mijë të huaj, shumica islamistë

Sipas njoftimeve të mediave, policia gjermane është në kërkim të rreth 300.000 vetëve, ndër ta 126.000 të huaj, shumica e të cilëve islamistë. Gazeta "Welt am Sonntag" jep shifrat e sakta duke iu referuar të dhënave të Entit Federal për Kriminalitetin në Gjermani,

transmeton DW. Sipas tyre janë shpallur në kërkim saktësisht 297.820 vetë, 126.327 syresh të huaj. Ministria Federale e Punëve të Brendshme mendon se një pjesë të huajve të shpallur në kërkim duhet të jenë larguar ndërkohë nga Gjermania. Personat e shpallur në kërkim janë persona të burgosur për vepra penale që janë arratisur, të tillë që janë fshehur për t'i shpëtuar ndjekjes penale, ose persona që konsiderohen si rrezik për rendin publik. Sipas autoriteteve ndër personat e shpallur në kërkim ka një rritje

të numrit të personave që kanë kryer vepra penale me motive politike. Në krahasim me një vit më parë numri i personave të shpallur në kërkim për vepra të tilla është trefishuar - fjala është për 4.411 vetë. Shumica e tyre janë islamistë.

të numrit të personave që kanë kryer vepra penale me motive politike. Në krahasim me një vit më parë numri i personave të shpallur në kërkim për vepra të tilla është trefishuar - fjala është për 4.411 vetë. Shumica e tyre janë islamistë.

Gjysma e britanikëve duan BREXIT të ri

Gjysma e britanikëve kërkojnë mbajtjen e një referendumi të ri rreth largimit të Britanisë së Madhe nga Bashkimi Evropian (Brexit), ndërsa 78 për qind e qytetarëve mendojnë se Qeveria është duke e udhëhequr keq procesin e Brexit-it, ka treguar një anketë e fundit në këtë vend. Sipas një ankete të kompanisë "Sky Data" të zhvilluar me 1.466 persona më 20-23 korrik, shumica e popullatës janë shprehur pro shkuarjes në referendum për marrëveshjen e Brexit-it të cilën qeveria do t'ia

ofrojë BE-së. Rezultatet tregojnë se 50 për qind e qytetarëve kanë kërkuar një referendum i cili do t'i përfshinte alternativat për "marrëveshjen e parashtruar nga qeveria", "largim pa marrëveshje" dhe "ngelje në BE". Ndërkaq, 40 për qind janë shprehur kundër kërkesës për referendum.

Gjersa 78 për qind e pjesëmarrësve mendojnë se qeveria është duke e udhëhequr keq procesin e Brexit-it, 74 për qind e kanë konsideruar si të pakënaqshme udhëheqjen e kryeministres Theresa

May. Ndërkohë, 31 për qind janë të mendimit se Brexit do të gjenerojë rezultate pozitive në jetën e tyre personale, ndërsa 42 për qind kanë shprehur mendim negativ. 51 për qind besojnë se Brexit do të sjellë pasoja negative për vendin. Ndryshe, May kishte deklaruar se procesi i mëtutjeshëm i Brexit-it do të udhëhiqej nga vetë ajo pas dorëheqjes së Boris Johnson dhe David Davis, të cilët ishin përkrahës të mëdhenj të largimit nga BE-ja. Dorëheqjet ndodhën disa ditë pasi qeveria më



6 korrik shpalli qasjen e re të negociatave, përmes së cilës hapeshin

dyert për marrëveshje speciale të tregtisë së lirë dhe doganore.

Gjatë shekujve, aksionet e tij janë rrëfyer dhe romantizuar shumë herë, por burimet historike nuk janë aq të mbushura me informacione mbi jetën dhe as për vdekjen e tij. Pothuajse me siguri ai u vra në betejë, në prillin e vitit 71 P.E.S, dhe jo i kryqëzuar përgjatë Rrugës Apia, siç tregohet për shembull, në filmin me protagonist aktorin e njohur amerikan Kirk Dagllas

Nga Annalisa LO MONACO

Spartaku (109-71 P.E.S), gladiatori i famshëm që arriti të mposhte shumë herë ushtritë e frikshme romake me një ushtri skllevërishe, është një figurë historike që u shndërrua në një legjendë: një hero që lufton për liri kundër forcave shumë më të mëdha në numër, edhe pse nuk kishte si nxitje ndonjë ideale.

Karl Marksi madje e quajti atë "një nga protagonistët më të mirë të historisë së lashtë (...) një përfaqësues i vërtetë të proletarietit të lashtë". Gjatë shekujve, aksionet e tij janë rrëfyer dhe romantizuar shumë herë, por burimet historike nuk janë aq të mbushura me informacione mbi jetën dhe as për vdekjen e tij. Pothuajse me siguri ai u vra në betejë, në prillin e vitit 71 P.E.S, dhe jo i kryqëzuar përgjatë Rrugës Apia, siç tregohet për shembull, në filmin me protagonist aktorin e njohur amerikan Kirk Dagllas.

Por kush ishte në të vërtetë Spartaku? Ai sigurisht nuk ishte një "proletar", por ndoshta i përkiste një familje fisnike që jetonte në Trakë, një rajon historik midis Greqisë, Bullgarisë dhe Turqisë. Për disa kohë ai ishte pjesë e ushtrisë romake, por pastaj e braktisi atë, ndoshta sepse nuk ishte në gjendje t'i nënshtrohej disiplinës strikte ushtarake.

Pasi u kap dhe u skllavërua, ai përfundoi si një gladiator në Amfiteatrin e Kapuas, ku u ngrit shkolla e parë e gladiatorëve. Nëse Spartaku nuk kishte arritur të mësohej me disiplinën ushtarake, ai nuk mund të toleronte as gjendjen e skllavërisë: në vitin 73 P.E.S, arriti të arratiset, duke marrë me vete 70 gladiatorëve të tjerë (por sipas Ciceroni ishin më pak se 50), të cilët marshuan drejt Vezuvit, të armatosur vetëm me thika të marra nga kuzhina e shkollës.

SPARTAKU MIDIS LEGJENDËS DHE REALITETIT

FUNDI I SKLLAVIT REBEL



Rrugës, radhët e ushtrisë së Spartakut, që komandonte rebelët së bashku me dy Galët, Enomao dhe Kriksus, ishin gjithmonë në rritje - skllevërit nëpër fshatra, por edhe njerëz të lirë, fshatarë dhe bariinjë të varfër u bashkuan me gladiatorët, sidomos pasi ata mposhtën me lehtësi legjionet e Gaius Klaudio Glabros I, dhe të Publius Variniusit më vonë.

Në fakt, romakët e nënvlerësuan atë grup skllevërishe të armatosur keq, të cilët në pamje të parë nuk dukej se përbënin një kërcënim të madh: dy komandantët romakë nuk kishin me vete një ushtri të vërtetë, por ushtarë të rekrutuar nga zonat aty pranë, tërësisht të papërvajë, dhe aspak të stërvitur. Spartaku vazhdoi t'i llojë skllevërit nëpër fshatra, duke sulmuar dhe shkatërruar

shumë fshatra në Italinë Jugore, ndërsa Roma filloi të shqetësohej: Ushtria e Spartakut, tanimë numëronte 40.000 persona. Pastaj, siç ndodh shpesh në mesin e atyre që luftojnë në të njëjtën anë, dhe me të njëjtat qëllime, rebelët u përçanë. Spartaku, që nuk ishte dakord me dhunën ekstreme të ish-skllevërit galë dhe gjermanikë, u nis drejt veriut, ndërsa Kriksus i udhëhoqi ndjekësit e tij besnik në Apulia (Puljan e sotme), ku u mund nga konsulli Lusius Gellius Publikola, i cili më pas u vu në ndjekje të Spartakut, ndërsa konsulli tjetër, Klodiano Lentulus, vinte nga veriu.

Luftëtarët e Spartakut i shpartalluan legjionet e të dyve, dhe më pas edhe ato të guvernatorit të Galisë Alpine. Në atë pikë, Spartaku kishte rrugën e hapur drejt



Alpeve, domethënë lirisë, në territoret ende relativisht të lira nga kontrolli romak. Në vend të kësaj, për arsye që historia nuk i di, gladiatorët u rikthyen në jug. Rebelët arritën në Kalabri, duke planifikuar të kalonin në ishullin e Sicilisë, për t'u bashkuar me një revoltë skllevërishe, që kishte shpërthyer asokohe në Trinakria. Por ata nuk kishin llogaritur udhëheqësin e ri të romakëve, të pasur dhe arrogant Mark Krasin, që për të motivuar ushtarët e tij në luftë, zbatoi praktikën e dhjetimit: nga legjionet që tërhiqeshin përpara armikut, ai do të zgjidhte me short një numër të caktuar ushtarësh (thuhet se u ekzekutuan 4.000, pas një humbjeje përballë Spartakut), të cilët u vranë duke u goditur me shkopinjë.

Për të shpëtuar nga legjionarët, rebelët u kthyen në veri, duke u drejtuar për në Pulja, me Krasin që i ndiqte nga pas, por që u mposht në betejën e Petilias. Ajo ishte fitorja e fundit e ushtrisë së Spartakut: rebelët u tërhoqën në Lukania, ku Spartaku takoi një pirat, Tigranin, me të cilin donte të organizonte një udhëtim detar nga Brindisi, por ardhja e një garnizoni romak në portin puljez, ndryshoi planet e gladiatorit.

Ndërkohë, grindjet e brendshme vazhduan të dobësonin ushtrinë rebele: komandantët Kriksus, Enomao, Ganiko dhe Kastio, u ndanë veçmas grupe të ndryshme dhe Spartaku mbeti me një numër të vogël ndjekësishe. Sërish, ndarjet midis armiqve ishin në favor të romakëve: më në fund ata u mposhtën që të gjithë. Gjashtë mijë ushtarë të Spartakut u kryqëzuan përgjatë Via Apia. Spartaku, në vend se të përpiqej të arratiset, u përball me Krasin në Kalabri, ose ndoshta në Lukania, duke luftuar si një luan, deri në fund, derisa ai u masakrua me goditje shkopinje. Sipas Salustio, në fund të betejës, trupi i Spartakut nuk u gjet, ndoshta për shkak se ishte i shpërfytyruar, dhe nuk identifikohet nga ndonjë armaturë e veçantë. Megjithatë, sipas një versioni më romantik, skllavi heroik arriti t'i shpëtojë armiqve të tij, dhe i udhëhoqi disa rebelë të mbijetuar drejt një vendi, ku ishte ende e mundur të jetohej pa vuajtur zgjedhën e romakëve. Megjithatë versioni kinematografik i vitit 1960, duhet të konsiderohet si një version fiktiv i ngjarjeve larg realitetit historik, rindërtimi i skenarëve dhe betejave, është ende gjithsesi me interes për të apasionuarit pas historisë.

LIGA E KAMPIONËVE - SHKËNDIJA NË MOLDAVI PËRBALLET ME SHERIF TIRASPOLLIN

ADILI: PËR TU PLASUAR TUTJE, DUHET TË SHËNOJMË SË PAKU NJË GOL

"Sipas mendimit tim gjasat janë të barabarta, të themi 50-50. Kemi rezultat pozitiv, derisa 1-0 nuk është rezultat për tu nënçmuar. Nga ana tjetër futbollistët e Sheriff Tiraspollit para tifozëve të tyre luajnë lojë ofensive dhe agresive. Për këtë arsye ne të gjithë jemi të vetëdijshëm se për tu plasuar tutje, duhet të shënojmë së paku një gol", pohon Adili



Shkup, 30 korrik - Skuadra e Shkëndijës sonte (e martë) do të zhvillojë ndeshjen kthyesë të raundit të dytë të Ligës së Kampionëve, kundër Sherif Tiraspollit. Kuqezinjët kanë epërsi minimale prej 1-0 nga ndeshja e parë në Shkup dhe do të tentojë që këtë epërsi ta rruajë dhe të paktën të shënojë një gol, që të mund ta bëjë më të lehtë plasimin në raundin e tretë. Trajneri Qatip Osmani dhe mbrojtësi Mevlan Adili besojnë se në rast se Shkëndija imponon lojën e vet, mund të kalojë në raundin e tretë. "Gjate

këtyre ditëve e bën analizën e lojës me Sheriff Tiraspollin që e zhvilluam në Shkup dhe kishim mundësi të shohim disa gabime që bëmë gjatë pjesës së dytë. Mendoj se gjasat janë reale që Shkëndija të shkojë më tej edhe pse ka një përparësi minimale, por ndeshja luhet në një fushë ku lejohet të luhet dhe nëse arrijmë të imponojmë lojën tonë, besoj se Shkëndija do të kalojë më tej" tha Osmani. Në anën tjetër, Adili pranon se do ta kenë vështirë, ndërsa rastet për tu plasuar në raundin tjetër janë 50-50. "Sipas mendimit tim gjasat janë të barabarta, të themi 50-50. Kemi rezultat

pozitiv, derisa 1-0 nuk është rezultat për tu nënçmuar.

Nga ana tjetër futbollistët e Sheriff Tiraspollit para tifozëve të tyre luajnë lojë ofensive dhe agresive. Për këtë arsye ne të gjithë jemi të vetëdijshëm se për tu plasuar tutje, duhet të shënojmë së paku një gol. Nuk besoj se do të humbim 3-1. Në fakt cili do rezultat le të arrihet, vetëm Shkëndija të plasohet në raundin tjetër dhe të luajmë kundër Sallzburgut në raundin e tretë", u shpreh Adili.

"Para së gjithash, gjëja më e rëndësishme për ne është se ne jemi me plotë vetëbesim. Fitorja në nde-

shjen e parë, për ne ka rëndësi të madhe. Nëse në të kaluarën kemi mundur pa probleme në Liga Evropë, tani këtë po e bëjmë edhe në ndeshjet e Ligës së Kampionëve. Sigurisht se për këtë jemi të gjithë krenar. Përsëris, duhet ta japim maksimumin, ndërsa nëse ajo mjafton për sukses është në rregull, nëse jo, të paktën kemi dhënë më të mirën nga vetja", përfundoi mbrojtësi shkupjan në radhët e kuqezinjve. Ndeshja Sheriff Tiraspoll - Shkëndija do të zhvillohet në orën 19.00, ndërsa fituesi nga kjo përballje në raundin e tretë do të përballlet me Sallzburgun. (B.K.)

Nevill sërish flet me ironi për Shaqirin

Ish-futbollisti i Mançester Junajtedit vazhdon të tregojë inatin e tij ndaj shqiptarit. Geri Nevill nuk i ndal kritikën ndaj Xherdan Shaqirit. Futbollisti shqiptar shkëlqeu në debutimin e tij me fanellën e Liverpoolit duke asistuar dhe shënuar një super gol ndaj Mançester Junajtedit në fitoren e "The Reds" 4-1 në kuadër të "International Champions Cup". Gjatë Kampionatit Botëror, legjenda e Junajtedit, e kishte quajtur "joprofesionist" mesfushorin shqiptar ndërsa së fundmi ai ka ironizuar duke thënë se Shaqiri do të qëndrojë në mesfushë kot. "Shpresoj që të gjithë ju do të më shkruani mesazhe sa herë që ta shihni atë duke qëndruar në vijën e mesit të fushës derisa skuadra juaj po sulmohet", ka thënë Nevill, transmeton "ksp". "Ai ka gjithashtu nevojë që përkrah tij të luajë Ronaldinjo", tha ai. Neville pasi dështoi të tregonte veten si trajner, ka nisur punën si analist ku njihet si mjaft kontrovers.

Shkupi sfidohet nga Gjilani dhe Feronikelil

Shkup, 30 korrik - Kur kanë mbetur edhe pak më shumë se dy javë deri në fillimin e kampionatit të ri futbollistik të Maqedonisë, skuadra e FC Shkupit edhe pse është një nga ekipet e para që këtë sezon ka filluar me përgatitje shkaku i paraqitjeve në arenën ndërkombëtare, ka aranzhuar edhe një ndeshje kontroluese. Skuadra që do të sfidojë Shkupin, është Gjilani nga Kosova, ndërsa ndeshja do të luhet të mërkurën

(01.08.2018), me fillim në orën 16:30 minuta në stadiumin e Çairit. Gjithashtu me 5 gusht me fillim në ora 17:00, është planifikuar të luhet ndeshja që ishte caktuar më parë me 29 korrik ndaj Feronikelit. Të dy ndeshjet do të jenë një mundësi më tepër që trajneri Zekirija Ramadani të shef nga afër aftësitë edhe të futbollistëve të rinj nga Nigeria, Senegali dhe Ishujt Fare, që ditë më parë erdhën në testime.



PAS SHKËLQIMIT TE BAJERNI I MUNIHUT

Shabani mes kombëtares së Kosovës, Shqipërisë e Gjermanisë

Një gol i bukur me kokë kundër Mançester Sitit ishte ai që e bëri të famshëm këtë muaj, por Meritan Shabani ka kohë që shkëlqen tek të rinjtë e Bajernit dhe që sezonin e shkuar ishte bërë pjesë e ekipit të parë, duke debutuar në formacion në fitoren kundër A인트rahtit të Frankfurtit në prill të këtij viti. Tani 19-vjeçari i lindur në Muni natyrisht ka

përpara edhe dilemën e përzgjedhjes së kombëtares ku do të luajë, nëse zhvillimi i tij ecën me këtë ritëm. Mesfushori ofensiv duket se kërkon t'i bëjë gjërat me qetësi, duke pritur momentin e duhur për të vendosur. Menaxheri për median dhe licencimin në Federatën e Kosovës, Bajram Shala, ka folur për "Gazetën Express", duke shpjeguar ç'po

ndodh. "Po, ka shumë kohë që jemi në kontakt me familjarët e Meritanit.

Ata kërkojnë që të mos nguten dhe fillimisht duan ta shohin sesi po zhvillohet Meritani e më pas të marrin një vendim. Ne ua kemi bërë të qartë që jemi të gatshëm të bëjmë gjithçka që është e mundshme që Meritani të luajë për Kosovën", deklaroi Shala.



Në bazë të nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/41, 199/14 dhe 27/16) dhe nenit 14 paragrafi 1, nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05, 106/08, 161/8, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), nenit 110-g dhe 110-e të Ligjit për mbrojtje sociale ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 79/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14, 180/14, 33/15, 72/15, 104/15, 105/15, 173/15, 192/15 dhe 30/16), pas Pëlqimit të marrë nga Ministria e Punës dhe Politikës sociale nr. 04-6519/3 të datës 25.06.2018, dhe Vendimit të Drejtorit të IP Enti për mbrojtje dhe rehabilitim Banja Bansko, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE Për punësim të:

- 1 (një) realizues/ve për kohë të pacaktuar për vendin e punës – përkëdhelëse.

Kandidatët të cilët do të konkurrojnë, duhet të përmbushin Kushtet e përgjithshme në vijim të përcaktuara me Ligj:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryeje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Shpallja publike zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.

Për vendin e lartpërmendura të punës: orari i punës është me ndërrime prej 3 ndërrimeve me 40 orë pune në javë,

Pagesa fillestare për përkëdhelësit është: 12.728,00 denarë.

2. Kandidatët obligohen të parashtrorjnë dëshmi përkatëse në formë origjinale ose kopje të vërtetuar në noter, si për përmbushjen e kushteve të përgjithshme, ashtu të parashtrorjnë dëshmi edhe për përmbushjen e kushteve të posaçme edhe atë:

-Për përkëdhelës për nivelin B3 së paku niveli i kualifikimeve III, 180 kredi sipas ECVET ose arsim të mesëm trevjeçar.

- Diplomë/Certifikatë/Dëftesat për shkallë të kryer përkatëse të arsimit që kërkohet për vendin e punës;
- Shtetësia dhe
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë gjyqësore për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës – jo më të vjetra se 6 (gjashtë) muaj.

Dokumentet e kërkuara parashtrorhen në zarf të mbyllur me shënim "Të mos hapet" në adresën në vijim:

IP Enti për mbrojtje dhe rehabilitim Banja Bansko – Strumicë

F. Bansko pn

Arkivi i Institucionit

(me shenjë "për shpallje")

Fletëparaqitja dhe dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i pakompletuar nuk do të merret parasysh.

IP Enti për mbrojtje dhe rehabilitim Banja Bansko
Drejtor
Defektolog i diplomuar Stojanka Izova

Në bazë të nenit 19a dhe nenit 23 paragrafi 3 të Ligjit për ndërmarrjet publike ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 38/96; 6/02; 40/03; 49/06 41/14; 138/14; 25/15, 61/15 dhe 39/16), nenit 50 paragrafi 1 pika 9 e Ligjit për Vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 5/02), nenit 34 të Statutit të Komunës Karbinci ("Fleta Zyrtare e Komunës së Karbincit" nr. 3/04), si dhe në bazë të Vendimit për publikim të konkursit publik për zgjedhje të Drejtorit të NP "Pllačkovića" – Karbinci, numër 04 - 890/1 të datës 27.07.2018,

Kryetari i Komunës së Karbincit publikon:

KONKURS PUBLIK Për zgjedhje të drejtorit të Ndërmarrjes publike "Pllačkovića" – Karbinci

1. Kryetari i Komunës së Karbincit publikon konkurs publik për zgjedhje të Drejtorit të NP "Pllačkovića" – Karbinci me mandat prej 4 (katër) vjet.
2. Kandidati duhet të përmbushë kushtet e përgjithshme në vijim:
 - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
 - Në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase,
 - Të jetë i moshës së rritur,
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
 - Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
3. Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të përmbushin kushtet e posaçme në vijim, të përcaktuara me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Statutin e NP "Pllačkovića" – Karbinci:
 - Të ketë të arritura së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit,
 - Të ketë minimum pesë vjet përvojë pune;
 - Të posedojë një prej certifikatave të pranuar ndërkombëtarisht në vijim ose certifikatave për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet edhe atë TOEFL iBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2, FCE (Cambridge English: First) – të dhënë ose BULATS – së paku 60 pikë ose APTIS – së paku niveli B2.

Vërejtje: Kandidati i zgjedhur i cili do të emërohet obligohet që të përmbushë kushtin për njohje të gjuhës angleze, më së voni në afat prej një viti nga dita e emërimit të tij në funksionin e drejtorit.

Kushtet e tjera:

Pagesa: 25.800,00

Orët e punës në javë: 40

Orari i punës: prej 07:30 deri 15:30

Ditët e punës: Prej së hënës deri të premten

4. Dokumentet e nevojshme të cilat kandidatët duhet të parashtrorjnë janë si në vijim:
 - Fletëparaqitje për konkurs;
 - Biografi të shkurtë të kandidatit;
 - Certifikatë të mjekut;
 - Certifikatë të shtetësisë;
 - Vërtetim/Certifikatë se nuk është i dënuar nga gjykata themelore;
 - Dëshmi për 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar diplomë ose certifikatë;
 - Dëshmi për përvojë të arritur të punës;
 - Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës nga Regjistri qendror i RM;
 - Vërtetim se posedon një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet edhe atë TOEFL iBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2, FCE (Cambridge English: First) – të dhënë ose BULATS – së paku 60 pikë ose APTIS – së paku niveli B2.

Dokumentet e nevojshme parashtrorhen në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

5. Krahas dokumenteve të nevojshme, kandidati duhet të parashtrorjë edhe Program për punë të ndërmarrjes publike për periudhë prej 4 (katër) vjet.

6. Kandidatët të cilët paraqiten duhet fuqishëm të besojnë në kapacitetin e tyre, të posedojnë aftësi menaxhimi dhe shkathtësi lideri, aftësi për punë ekipore dhe të jenë të përgatitur për përkushtim themelor, angazhim të fuqishëm dhe sfida. Të gjithë kandidatët e paraqitur kanë mundësi të barabarta të jenë të pranuar në pajtim me aftësitë e tyre, arsimin, përvojën dhe kapacitetin personal.

7. Dokumentet e arritura do t'i shqyrtojë komisioni prej tre anëtarëve i zgjedhur nga ana e Kryetarit të Komunës së Karbincit dhe në afat prej 8 ditëve pas kalimit të afatit të konkursit, tërë dokumentacionin do t'ia dorëzojë Kryetari të Komunës, i cili në afat prej 15 ditëve nga dita e parashtrimit të dokumentacionit, do të sjellë Vendim për zgjedhje të drejtorit.

8. Të gjithë kandidatët e paraqitur do të ftohen në intervistë.

9. Fletëparaqitjet me dokumentet e nevojshme parashtrorhen në zarf të mbyllur, personalisht në arkivin e Komunës së Karbincit ose përmes postës në adresën në vijim: Komuna e Karbincit fshati Karbinci nr. 2207 Karbinci, PËR KRYETARIN E KOMUNËS SË KARBINCIT, me shenjë (PËR KONKURS PUBLIK PËR ZGJEDHJE TË DREJTORIT).

10. Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit në gazetën ditore.

11. Fletëparaqitja e dorëzuar pas afatit, jo e plotë dhe e parregulluar nuk do të jetë lëndë shqyrtimi.

Numër 04 - 890/2
27 korrik 2018
Karbinci

KRYETARI I KOMUNËS,
Së Komunës së Karbincit
Jordan Nasev

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 62/2008, 106/2008, 161/2008, 114/2009...27/2016 dhe 120/2018) nenit 37-i të Ligjit për ndërmarrjet publike ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 38/1996, 6/2002, 40/2003...39/2016 dhe 64/2018) dhe nenit 9 dhe nenit 10 të Marrëveshjes kolektive të NPK DERVEN Veles, Drejtori i ndërmarrjes

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të ofruesve të shërbimeve dhe personave ndihmës-teknik për kohë të pacaktuar të punës në NPK DERVEN Veles

Neni 1

Drejtori i NPK DERVEN Veles ka sjellë Vendim për punësim të ofruesve të shërbimeve dhe personave ndihmës-teknik për kohë të pacaktuar të punës për vendet e punës në vijim:

1. Inkasant pagues në Departamentin Tregjet me shifër KDR 03 05 B04 101 – (1) realizues

- PMP

- Pa përvojë pune

2. Shtitës të pajisjeve të varimit në Sektorin Higjiena Komunale – Departamenti Varrezat me shifër KDR 03 05 B04 039- (1) realizues

- PMP

- Pa përvojë pune

3. Punëtor të përgjithshëm në Sektorin Higjiena Komunale / Departamenti për mënjanim të mbeturinave – Seksioni për grumbullim dhe trajtim të mbeturinave me shifër KDR 03 05 V02 031 – (3) realizues

- Arsim fillor

- Pa përvojë pune

4. Vozitës të traktorit në Sektorin Higjiena Komunale – Departamenti për higjienë publike me shifër KDR 03 05 B03 020 – (1) realizues

- PMP

- Leje të vozitjes të kategorisë B/C

- 1 vjet përvojë pune

5. Vozitës të traktorit në Sektorin Higjiena Komunale – Departamenti për mënjanim të mbeturinave me shifër KDR 03 05 B03 020 – (1) realizues

- PMP

- Leje të vozitjes të kategorisë B/C

- 1 vjet përvojë pune

6. Mekanik në Sektorin Higjiena Komunale / Departamenti për mënjanim të mbeturinave – Seksioni punëtor automekanike me shifër KDR 04 01 A02 035 – (1) realizues

- PMP – automekanik, makineri, elektro (shkalla III)

- 1 vjet përvojë pune

7. Larës të rrugëve në Sektorin Higjiena Komunale – Departamenti për higjienë publike me shifër KDR 03 05 V02 003 - (2) realizues

- Arsim fillor

- Pa përvojë pune

8. Vozitës të makinës speciale në Sektorin Higjiena Komunale - Departamenti për mënjanim të mbeturinave me shifër KDR 03 05 B03 005 - (2) realizues

- PMP

- Leje të vozitjes të kategorisë B/C

- 1 vjet përvojë pune

9. Punëtor për ngarkim të bërllokut në Sektorin Higjiena Komunale - Departamenti për mënjanim të mbeturinave me shifër KDR 03 05 V02 002 – (3) realizues

- Arsim fillor

- Pa përvojë pune

10. Punëtor të përgjithshëm në Sektorin Higjiena Komunale - Departamenti për higjienë publike me shifër KDR 03 05 V02 031 – (2) realizues

- Arsim fillor

- Pa përvojë pune

11. Punëtor të përgjithshëm në Sektorin Ujësjellës dhe kanalizim / Departamenti për distribuim dhe ujësjellës – Seksioni për mirëmbajtje me shifër KDR 04 01 A03 012 - (2) realizues

- Arsim fillor

- Pa përvojë pune

12. Punëtor të përgjithshëm në Sektorin Ujësjellës dhe kanalizim / Departamenti për distribuim dhe ujësjellës – Seksioni kanalizim me shifër KDR 04 01 A03 012 – (1) realizues

- Arsim fillor

- Pa përvojë pune

Neni 2

Për plotësimin e vendit të punës, kandidati duhet të përmbushë kushtet e përgjithshme në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,

- në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase,

- të jetë i moshës së rritur,

- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës (vërtetim mjekësor) dhe

- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (vërtetim nga Gjykata themelore Veles)

Krahas përmbushjes së kushteve të përgjithshme për vendin e punës nga paragrafi 1 i këtij neni, kandidati duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim:

- të ketë kualifikim profesional të nevojshëm për vendin e punës,

- të ketë përvojë përkatëse të nevojshme për vendin e punës dhe

- të posedojë kompetenca të posaçme përkatëse të nevojshme për vendin e punës.

Neni 3

Shpallja për punësim do të zgjasë 15 ditë nga dita e publikimit të saj në gazetën ditore (Nova Makedonija dhe Koha) më datë 31.07.2018. Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në procedurën e realizuar të intervistës. Kandidatët do të ftohen në intervistë në afat prej 5 (pesë) ditëve pas përfundimit të konkursit publik.

Drejtor
NPK DERVEN Veles
Ekonomist i diplomuar Gjorgji Stojanov

Në bazë të nenit 126 paragrafi 1 alineja 7 dhe 132 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/2008, 116/2010, 156/2010), Këshilli i shkollës së SHF "Krstev P. Misirkov" – f. Bistrica në bazë të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Manastirit nr. 08-568/2 të datës 24.07.2018 dhe Vendimit të Këshillit të shkollës nr. 02-205/2 të datës 27.07.2018 publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për zgjedhje të drejtorit të SHF "Krstev P. Misirkov" f. Bistrica

Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, kandidati duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim:

- Të ketë së paku arsim sipëror;
- Të përmbushë kushtet për mësimdhënës, pedagog dhe psikolog në shkollë fillore;
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- Të ketë së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në institucion për punë edukative arsimore;
- Të ketë të dhënë provimin për drejtor.

Kandidatët duhet të parashtrorjnë dokumentet në vijim:

- CV – biografi të shkurtë;

- Original ose kopje të vërtetuar në noter të diplomës për arsim të mbaruar;

- Dëshmi për përvojën e punës;

- Certifikatë për provim të dhënë për drejtor;

- Program të shkurtë për punë për periudhë prej 4 vjet;

- Certifikatë se në momentin e emërimit nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

Orari i punës është 40 orë në javë prej ora 07:00 deri në ora 15:00.

Neto pagesa mujore është në shumë prej 26.850,00 denarë.

Mandati i drejtorit është për periudhë prej 4 (katër) vjet.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit, ndërsa i tërë procesi rreth zgjedhjes së drejtorit zgjatë deri në përfundimin e procesit sipas dispozitave ligjore.

Dokumentet e nevojshme të parashtrorhen deri të Këshilli i shkollës pranë SHF "Krstev P. Misirkov" f. Bistricë.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

Këshilli i shkollës pranë
SHF "Krstev P. Misirkov" – f. Bistricë

Në bazë të nenit 21 dhe 22 të Ligjit për punësuarve në sektorin publik dhe nenit 22 dhe 23 prej Ligjit të marrëdhënieve të punës, Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë, boton

Shpallje

për punësim me kohë të caktuar deri me 31.12.2018

I Për nevojat e themelimit të marrëdhënies së punës për kohë të caktuar në Agjencinë e punësimit të Republikës së Maqedonisë për vendin e punës siç vijon:

1. Bashkëpunëtor shërbimeve për mbështetjen e punësimit në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë – Qendra e punësimit në qytetin e Shkupit-një realizues;

Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:

- Arsimin e lartë, përkatësisht të ketë së paku 180 kredit të arritura sipas EKTS-së ose të ketë mbaruar shkallën VII/1;

-Të ketë së paku dy vjet përvojë pune në profesion;

-Të ketë njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;

-Të ketë njohje aktive të njërës prej tri gjuhëve që më së shpeshti përdoren në Unionin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);

-Rroga themelore neto për vendin e punës do të jetë 23.230,00 denarë

Bashkë me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë edhe:

- Dëftesën/diplomën për mbarimin e nivelit arsimor;

- Vërtetimin/dëshminë për përvojë punës;

- Vërtetimin/dëshminë për njohje e programeve kompjuterike për punë zyre;

- Vërtetimin/dëshminë për njohje aktive të gjuhëve;

- Dëshminë se nuk është shqiptuar ndalesë për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

- Vërtetimin e shtetësisë

II. Marrëdhënia e punës themelohet me orar të plotë pune-40 orë në javë, nga e hëna deri të premten, ndërsa orari i punës ditore është prej 07:30 deri 15:30.

III. Bashkë me fletëparaqitjen, kandidatët duhet të dorëzojnë dëshmi me të cilat vërtetohet plotësimi i kushteve të parapara.

IV. Shpallja do të jetë e hapur pesë ditë pune, duke filluar nga data e botimit në shtypin ditore.

V. Fletëparaqitjet me dokumentacionin e nevojshëm duhet të dorëzohen në arkiv nëpërmjet postës në adresën siç vijon: Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë- shërbimi qendror, rruga "Vasil Gjorgov" nr. 43, Shkup.

Sipas nenit 31, 36, 39 dhe 40 nga Ligji për Shërbim në Armatën e Republikës së Maqedonisë („Gazeta Zyrtare e RM “ nr. 36/10, 23/11 , 47/11, 148/11 dhe 55/12 dhe 29/14), , 33/15, 193/15 dhe 71/16), nenit 1 nga Rregullorja për mënyrën e zbatimit të procedurës për pranimit të kandidatëve për oficerë, gjegjësisht nënoficerë, ushtarë profesional dhe personel civil për shërbim në Armatën e Republikës së Maqedonisë („Gazeta Zyrtare” e RM numër 57/18), Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë shpall

KONKURS PUBLIK

1. Për pranimit e 125 (njëqind e njëzet e pesë) ushtarëve profesional për shërbim në Armatën e Republikës së Maqedonisë për kohë të caktuar me kontratë për punësim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjetëve, me mundësi për vazhdim disa here, më së shumti deri në moshën 45 vjeçare sipas përzgjedhjes në përputhje me Ligjin.

2. Kandidatët për pranimit si ushtarë profesional për shërbim në Armatën e Republikës së Maqedonisë nga pika 1 e këtij konkursi duhet të plotësojnë kushtet në vijim:

Kushtet e përgjithshme:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë;
- të jenë në moshë madhore, dhe të kenë aftësi të veçantë shëndetësore dhe fizike.

Kushte të veçanta:

- të kenë mbaruar arsimin e mesëm;
- të kenë kryer shërbimin vullnetar ushtarak dhe të mos jenë më të moshuar se 25 vjeç në ditën e mbarimit të shpalljes së konkursit për pranimit të ushtarëve profesional.

Orari i punës është nga ora 08,00 deri në ora 16,00.

3. Paga mujore është nga 20.000,00 denarë deri në 24.000,00 denarë.

4. Kandidatët të cilat kanë sigurim shëndetësor dhe do të dorëzojnë vërtetim të lëshuar nga doktori amë për përputhje të përgjithshme të mirë shëndetësore bashkë me fletëparaqitjen për pranimit të kandidatëve për ushtarë profesional për shërbim në ARM, nuk do të duhet t'u nënshtrohen kontrolleve për aftësi të përgjithshme shëndetësore.

5. Personat të cilët nuk kanë sigurim shëndetësor dhe si rrjedhojë nuk do të jenë në gjendje të dorëzojnë vërtetim nga mjeku amë për aftësinë e përgjithshme shëndetësore bashkë me paraqitjen për pranimit të kandidatëve për ushtarë profesional për shërbim në ARM, do të dërgohen për kontrolle të aftësive të përgjithshme shëndetësore në Institutin për fiziologji në Qendrën Klinike – Shkup.

Gjatë procedurës së përzgjedhjes, kontrolli i aftësive fizike dhe shëndetësore të kandidatëve për ushtarë profesional për shërbim në ARM do të realizohet nga komisione të veçanta të formuara nga ministria e mbrojtjes.

Kandidatët do t'u nënshtrohen kontrolleve për testimin e gatishmërisë fizike sipas Rregullores për mënyrën e ruajtjes dhe kontrollit të aftësive fizike për personelin ushtarak aktiv në shërbim në ARM (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 170/16) apo në vegzën vijuese: <http://morm.gov.mk/wp-content/uploads/2018/07/>

Gjatë punësimit do të merret parasysh edhe përfaqësimi i drejtë dhe adekuat i qytetarëve të cilët u përkasin bashkësive të ndryshme etnike duke respektuar kriteret për profesionalizëm dhe kompetenca.

6. Njëherit, Ministria e Mbrojtjes fton dhe i inkurajon pjesëtarët e gjinisë femërore të cilat i plotësojnë kushtet të aplikojnë në këtë konkurs publik për pranimit e ushtarëve profesional në Armatën e Republikës së Maqedonisë.

7. Me kandidatët e përzgjedhur do të lidhet kontratë pune për kohë të caktuar me kohëzgjatje të kontratës në afat prej (3) tre vjetësh, në përputhje me pikën 1 të këtij konkursi.

8. Konkursi publik për pranimit e ushtarëve profesional do të zgjatë 30 ditë nga dita e shpalljes në së paku 2 gazeta ditore, edhe atë në një në gjuhën maqedonishte dhe një në gjuhën qe e flasin mbi 20 % nga qytetarët të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonishte, si dhe në internet faqen e Ministrisë së Mbrojtjes.

9. Kandidatët për ushtarë profesional në konkursin publik mund të aplikojnë nëpërmjet postës elektronike të Ministrisë së Mbrojtjes javenoglaspfv@morm.gov.mk duke plotësuar formularin Aplikacionin për Kandidatët për Ushtarë Profesional për Shërbim në ARM. Aplikacionin mund ta merrni në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes www.morm.gov.mk.

10. Kandidatët për ushtarë profesional në konkursin publik mund të aplikojnë edhe në Njësitë e Mbrojtjes të Ministrisë së Mbrojtjes në ose afër vendbanimit të tyre .

11. Gjatë aplikimit në konkursin publik, kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet dhe të dhënat si në vijim::

- Aplikacionin për Kandidatët për Ushtarë Profesional për Shërbim në ARM (Fletëparaqitjen mund ta gjeni në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe në Njësitë e Mbrojtjes)

- pyetësor i plotësuar me shkrim dhe deklaratë mbi përgjegjësinë morale, materiale dhe penale për vërtetësinë e të dhënave (formularin mund ta gjeni në ueb faqen e Ministrisë dhe në Njësitë e Mbrojtjes);

- Vërtetim për kryerjen e shërbimit vullnetar ushtarak në ARM (Vërtetimi merret në Njësinë e Mbrojtjes);

- Fotokopje të një dokumenti për identifikim personal (letër njoftim ose pasaportë);

- Diplomë për arsimin e mesëm të mbaruar (original ose kopje të noterizuar);

- Vërtetim të lëshuar nga mjeku amë për gjendjen e përgjithshme shëndetësore për personat të cilët kanë sigurim shëndetësor, dhe këtë të dhënë janë të detyruar ta theksojnë në aplikacionin për aplikim të kandidatëve për ushtarë profesional për shërbim në ARM;

12. Dokumentet e pa kompletuara dhe jo të dorëzuara në kohë nuk do të merren në shqyrtim.

13. Kandidatët për ushtarë profesional të cilët me sukses do të kalojnë të gjitha kontrollet e parashikuara në faza, sipas Rregullores për Mënyrën e kryerjes së Procedurës për Pranimit të Oficerëve, gjegjësisht nënoficerëve, ushtarëve profesional dhe personelit civil në shërbim në Armatën e Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e republikës së Maqedonisë” nr. 57/18) edhe atë:

- Kontroll i të dhënave të cilat kandidatët i kanë dorëzuar si të vërteta,,

- Kontroll të aftësisë fizike,

- Kontroll të aftësisë shëndetësore

14. Vendosen në listën për përzgjedhje dhe pranimit të ushtarëve profesional për shërbim në ARM

15. Kandidatët për ushtarë profesional të cilët do të pranohen për shërbim në ARM dhe do të ftohen në Ministrinë e Mbrojtjes për të nënshkruar kontratën e punës duhet të sjellin me vete dokumentet në vijim::

- diplomë për arsimin e mesëm të mbaruar (original ose kopje të noterizuar);

- certifikatë shtetësie;

- certifikatë të lindjes;

- vërtetim se nuk i është lëshuar masë sigurie ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë apo detyrës (jo më të vjetër se 6 muaj);

- letër njoftim me afat dhe 2 (dy) fotokopje të letërnjoftimi ku duhet shënuar komuna ku jeton me adresën e banimit;;

- llogari transaksioni;

- nëse kandidati ka qenë i punësuar të dorëzojë listën e dorëheqjes me datë të përmyllur në kompaninë ku ka qenë i punësuar (formulari M-2), ose vërtetim se nuk është i punësuar të lëshuar në agjencinë për punësim.

16. Kandidatët që nuk do të përzgjedhen pas shpalljes publike dhe nuk do të punësohen në Ministrinë e Mbrojtjes si ushtarë profesional për shërbim në Armatën e Republikës së Maqedonisë, dokumentet e tyre do t'i marrin me njoftim me letër nëpërmjet njësisë rajonale të Mbrojtjes në rajonin ku edhe janë dorëzuar.

REPUBLIKA
E MAQEDONISË
MINISTRIA E MBROJTJES

Koha
http://www.koha.mk

www.koha.mk
koha@koha.com.mk | marketing@koha.com.mk
Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060;
Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, I.Q.T. Mavrovosja lok.14 - përdhesh, Shkup

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. “7 korriku” nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar 890 m2 me markë ndërtimore 430 m2, lartësia 8,5 m, Bo+ Pr+1+1+Nën, trualli i parë në “Momin Potok” – Shkup, industria e lehtë, asfalt, ndriçim të rrugëve, autobus, rrymë elektrike, ujë, kanalizim, telefon, internet, gardh, parking dhe nënobjekte të ndërtuara ndërtimore (gjithsej 180 m2). Çmimi 165.000 euro. Tel. 078-201-960

Republika e Maqedonisë
Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Në bazë të nenit 20 të Ligjit për Byronë për zhvillim të arsimit (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 37/2006, 142/2008, 148/2009, 69/2013, 120/2013, 148/2013, 41/2014, 30/2016 dhe 64/2018), Qeveria e Republikës së Maqedonisë publikon

Shpallje publike për emërim të zëvendës drejtorit të Byrosë për zhvillim të arsimit

1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës do të emërojë zëvendës drejtorin e Byrosë për zhvillim të arsimit, me mandat prej katër vjet.

2) Për zëvendës drejtor të Byrosë për zhvillim të arsimit mund të emërohet personi i cili përmbushë kushtet në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- të ketë të arritur së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit;
- të ketë minimum pesë vjet përvojë pune në punë edukativo arsimore dhe të përmbushë kushtet nga neni 17 alineja 2, 3 dhe 4 e Ligjit për Byro për zhvillim të arsimit dhe
- të posedojë një prej certifikatave të njohura ndërkombëtare ose certifikatave për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vite: TOEFEL IBT – me më së paku 74 pikë; IELTS – me më së paku 6 pikë; ILEC (Cambridge English: Legal) – me më së paku nivelin B2; FCE (Cambridge English: First) – të dhënë ose BULATS – me më së paku 60 pikë ose APTIS – së paku nivelin B2.

3) Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët janë të obliguar të parashtrajnë dokumentacionin në vijim:

- biografi të shkurtë;
- certifikatë të shtetësisë;
- Dëshmi se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- diplomë për arsimin e mbaruar sipëror;
- dëshmi se ka minimum pesë vjet përvojë pune në punë edukativo arsimore dhe të përmbushë kushtet nga neni 17 alineja 2, 3 dhe 4 e Ligjit për Byro për zhvillim të arsimit.

4) Dokumentet nga pika 3 duhet të parashtrihen në original ose kopje të vërtetuara në noter dhe të njëjtat parashtrihen në Arkivin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë ose përmes postës në adresën: Qeveria e Republikës së Maqedonisë, bul. “Ilinden” nr. 2, 1000 Shkup me shënim: “Për shpallje publike për emërim të zëvendës drejtorit të Byrosë për zhvillim të arsimit”.

5) Koeficienti për përllogaritje të pagesës është përcaktuar në pajtim me Vendimin për përcaktim të koeficientit për përllogaritje të pagesës së funksionarëve të cilët i emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 53/2005, 71/2005, 2/2006, 8/2006, 46/2006, 18/2007, 94/2007, 103/2007, 126/2007, 138/2007, 39/2008, 137/2008, 154/2008, 63/2009, 76/2009, 144/2009, 39/2010, 63/2010, 158/2010, 5/2011, 75/2011, 133/2011, 70/2012, 82/2012, 161/2012, 172/2013, 16/2014, 21/2014, 99/2014, 116/2014, 152/2015, 161/2015, 218/2015, 19/2016, 71/2016, 189/2016, 126/2017, 102/2018 dhe 108/2018).

6) Zëvendës drejtori i cili emërohet në periudhë nga dita e futjes në fuqi të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Byronë për zhvillim të arsimit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 64/2018) prej më 18 prill deri më 1 shtator 2018, obligohet që të përmbushë kushtin për njohje të gjuhës së huaj më së voni në afat prej një viti nga dita e emërimit të tij. Zëvendës drejtori i cili nuk do të përmbushë kushtin për njohje të gjuhës së huaj brenda afatit të caktuar i ndërpritet mandati.

7) Afati për paraqitje të kandidatëve të interesuar është pesë ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes në gazetën ditore, ndërsa deri më 6 gusht 2018.

8) Dokumentacioni i pakompletuar dhe dokumentacioni i parashtruar pas kalimit të afatit për aplikim nuk do të shqyrtohet.

NEJMAR PRANON "TEATRIN" DHE ZOTOHET

PASHË VETEN NË PASQYRË DHE DO TË NDRYSHOJ

Nejmar ka përdorur reklamën e sponsorit me prodhuesit e produkteve të kujdesit personal "Gillette" për të pranuar kritikën dhe për t'u zotuar se do të ndryshojë

Nejmar ka pranuar se e ka ekzagjeruar me rëniet pas faullave gjatë Kupës së Botës në Rusi, por superstari i Brazilit dhe PSZH është zotuar të bëhet një njeri i ri në këtë drejtim, pas turneut të madh të kësaj vere. Ka pasur shpresa të mëdha për Nejmarin dhe Brazilin në "Rusia 2018", por gjigantët e Amerikës së Jugut u eliminuan që në çerekfinale, pas disfatës me Belgjikën. Nejmar, i cili shënoi dy herë në këtë Botëror, pasi u rikthye nga një këmbë e thyer, që e la jashtë fushave prej muajit shkurt, ishte objekt i rregullt i kritikave për "teatrin" dhe sjelljen e tij në fushë. Sulmuesi 26-vjeçar, lojtari më i shtrenjtë në historinë e



futbollit, u la më pas jashtë listës së shkurtër për çmimin e "The Best" të FIFA-s. Nejmar ka përdorur reklamën e sponsorit me prodhuesit e produkteve të kujdesit personal "Gillette" për të pranuar kritikën dhe për t'u zotuar se do të ndryshojë. Reklama fillon me Nejmar

duke thënë "Boot-stud on the shins. Kick in the spine. Stomp on the foot": "Ju mund të mendoni se unë bëj teatër me reagimin në fushë. Nganjëherë e bëj. Por, e vërteta është që vuaj në fushë. Ti që je jashtë saj, nuk e ke idenë se çfarë kaloj. Kur të largohem pa folur për

shtypin, nuk është sepse vetëm unë dua të fitoj, por sepse ende nuk kam mësuar të zhgënjem. Kur dukem i pasjellshëm, nuk është sepse jam një fëmijë i përkëdhelur, por se ende nuk kam mësuar si të merrem me frustrimet e mia. Ka ende një djalosh brenda meje, ndonjëherë ai e verbon botën, herë të tjera i prish të gjitha. Dhe lufta ime është për ta mbajtur këtë djalë gjallë, por brenda meje, jo brenda fushës. Ju mund të mendoni se e kam tepruar me rëniet në fushë, në Botëror, por realiteti është ndryshe", thotë në reklamë Nejmar, duke vazhduar: "Paragjykimi më lëndon më shumë se kushdo që shkel në kyçin e këmbës sime të operuar. Kam marrë kohë për t'i pranuar kritikën. Kam marrë kohë për të parë veten në pasqyrë dhe për t'u bërë njeri i ri. Por, tani jam këtu, me zemrën time të hapur. U rrëzova, por vetëm ata që bien mund të ngrihen. Mund të më godisni me gurë dhe të më ndihmoni të ngrihem, sepse kur ngrihem, i gjithë vendi ngrihet me mua".

FLET ISH FUTBOLLISTI ARGJENTINAS I XHENOAS
Jam drogë dhe dashuroj armët!



Fëmijëria e vështirë, konsumimi i drogës, dashuria për armët. Ricardo Centurion, një prej talentëve të mëdhenj argjentinas, që deri tani ende nuk janë shprehur plotësisht, është rrëfyer gjatë një interviste për emisionin "PH-Podemos Hablar" të 'Telefe'. "Kam kaluar një fëmijëri të vështirë, jam rritur në një qytet pranë Avellaneda, aty ku sot nuk mund të kthehem. E gjithë kjo për shkak të zilisë, shumë zili. Dhe familja ime e vuan. Kam humbur babin tim që në moshë të vogël. Punonte në një fabrikë ilegale të fishekzjarrëve, në të zeze. Nuk dihet se si, por një ditë shpërtheu. Aty punonin shtatë punonjës dhe vdiqën të gjithë. Unë isha 5 vjeç dhe aty nisi një jetë e re. Nëse nuk e shohë në foto, nuk më kujtohet fare", rrëfeu argjentinas që është aktivizuar me Xhenoan në Seria A. Jetim që fëmijë, Centurion ka pasur shoqëri të rrezikshme. "Më pëlqejnë armët, por nuk kam kryer kurrë ndonjë krim. Kam bërë edhe foto të armatosur, në San Nikola, përpara se të bëhesha profesionist. Nëse do të isha rritur me jahte, atëherë do të kisha bërë foto me jahte. Por nuk e kam pasur atë fat. Kur kam debutuar në Primera, ndodhi gjithçka bashkë dhe nisa të përdor mariuanë. Sot ka kontrolle antidoping surprizë, dhe nëse rezulton pozitiv, atëherë është një njollë që nuk arrin kurrë ta heqësh. Por më parë bënin kontrolle një herë në javë dhe ishte ndryshe, por kam provuar drogë", përfundon Centurion.

Zbulohet shtëpia e Ronaldos në Torino



Arriti të dielën vonë në mbrëmje, në terminalin privat të aeroportit "Caselle". U shfaq me djalin më të vogël në krahë, me një bluzë me mëngë të shkurtra të bardhë dhe syze të errëta. Me trajnimin e djeshëm, zyrtarisht filloi aventura bardhezi i Cristiano Ronaldos. Një aventurë që do ta shohë kampionin portugez duke jetuar në një shtëpi luksoze në Torino. Bëhet fjalë për dy vila, me dy

hyrje të veçanta, të zhytur në pyje dhe në zonën qendrore të Torinos. Shtëpia e KR7 ndodhet prapa "Gran Madre", jo shumë larg shtëpisë së Xhon Elkann. Niveli i sigurisë është në nivelet më të larta, privatësia do të garantohet nga rojet dhe kamerat. Brenda ka gjithçka: nga një pishinë shtëpie te palestra gjithnjë e pranishme, sepse Cristiano do të trajnohet çdo ditë edhe në shtëpi.

Ibra humb ndeshjen kundër Juventusit



Asnjë "amarcord" për Zlatan Ibrahimović. Sulmuesi suedez do ta humbasë "All-Star Game", formacioni i cili do të ketë një

përzgjedhje të lojtarëve të MLS për të sfiduar Juventusin në një ndeshje miqësore. Për të bërë të njohur mungesën e ish-sulmuesit të Juventusit ishte klubi i tij, Los Anxhelos Galaksi, që në një shënim zyrtar shpjegoi se Ibra ka një kalendar të ngjeshur, që përfshin tri ndeshje në një javë. Është shumë e rëndësishme për Ibrahimović dhe LA Galaksi kjo pikë e sezonit, sidomos kur në horizont afrohet një cikël i vërtetë "zjarri" brenda disa ditësh: "Më vjen keq që nuk mund të jem në dispozicion të "All-Star Game" për ndeshjen kundër Juventusit, një nga ish-skuadrat e mia, – ka komen-

tuar Ibra. – I falënderoj ata që votuan për mua, por qëllimi im kryesor është për të shënuar dhe për të ndihmuar Los Anxhelos Galaksi në "play-off", deklaroi Ibra. Ndryshe, natën mes të mërkurës dhe të enjtes, në Atlanta, bardhezinjtë do të përballen me një skuadër të përbërë nga lojtarët më të mirë në ligën amerikane të futbollit. Njëmbëdhjetësja titullar është përzgjedhur nga tifozët (në mesin e tyre ishte edhe suedezi), ndërsa pjesa tjetër nga "Tata" Martino, i cili për këtë rast do të udhëheqë ekipin e MLS. Ndryshe nga Ibrahimović, një tjetër ish-lojtar i Juventusit, Sebastian Xhovinko do të jetë

atje. Ja lojtarët, që do të përbëjnë "All-Star Game": Portierë: Guzan (Atlanta Junajted), Steffen (Kolumbus Crev); Mbrojtës: Kalvo (Minnesota), Ciman (LAFC), Dejviss (Vankuver), Hedges (Dallas), Long (NYRB), Murillo (NYRB), Parkhurst (Atlanta), Zusi (Kansas Siti); Mesfushorë: Almiron (Atlanta), Bar-

co (Atlanta), Xhonatan dos Santos (LA Galaksi), Elis (Hjuston), Piatti (Montreal), Ring (NYCFC), Sançez (Kansas Siti), Valeri (Portland), Jotun (Orlando), Zahibo (Nju England); Sulmues: Xhovinko (Toronto), Martinez (Atlanta), Vela (LAFC), Villa (NYCFC), B.Urajt-Filips (NYRB).

TREGOLËSHI I PARË I IBRAS NË MLS

Zlatan Ibrahimović i papërmbajtshëm me Los Anxhelos Galaksi. Sulmuesi suedez shënoi tre gola në fitoren 4-3 të skuadrës kaliforniane ndaj Orlando Sinit, duke dhënë kontributin kryesor në përmbysjen e rezultatit. Me këtë tregolësh "Mbreti" Zlatan arriti në kuotën e 15 finalizimeve në 17 ndeshje në MLS, kampionat ku u transferua në fillimit të vitit, pas një sezoni të gjysmë te Mançester Junajted.

DASHI 21. mars - 20. prill
Ky është momenti më i mirë për të shfaqur të gjithë talentin tuaj dhe për të treguar se sa vleni. Duhet të jeni kurajoz dhe të gatshtëm për gjithçka, pasi intuata juaj do të rezultojë fituese sa i takon çështjeve të biznesit.

DEMI 21. prill - 21. maj
Është duke u mbyllur një muaj i cili ju ka parë konfuzë dhe mjaft të lodhur. Parashikohet një rikuperim shumë i mirë, si nga pikëpamja fizike edhe ajo sentimentale, por megjithatë duhet të jeni shumë të kujdesshëm në mënyrë që të shmangni polemikat e kota.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
Nis një javë e rëndësishme, e cila parashikon rinovime të rëndësishme për karrierën tuaj aktuale. Tashmë mund të nisni planifikimin e një udhëtimi romantik. Parashikohen marrëveshje të mira.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
Distanca me partnerin së fundmi ju ka krijuar jo pak probleme, ndaj gjatë kësaj të hëne këshillohet që të favorizoni më shumë dialogun. Në vendin e punës duhet të shfaqni më shumë besim sa i takon ballafaqimeve me bashkëpunëtorët. Janë fare pranë konfirmime pozitive.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
Shkëndija dhe rikthimi i dashurisë është shumë i mundur gjatë kësaj dite, kjo edhe për shkak të rigjetjes së sigurisë në veten tuaj. Jini të gatshëm për të përballuar një fazë mjaft intriguese, e cila do ju lejojë që të vlerësoni sa më mirë ndjenjat tuaja.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
Këshillohet që të bëni kujdes me shpenzimet, pasi në këtë moment duhet të përcaktoni qartë prioritetet tuaja, në favor të disa ndryshimeve në familje ose në dashuri. Në mbrëmje parashikohen momente me tensione, por shmangni përfshirjen në debate shumë të ndezura.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
Kjo është një ditë disi e turbullt, ndaj duhet të ruani sa më shumë të mundeni ekuilibrin e duhur. Do të jeni të detyruar që të mendoheni lidhur me diskutimet që keni patur me të afërmit apo bashkëpunëtorët tuaj. Avantazhet janë fare pranë.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
Do të dini të jeni shumë vendimtarë në raport me të tjerët dhe kjo gjë do ju lejojë që të rrethoheni nga aleatë të vlefshëm, sidomos nëse jeni në prag të nisjes së një projekti të ri. Këshillohet që të jeni luftarak, pasi parashikohen sfida të reja stimuluese për karrierën. Në mbrëmje do të shijoni momente relaksi dhe dashurie.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
Ka disa çështje të cilat i keni lënë pas dore dhe tashmë duhet të mundoheni që të vini në zbatim intuitën tuaj, në mënyrë që të arrini rezultatet e shpresuara. Në dashuri mos u dekurajoni, pasi parashikohen konfirmime të cilat i prisnit prej kohësh.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
Duhet të mundoheni që të favorizoni më shumë bashkëpunimin me kolegët tuaj, në mënyrë që të përmirësoni ritmin tuaj të punës. Në dashuri do të ndiheni disi të lënë pas dore, ndaj bëni kujdes.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
Në këtë moment dashuria ju bën të fortë dhe karizmatik dhe kjo pasi më në fund keni arritur të gjeni stabilitetin që kërkonit prej kohësh. Por para se të merrni vendime të rëndësishme në vendin e punës, merrni pak më shumë kohë për t'u përgatitur siç duhet.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
Është një ditë e rëndësishme për të vendosur me saktësi disa prioritete tuaja. Po përjetoni një fazë të rëndësishme transformimi, e cila do ju bëjë më të pjekur dhe të vetëdijshëm për kapacitetin tuaj. Kjo e hënë sjell fitore të mëdha në vendin e punës.



KOHA	BABAI/AKTORES NË FOTO, ÇAPLIN	Ç	LLOJ QENI, RETRIVER	REGJISOR AMERIKAN (VËLLAU I XHULIUS STERNIT)	FILM ME AKTOREN NË FOTO	KËNGËTARI DEDA PARAFJALË GJERMANE	Mensur Mamuti	MONEDHA E HUNGARISË AKTORJA NË FOTO	F	FILM ME AKTOREN NË FOTO	PORTIERI SHOQIPTAR, LIKA
KAFSHË ENGLJASHME ME HARDHUCEN, PIKELORE											GRUP LUDHESASH KORALE NË SEJISELE
SATELITI									SHKRONJA E FUNDIT DHE E PARË		BASKETBOLLISTJA PORTORIKANE, TAPIA
AUTORI FRËNG, KAMY							IFSHËTË IMPULSI				
KËNGËTARIA ANGLEZE, MEK KOLL									FUTBOLLISTI SPANJOLL, HERNANDEZ		JODI
SQUIFURI		HYJNËSHA GREKE E HAKMARRUES					PIKTORI YNË, KALESHI		NJË MUAJ VITI AKADEMIKU ALI		
KOHA	QYTET NË UKRAINË								ISH GRUP MUZIKOR SUEDEZ		SHPËRBLIMI NË TË HOLLA, RROGA
JO MORAL									QYTET NË FRANCE		LËVIZJA RELATIVE
KRYEQYTETI I ZVICRES							PARAARDHËSI YNË KALIUMI				TEMPERATURA CELSIUSI
FLORIRI							DORËSHTRËNGUAR, KOPRACE				

ZGJIDHJET: F, XHODI, EROL, RIKI, ANTO, Ç, ELTON, SALAMANDËR, TRABANTI, ZHA, ALBER, INTIM, KIRSTI, ÇAVI, S, ATE, JANAR, ODESA, PAGA, AMORAL, LION, BERN, ILIR, T, ART, KURNACE.

Sudoku

shumë i lehtë

1			3					8
	3	2				1	5	
	6			1			3	
5				7	2			4
6			5		4			2
			1	3				
	8			5			7	
	5	9				6	8	
7			9					5

shumë i vështirë

7		8		3	2	1		6
	1	4	6		8	7	9	
	6	3			9		1	
	7		4			3	5	
	2	6	8		5	9	3	
8		7		9	3	2		5

Shumë i lehtë: 145369728, 932748156, 867215439, 591872364, 673594812, 428136597, 284651973, 359427681, 716983245. Shumë i vështirë: 692741583, 758932146, 314658792, 263589417, 485317629, 971426358, 126875934, 847193265, 539264871.

Birra e prodhuar nga vagina po çmend polakët!



Në tregun e mbushur me birra artizanale, ju duhet të keni një USP për të qëndruar përpara konkurrencës. Por një birrari polake mund të ketë shkuar shumë larg, pasi ofron birra të

prodhuar me baktere nga vaginat e dy modeleve femra. Falë një fushate të suksesshme fabrika e birrës, me bazë në qytetin jugor polak të Katovicës, tani ofron dy birra 8% që iu premtojnë se do

të kapni "gruan e ëndrrave tuaja" që është "mbyllur në një shishe birra". Pronari i birrës Wojciech Mann ka siguruar agjencinë e lajmeve RT se bakteret nga vaginat e dy grave të veçanta, Paulina dhe Monika, përdoren ekskluzivisht në prodhimin e birrës. "Ne i morëm në një makinë, shkua në një laborator shumë të mirë në qytetin e Poznan, i cili i veçoi këto baktere, i shqyrtoi dhe i shumëzoi ato në mënyrë që të ishin vetëm këto baktere", tha ai. Por, ndërkohë që fillimi i polakëve mund të ketë marrë tingullin e vjetër të marketingut "seksit shet" në mënyrë të drejtpërdrejtë, ata nuk janë e para fabrikë birre që përdor ide të neveritshme në mënyrë që të mbizotërojnë në tregun e kësaj pije alkoolike.

Çanta e Meghan Markle në shitje për vetëm 35 dollarë

Duket se përveç një fustani të saj të cilin e kishte në dispozicion për shitje javën e kaluar, Meghan Markle, tani po shet edhe çantën e saj. Atë e kishte përdorur vetëm në "Polo 2018" ku kishte shkuar me princ Harryn dhe pjesëtarët tjerë të familjes mbretërore. Çanta e saj blihet online për 35 dollarë, ndërsa ka të ngjashme të këtij versioni që shiten nga 30 dollarë.



Plas sherri për gomarët, komuna i merr në mbrojtje

Ata i marrin turistët nga porti në qendër të ishullit, duke u ngjitur në një tatëpjetë prej 500 metër nën diellin përvëlues. Dhe kjo ndodh katër deri në pesë herë në ditë. Tani ata do të jenë më të mbrojtur dhe do të ketë kohë të caktuar dhe ngarkesa të zgjedhura. Po flasim për gomarët e shtrenjtë të Santorinit. Autoritetet lokale të ishullit xhevahir kanë vendosur të ndryshojnë rregullat dhe të marrin në mbrojtje gomarët që transportojnë turistët nga porti në kryeqytetin e ishullit, Fira (ose Thera), që është disa qindra metra më lartë. Vendimi erdhi pas protestave të disa aktivistëve të të drejtave të kaf-

shëve dhe për të shmangur publicitetin negativ për ishullin popullor me turistë nga e gjithë bota. Tani e tutje nuk do të lejohet të rrihen gomarët, duke i dënuar pronarët me gjoba. Çështja shpërtheu pasi në rrjetet sociale u publikua një video ku shihej pronari i një gomari duke rrahur kafshën e tij. Të premtën u zhvillua një protestë nga katër grupe aktivistësh që përfundoi me përleshje. Të shtunën Bashkia reagoi duke vendosur masat e reja, pasi pronarët e gomarëve sulmuan protestuesit. Masat gjithashtu sigurojnë që gomarët do të 'mbahen në hije' gjatë pushimeve dhe do t'u jepet ujë më rregullisht.

"Kutia e Zezë" e trurit!



Zbulohet sekreti i mekanizmit që na zgjon në mëngjes, që na mban në kontakt me ambientin e jashtëm dhe nga i cili varen mendimi dhe gjuha. Mekanizmi aktivizohet nga neuronet gjigande të

trurit, me të cilët lidhen edhe funksionet komplekse, si ndërjegjësimi për veten, por edhe aftësia për vlerësuar realitetin. Zbulimi është bërë nga një studim mbi kaviet e laboratorit, nga grupi i

kërkuesve të Rockefeller University dhe është publikuar në revistën shkencore zyrtare amerikane PNAS.

Rezultati mund të ndihmojë për të kuptuar më mirë sëmundjet psikiatrike, si shqetësimi bipolar dhe vëmendja deficitare, në të cilat ky mekanizëm nuk funksionon në mënyrë korrekte. Është studiuar e ashtuquajtura "kutia e zezë e trurit", e cila është një zonë pak e eksploruar deri më tani, por që quhet bërthama gjigandocelulare ose NGC.

Pikërisht në këtë zonë gjenden neurone të mëdha, të cilët mund të jenë esenciale për çdo lloj sjelljeje. Në të është dalluar se prodhohet një enzimë që rrelakson enët e gjakut, duke shtuar kështu fluksin e gjakut që jep oksigjen dhe mbërrin në inde. Kjo kontribuon në gjendjen e zgjimit dhe qëndrueshmërinë funksionale të saj.

KALENDARI HISTORIK 31 KORRIK

- 431 - Zgjedhet Pope Sixtus III.
- 781 - Erupcioni më i vjetër i evidentuar i vullkanit Mt. Fuji (Data tradicionale japoneze 6 korriku, 781).
- 904 - Thessalonica bie në duart e arabëve të cilët shkatërrojnë qytetin.
- 1009 - Pietro Boccapecora bëhet Pope Sergius IV.
- 1451 - Jacques Cœur arrestohet me urdhër të mbretit Charles VII i Francës.
- 1703 - Daniel Defoe vendoset në Pillory për shkak të krimeve.
- 1741 - Mbreti Charles Albert nga Bavaria okupon Austrinë e sipërme dhe Boheminë.
- 1930 - Emetohet për herë të parë radio programi The Shadow.
- 1945 - John K. Giles tenton të arratiset nga burgu Alcatraz.
- 1951 - Themelohet kompania Japan Airlines.
- 1971 - Programi Apollo: Astronautët e misionit Apollo 15 bëhen të parët që kanë ecur në "lunar rever".
- 2006 - Fidel Castro i le pushtetin përkohësisht vëllait të tij Raúl Castro.

Presidenti i 15 i SHBA-së, Xhejms Bukanan, blinte vazhdimisht skllëvër me paratë e tij, në mënyrë t'u garantonte më pas atyre lirinë.



Studimet tregojnë se burrat përjetojnë në fakt më shumë dhimbje emocionale pas ndarjes se sa femrat.



MADHËSIA

Një sipërmarrës varrimi punoi deri vonë natën. Ai e përgatiti trupin e zotëri Schwartz për djegie, por gjatë punës u habit kur ia pa "senin" e madh.
- "Me vjen keq zotëri Schwartz, por nuk mund të lejoj që edhe ky 'sen' të digjet. Duhet të ruhet për brezat e ardhshëm...". Kështu që ia preu dhe e futi në çantë dhe e mori në shtëpi.
- "Eja të shohësh diçka" - i tha gruas se tij duke e hapur çantën.
- "O zot", bërtiti gruaja - "paska vdekur zotëri Schwartz".

THËNIA E DITËS



Breshka, gomari dhe prindi kanë fatin të mbajnë samarin tërë jetën në shpinë. (Dritëro Agolli)